



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

RAPORTI I MES-VITIT MBI ZBATIMIN E BUXHETIT 2022

**VLERËSIMI I SITUATËS MAKROEKONOMIKE, FISKALE DHE
BUXHETORE PËR 5-MUJORIN 2022,
DHE PRITSHMËRITË PËR 12-MUJORIN 2022**

Tiranë, Qershor 2022

P Ë R M B A J T J A

LISTA E TABELAVE.....	3
LISTA E GRAFIKËVE.....	4
I. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE.....	5
I.1 Ecuria e treguesve makroekonomikë për periudhën Janar-Maj 2022.....	5
I.2 Pritshmëritë e treguesve makroekonomikë deri në fund të vitit 2022.....	7
II. POLITIKA FISKALE.....	8
II.1 Performanca fiskale për periudhën Janar-Maj 2022.....	8
II.2 Pritshmëritë fiskale deri në fund të vitit 2022.....	14
III. BUXHETI I VITIT 2022.....	15
III.1 Shpenzimet e Përgjithshme Buxhetore gjatë periudhës Janar-Maj 2022.....	15
III.2 Financat Vendore gjatë Janar-Maj 2022.....	24
III.3 Fondi Rezervë, Fondi i Kontigjencës, Fondi i Rindërtimit.....	29
III.4 Pritshmëria e Shpenzimeve Buxhetore deri në fund të vitit 2022.....	31
IV. BORXHI PUBLIK.....	32
IV.1 Stoku i Borxhit Publik.....	33
IV.2 Menaxhimi i Borxhit.....	35
IV.3 Pritshmëritë e Borxhit për vitin 2022.....	39
V. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE.....	39
V.1 Ndërmarrjet shtetërore.....	41
V.1.1 Ndërmarrjet shtetërore – Sektori Energjetik.....	43
V.1.2 Ndërmarrjet shtetërore – Sektori i Ujësjellës-Kanalizimeve.....	47
V.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme.....	48
V.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e qeverisjes QENDRORE.....	49
V.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes VENDORE.....	49
V.3 Pagesat Faktike të Kontratave Koncesionare/PPP, me Mbështetje Buxhetore.....	50
V.4 Detyrime të tjera Kontigjente.....	52
V.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).....	52
V.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT.....	54
VI. KONKLUZIONE DHE PROPOZIME.....	56
VII. SHTOJCAT.....	57
VII.1 Ecuria e detajuar e treguesve makroekonomikë gjatë Janar-Maj 2022.....	57
VII.2 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2022.....	63
VII.3 Ecuria e detajuar e projekteve të investimeve publike, gjatë Janar-Maj 2022.....	83

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Të ardhurat Tatime & Dogana për periudhën Janar – Maj 2022 (në milionë lekë).....	8
Tabela 2: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga Akciza/Diferencat Janar-Maj 2022/2021.....	10
Tabela 3: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga Akciza/ Diferencat Janar-Maj 2022/2021.....	11
Tabela 4: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga TVSH/Diferencat Janar-Maj 2022/2021.....	11
Tabela 5: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga TVSH/ Diferencat Janar-Maj 2022/2021.....	11
Tabela 6 : Të dhëna për Rentën Minerare, naftë bruto dhe minerale të tjera (në milionë lekë).....	12
Tabela 7: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2022 (në milion LEK).....	15
Tabela 8: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2021 dhe 2022 (në milion LEK).....	15
Tabela 9: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë).....	28
Tabela 10: Shpenzimet e fondit të rindërtimit akorduar për pushtetin vendor sipas natyrës (në milion lekë).....	29
Tabela 11: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto&neto (Janar-Mars 2022)....	35
Tabela 12: Huamarrja e huaj në terma bruto (TM. I 2021-TM. I 2022).....	36
Tabela 13: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2021–Mars 2022).....	37
Tabela 14: Matrica e riskut.....	40
Tabela 15: Të dhënat financiare për UKT sh.a (2020 – T1 2022) (në mijë LEK).....	41
Tabela 16: Të dhënat financiare për Hekurudha Shqiptare sh.a (2020 – T1 2022) (në mijë LEK).....	42
Tabela 17: Të dhënat financiare për AlbGaz sh.a (2020-T1 2022) (në mijë LEK).....	42
Tabela 18: Të dhënat financiare për Albcontrol sh.a (2020-T1 2022) (në mijë LEK).....	43
Tabela 19: Të dhënat financiare për RTSH sh.a (2020-T12022) (në mijë LEK).....	43
Tabela 20: Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB,MFE dhe DPT:.....	44
Tabela 21: Të dhënat financiare 3 mujore për Sektorin Energjitik (në mijë LEK).....	45
Tabela 22: Të dhënat financiare 3 mujore për OSHEE Group sh.a (në mijë LEK).....	45
Tabela 23: Të dhënat financiare 3 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK).....	46
Tabela 24: Të dhënat financiare 3 mujore për OST sh.a (në mijë LEK).....	46
Tabela 25: Stoku i detyrimeve të prapambetura të UK ndaj OSHEE Group sh.a (në mld LEK).....	47
Tabela 26: Stoku i detyrimit të mbetur vendor – T1 2022 (në lekë).....	50
Tabela 27: Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK).....	52
Tabela 28: Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ-së (në Euro).....	53
Tabela 29: Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR).....	55
Tabela 30: Rritja e eksportit të mallrave, sipas kategorive kryesore.....	58
Tabela 31: Rritja e importit të mallrave, sipas kategorive kryesore.....	59
Tabela 32: Bilanci tregtar, sipas kategorive kryesore.....	60
Tabela 33: Rritja vjetore e çmimeve, në përqindje.....	60
Tabela 34: Ecuria e kredisë për bizneset dhe individët, në përqindje.....	61
Tabela 35: Ecuria e kredisë të këqija, në përqindje.....	62
Tabela 36: Ecuria e kursit të këmbimit 2015-2022.....	62
Tabela 37: Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 5M I 2022.....	63
Tabela 38: Shëndetësia dhe mbrojtja sociale.....	64
Tabela 39: Arsimi.....	66
Tabela 40: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural.....	68
Tabela 41: Infrastruktura dhe Energjia.....	69
Tabela 42: TURIZMI DHE MJEDISI.....	71
Tabela 43: Drejtësia.....	72
Tabela 44: Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.....	73
Tabela 45: Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional.....	74
Tabela 46: Mbrojtja.....	76
Tabela 47: Rendi dhe Siguria Publike.....	79
Tabela 48: Kultura.....	81
Tabela 49: Politika e Jashtme.....	82

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Totali i të ardhurave Janar- Maj 2022/2021 (në milionë lekë).....	8
Grafiku 2: Import i Taksuar dhe Eksport Total 2022/2021 (në miliard lekë)	9
Grafiku 3: Të ardhurat Doganore për Janar- Maj 2021, mujore dhe progresive (në milion lekë).....	10
Grafiku 4: Kontribuesit kryesor në të ardhurat doganore Janar- Maj 2022/2021 (në milion lekë).....	10
Grafiku 5: Të ardhurat nga Tatimet Janar- Maj 2022, Mujore dhe Progresive (në milionë lekë)	12
Grafiku 6: Të ardhura nga TVSH dhe rimbursimi i TVSH, 5 mujori në vite (në miliardë lekë).....	12
Grafiku 7: Të ardhurat nga Tatim Fitimi, 5 mujori në vite (në miliardë lekë).....	13
Grafiku 8: Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në vite (në milion lekë)	13
Grafiku 9: Të ardhurat 5 mujore nga Taksat nacionale, në vite (në miliardë lekë).....	13
Grafiku 10: Të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT, në vite (në miliardë lekë).....	14
Grafiku 11: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	15
Grafiku 12: Shpenzimet korente dhe kapitale Plan vs Fakt (në miliard LEK).....	16
Grafiku 13: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme, për periudhën 5 mujore 2022.....	16
Grafiku 14: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	17
Grafiku 15 : Struktura e shpenzimeve korente, për periudhën 5 mujore 2022.....	17
Grafiku 16: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	18
Grafiku 17: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	18
Grafiku 18: Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK).....	19
Grafiku 19: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	19
Grafiku 20: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	20
Grafiku 21: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë LEK).....	20
Grafiku 22: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK).....	21
Grafiku 23 Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)	22
Grafiku 24: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)	22
Grafiku 25: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)	23
Grafiku 26:Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit/suficiti - Plan vs Fakt 5 Mujori 2022 (në milion LEK)	23
Grafiku 27: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor	24
Grafiku 28: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit	25
Grafiku 29: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa mbi pasurinë.....	25
Grafiku 30: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa e biznesit të vogël	26
Grafiku 31: Të ardhurat e pushtetit e pushtetit vendor nga taksat lokale.....	26
Grafiku 32: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre	27
Grafiku 33: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës buxhetore	27
Grafiku 34: Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2017–Mars 2022)	33
Grafiku 35: Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me totalin (2017-Mars 2022).....	33
Grafiku 36: Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2017–Mars 2022)	34
Grafiku 37: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2017-Mars 2022). 34	34
Grafiku 38: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit&instrumenteve (2017-Mars 2022) 35	35
Grafiku 39: Huamarrja e brendshme në raport me të ardhurat tatimore (TM. I 2017-TM. I 2022)	36
Grafiku 40: Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (TM1 2017-TM1 2022).....	36
Grafiku 41: Jetëgjatësia&kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm shtetëror (2017-Mars 2022)	37
Grafiku 42: Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Mars 2022)	38
Grafiku 43: Norma mesatare e ponderuar e titujve shtetërorë (Shtator 2021 - Mars 2022).....	38
Grafiku 44:Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve Burimi: INSTAT (2022)	41
Grafiku 45: Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK).....	46
Grafiku 46:Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %)	46
Grafiku 47:Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln LEK.....	48
Grafiku 48: Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë	49
Grafiku 49: Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore (bashki+qarqe) sipas zërave kryesorë.....	50
Grafiku 50: Rritja mujore e totalit të eksporteve, në përqindje.....	58
Grafiku 51: Rritja mujore e totalit të importeve, në përqindje	59
Grafiku 52: Ndryshimi vjetor i Inflacionit, në përqindje.....	60
Grafiku 53: Ecuria e stokut të depozitave 2021-2022, në përqindje	61

I. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE

I.1 Ecuria e treguesve makroekonomikë për periudhën Janar-Maj¹ 2022

Ekonomia shqiptare u recuperua ndjeshëm gjatë vitit 2021 pas recesionit të vitit të kaluar. Efektet e pandemisë ishin të përmbajtura si rezultat i mbështetjes nga politikat fiskale e monetare ndërthurur me masat rregullative. Rritja ekonomike rezultoi më e fortë dhe me bazë më të gjerë krahasuar me atë që pritej. Efekti bazë dhe ndikimi nga investimet, rigjallërimi i turizmit dhe prodhimi i energjisë elektrike ishin gjithashtu faktorë të veçantë që përcaktuan përbërjen sektoriale të rritjes. Rikuperimi i kërkesës ka qenë i shpejtë dhe prodhimi ka tejkaluar nivelet e para tërmetit dhe të para pandemisë. Edhe tregu i punës paraqet përmirësim me rritje të punësimit dhe rënie të normës së papunësisë. Si sektori i prodhimit, ashtu edhe ai i shërbimeve, kanë përfituar nga këto zhvillime, duke siguruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afatmesme. Për vitin 2021, rritja ekonomike prej +8.54% paraqet një rikthim shumë të fortë, dukshëm mbi parashikimin fillestar dhe mbi nivelin prej -3.5% që ishte një vit më parë. Kjo rritje ishte e shpërndarë në të gjithë sektorët e ekonomisë, ku ndikimin kryesor e ka pasur sektori i ndërtimit me 1.83 pikë përqindje, ndërkohë që industria ka pasur gjithashtu një kontribut të lartë pozitiv në rritje me 1.71 pikë përqindje dhe Tregtia me 1.54 pikë përqindje.

Nga krahu i shpenzimeve, rritja ekonomike pasqyroi zgjerimin e konsumit dhe investimeve, duke reflektuar fuqizimin e kërkesës së brendshme si dhe rritje të eksporteve. Ajo u nxit kryesisht nga përmirësimi i besimit të biznesit dhe konsumatorit, nga rikuperimi i ekonomive partnere si dhe nga stimujt makroekonomikë, veçanërisht të fortë gjatë dy viteve të fundit. Aktualisht, niveli i aktivitetit ekonomik qëndron 5.5% mbi nivelin e regjistruar para tërmetit dhe para pandemisë, duke treguar për tejkalimin e efekteve negative nga këto goditje.

Shifrat e punësimit kanë mbështetur vijimin e ecurisë së aktivitetit ekonomik ku për tremujorin e parë të vitit 2022 papunësia ka vijuar të shënojë rënie dhe papunësia për grup moshën mbi 15 vjeç ka shënuar nivelin prej 11.3%, duke u ulur me 0.6 pikë përqindje në terma vjetorë, dhe duke rënë me 0.1 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021. Ndërkohë që edhe shkalla e punësimit ka vijuar të shënojë rritje duke rezultuar në 54.2% për popullsinë mbi 15 vjeç. Ritmi vjetor i ndryshimit të punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i parë i vitit 2021 në tremujorin e parë 2022, është +3.4%. Në terma vjetorë, punësimi është rritur me 8% në sektorin e industrisë, me 1.7% në sektorin e shërbimeve, dhe me 2.8% në sektorin e bujqësisë.

Një tjetër tregues i rëndësishëm që jep sinjale mbi rritjen ekonomike është treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) që në muajin maj të vitit 2022 shënoi nivelin 107.2, duke pësuar një rritje prej 4.6 pikësh nga muaji i kaluar dhe një rritje me 3.5 pikë përqindje në krahasim me maj 2021. Niveli aktual i TNE-së qëndron 7.2 pikë mbi mesataren afatgjatë² (në nivelin 100), dhe rreth 7.2 pikë përqindje mbi mesataren e 5 viteve të fundit (maj_2017 – maj_2022). Rritja e TNE u përcaktua nga përmirësimi i besimit në pothuaj të gjithë sektorët e ekonomisë, me kontribute më të theksuara nga sektori i shërbimeve dhe i tregtisë.

¹ Analiza e zhvillimeve ekonomike në këtë seksion, bazohet në statistikat/informacionin më të fundit zyrtar të disponueshëm, në momentin e hartimit të këtij raporti.

² Vija tek niveli 100 përfaqëson mesataren afatgjatë

Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave për periudhën 5-mujore të vitit 2022 treguan një rritje të qenësishme, si në eksporte ashtu edhe në importe. Eksportet e mallrave për periudhën janar-maj 2022 shënuan rritje vjetore prej +46% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjithashtu importet e mallrave shënuan rritje prej +27.1%. Këto zhvillime në tregtinë e jashtme të mallrave janë reflektuar dhe tek deficitin tregtar, i cili për periudhën janar-maj 2022 është rritur me rreth 8.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 56.7%.

Inflacioni mesatar për periudhën janar-maj 2022 ishte +5.2%, nga +1.3% që rezultonte një vit më parë gjatë së njëjtës periudhë. Rritja e inflacionit, vjen si shkak i presioneve të forta të ofertës, të cilat rezultuan kryesisht nga rritja globale e çmimeve të mallrave energjitike, të lëndëve të para dhe mallrave bazë ushqimore, duke shkaktuar një rritje të përgjithshme të çmimeve. Përgjatë kësaj periudhe, nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm e ka pasur zëri i ushqimeve dhe pijeve jo alkoolike dhe rritjen vjetore më të lartë e ka pasur zëri i transportit.

Gjatë muajit prill të vitit 2022, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 12.1% krahasuar me muajin prill të vitit 2021. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.8%, ndërsa ai në valutë rritje prej 15.9%, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar. Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin prill të vitit 2022, ka shënuar rritje prej 14%, krahasuar me prillin e vitit 2021, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 4.9 pikë përqindje. Në prill 2022 rezulton se rreth 51.5% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 48.5% përbëhet nga kreditë në valutë. Stoku total i depozitave bankare, gjatë muajit prill të vitit 2022, ka shënuar rritje me 8.9% krahasuar me një vit më parë. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 2.8%, ndërsa ai në valutë është rritur me 14.1% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2021. Në muajin prill 2022 rezulton se rreth 43.8% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 56.2% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj. Stoku total i depozitave të bizneseve në muajin prill të vitit 2022 shënoi rritje prej 20.4% krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar, ndërsa stoku total i depozitave të individëve ka shënuar rritje prej 6.0% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Tregu valutor ka qenë përgjithësisht i qetë dhe është karakterizuar nga parametra normalë tregtimi gjatë muajve të parë të vitit 2022, me përjashtim të një episodi jetëshkurtër pasigurie në fillim të muajit mars, momenti i nisjes së agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës. Kursi mesatar i këmbimit i monedhës vendase ndaj Euros rezultoi mesatarisht 121.45 lekë/euro në 5-mujorin e parë të vitit 2022, duke pësuar rënie nga 123.32 lekë/euro që shënonte për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në terma vjetor, ecuria e euros në tregun vendas ka reflektuar mbiçmim të lekut prej 1.52% përgjatë janar-maj 2022. Kursi mesatar i këmbimit i monedhës vendase ndaj Dollarit Amerikan rezultoi mesatarisht 110.31 lekë/usd në 5-mujorin e parë të vitit 2022, duke shënuar rritje nga 102.31 lekë/usd që shënonte për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në terma vjetor, ecuria e dollarit amerikan në tregun vendas ka reflektuar nënçmim të lekut prej 7.82% përgjatë 5-mujorit të parë 2022.

I.2 Pritshmëritë e treguesve makroekonomikë deri në fund të vitit 2022

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) nominal pati një zgjerim të konsiderueshëm prej 8.5% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, duke shënuar vlerën 1,890.2 miliardë lekë, çka rezultoi më e fortë dhe me një bazë më të gjerë nga sa pritej, në sajë të rikthimit të fortë të shifrave të turizmit, ashtu si dhe rritjes të lartë të investimeve dhe rimëkëmbjes së konsumit privat. Kjo vjen pas recesionit të parë në Shqipëri për më shumë se dy dekada prej -3.5% në vitin 2020, ku ekonomia shqiptare dëshmoi qëndrueshmëri dhe rënia ekonomike rezultoi shumë më e përmbajtur sesa parashikimi fillestar, që varionte nga -6.1% deri në -8%. Gjithashtu edhe parametrat e tjerë më të rëndësishëm mbetën përgjithësisht të qëndrueshëm.

Pas një stimuli të lartë, të domosdoshëm dhe njëkohësisht të paevitueshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 me qëllim amortizmin e goditjeve negative (tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme do të ri-orientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që do sigurojë një nivel investimesh publike relativisht të lartë. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.

Parashikimi për vitin aktual 2022 është pozitiv dhe pritet që ekonomia të vazhdojë në ritmet pozitive të rritjes dhe pse më një normë më të përmbajtur në krahasim me vitin e kaluar, në nivelin prej 3.2%. Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të ketë një efekt të moderuar pozitiv.

Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e rëndësishëm të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë.

Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 0.9 përqind në vit gjatë viteve 2023-2025. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pothuajse të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Krahas zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, pritet që edhe produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim gradual gjatë kësaj periudhe.

II. POLITIKA FISKALE

II.1 Performanca fiskale për periudhën Janar-Maj 2022

Të ardhurat nga “Tatime dhe Dogana” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 5 mujorin 2022, u realizuan në vlerën 204.7 miliardë lekë, 22.9% ose 38.1 miliardë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021 me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 6.4% ose 12.3 miliardë lekë më shumë se plani 5 mujor për vitin 2022. Në këtë realizim kanë ndikuar faktorët të cilët do të shpjegohen në analizën specifike të secilit prej tatimeve.


Tabela 1: Të ardhurat Tatime & Dogana për periudhën Janar – Maj 2022 (në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 5 mujor 2021	Fakt 5 mujor 2022	Plan 5 mujor AN3 2022	Diferenca 2022/2021	Ndryshimi në % 2021/2020	Diferenca Fakt/ Plan 2022	Ndryshimi në % Fakt/Plan 2022
TVSH TOTAL	55,237	75,943	71,877	20,706	37.5%	4,066	105.7%
<i>Tvsh në import</i>	45,787	59,300	55,553	13,513	29.5%	3,747	106.7%
<i>Tvsh brenda vendit</i>	9,450	16,644	16,324	7,194	76.1%	320	102.0%
Rimbursim TVSH	12,349	5,580	7,043	-6,770	-54.8%	-1,463	79.2%
Tatimi mbi fitimin	15,134	20,765	14,973	5,631	37.2%	5,792	138.7%
Akciza	18,293	19,476	21,130	1,183	6.5%	-1,654	92.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	16,004	18,264	18,127	2,260	14.1%	137	100.8%
Taksa Nacional dhe të tjera	15,875	19,295	17,414	3,420	21.5%	1,881	110.8%
<i>Taksat nacionale</i>	14,820	17,409	16,170	2,589	17.5%	1,239	107.7%
<i>Renta Minerare</i>	1055	1,886	1,244	831	78.7%	642	151.6%
Taksë Doganore	2,675	3,128	2,414	453	16.9%	714	129.6%
TOTALI TATIME + DOGANA	123,218	156,871	145,935	33,653	27.3%	10,936	107.5%
Kontributet e mbledhura (DPT)	43,406	47,843	46,443	4,437	10.2%	1,401	103.0%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	166,624	204,715	192,378	38,090	22.9%	12,337	106.4%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Krahasuar me 5 mujorin 2021, performanca e të gjithë zërave të të ardhurave “Nga Tatimet dhe Doganat” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT), ka pësuar rritje. Konkretisht, TVSH 37.5%, Tatim mbi të ardhurat personale 14.1%, Tatim mbi fitimin u realizua në masën 37,2%, Akciza 6.5%, Kontributet e mbledhura nga DPT 10.2% dhe Taksat doganore 16.9%. Paraqitet me rënie kundrejt vitit 2021 rimbursimi i TVSH me 54.8% ose 6.8 miliardë më pak për shkak të ndryshimit të skemës së rimbursimeve nga Administrata Tatimore.

Grafiku 1: Totali i të ardhurave Janar- Maj 2022/2021 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 5 mujorit kundrejt planit janë:

- Rimëkëmbja graduale të ekonomisë pas tërmetit të vitit 2019 dhe situatës Covid e cila është reflektuar në realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore
- Rritja e volumit të importeve të taksuara krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.
- Implementimi i procesit të fiskalizimit dhe mirëadministrimit nga administrata tatimore.
- Rritja e çmimeve të mallrave dhe veçanërisht e mallrave kryesore si energjia elektrike, karburanteve dhe mataleve bazë duke dhënë efekt pozitiv në të ardhura.


Performanca e të ardhurave tatimore dhe doganore kundrejt planit 2022

Të ardhurat nga “Tatimet dhe Doganat” për periudhën Janar - Maj 2022 paraqiten me një realizim në masën 106.4% ose 12.3 miliardë lekë më shumë se plani i periudhës. Performanca sipas taksave paraqitet si vijon:

- Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” në total, janë realizuar në vlerën 76 miliardë lekë, 5.7% ose 4.1 miliardë lekë më shumë se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin”, janë realizuar në vlerën 20.8 miliardë lekë, 38.7% ose 5.8 miliardë lekë më shumë se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Akciza”, janë realizuar në vlerën 19.5 miliardë lekë, 7.8% ose 1.7 miliardë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale”, janë realizuar në vlerën 18.3 miliardë lekë, 0.8% ose 137 milionë lekë më shumë se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Taksat Nacionale dhe të tjera” janë realizuar në vlerën 19.3 miliardë lekë, 10.8 % ose 1.9 miliardë lekë më shumë se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Taksat Doganore” janë realizuar në vlerën 3.1 miliardë lekë, 29.6 % ose 714 milionë lekë më shumë se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” janë realizuar në vlerën 47.8 miliardë lekë, 3 % ose 1.4 miliardë lekë më shumë se plani i periudhës.

Importi i taksuar arriti në vlerën 284 miliardë lekë, ndërsa eksportet në total arritën vlerën 217 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar importi i taksuar është rritur me 59 miliardë lekë ose 26%, gjithashtu edhe eksporti total është rritur me 75 miliardë lekë ose 53%. Sipas orientimit gjeografik, vendet Europiane, veçanërisht Italia mbeten partnerët kryesorë në shkëmbimet tregtare.

Grafiku 2: Import i Taksuar dhe Eksport Total 2022/2021 (në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të Ardhurat Doganore – Të ardhurat e mbledhura nga administrata doganore për 5 mujorin e vitit 2022 janë realizuar në vlerën 83.8 miliardë lekë, 23.6% ose 16 miliardë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021, dhe 4.3% ose 3.4 miliardë lekë më shumë se plani i të ardhurave doganore për 5M 2022.


Grafiku 3: Të ardhurat Doganore për Janar- Maj 2021, mujore dhe progresive (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Kontribuesit kryesor me efekt pozitiv në të ardhurat doganore janë karburant importi me 24.6% të të ardhurave, cigaret me 13.8% të të ardhurave, metalet bazë 8.5%, energjia elektrike 4.8% të të ardhurave.

Grafiku 4: Kontribuesit kryesor në të ardhurat doganore Janar- Maj 2022/2021 (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga taksat doganore janë realizuar në vlerën 3.1 miliardë lekë, 16.9% ose 453 milionë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021, dhe 29.6% ose 714 milionë lekë më shumë se plani 5M 2022.

Të ardhurat nga akcizat janë realizuar në vlerën 19.5 miliardë lekë, 6.5% ose 1.2 miliardë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021, dhe -7.8% ose -1.6 miliardë lekë më shumë se plani. Grup-produktet me kontribut pozitiv në të ardhura, ndikim kryesor pozitiv ka pasur produkti cigare i cili rezultoi me një rritje prej 150 ton ose +14.8% me një efekt +1.2 miliardë lekë më shumë se viti i kaluar. Ndër produktet e akcizueshme që kishin ndikim negativ, ishte produkti karburant import me një rënie prej 14,3 mijë ton (-6.3%) krahasuar me një vit më parë duke sjell një efekt negativ në akcizë me -325 milionë lekë.

Tabela 2: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga Akciza/Diferencat Janar-Maj 2022/2021

	Diferencat Janar-Maj 2022/2021			milionë lekë	
	Produktet me kontribut Pozitiv			Akciza	%
	Njësia	Sasi	%		
Cigare	Ton	150	14.8%	1,198	18.8%
Karburant Prodhim Vendi	Ton	1,302	24.6%	55	28%
Pije alkoolike Import	Mije lit	201	40.7%	52	53.3%
Birrë	Mije lit	903	6.7%	46	10.4%
Efkti				1,376	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Tabela 3: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga Akciza/ Diferencat Janar-Maj 2022/2021

Diferencat Janar-Maj 2022/2021					
Produktet me kontribut Negativ					
	Njësia	Sasi	%	Akciza	%
Karburantet Import	Ton	-14,335	-6.3%	-325	-3.3%
Duhan Import	Ton	-4	-10.7%	41	-17.5%
Gaz i lëngshëm	Ton	1,689	2.6%	17	-7.3%
Kafe	Ton	-406	-11.7%	2	-1.2%
Efekti				-386	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë realizuar në vlerën 59,3 miliardë lekë, 29.5% ose 13,5 miliardë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021 dhe 6.7% ose 3,7 miliardë lekë më shumë se plani. Gjatë 5 mujorit 2022 rritja e sasisë së importuar të energjisë elektrike +167.1 mijë megaëtorë, krahasuar me vitin 2021 ka sjellë efekt +2.7 miliardë lekë në të ardhura për tvsh. Grup-produktet me kontribut pozitiv në të ardhurat nga TVSH në import rezultuan: energjia elektrike, karburant importi, metalet bazë dhe artikujt prej tyre, gazi i lëngët dhe cigarette. Automjetet e përdorura kompjuterat, telefona celularë etj, kanë dhënë efektin kryesor negativ me - 0.8 miliardë lekë.

Tabela 4: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga TVSH/Diferencat Janar-Maj 2022/2021

Produktet me kontribut pozitiv					
	Njësia	Sasi	%	TVSH/milionë lekë	%
Energji Elektrike	Megavatorë	167,139	35%	2,700	337%
Karburant Import	Ton	-14,335	-6%	2,209	35%
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	Ton	12,783	6%	2,044	51%
Gaz i lëngët	Ton	1,689	3%	791	100%
Cigaret	Ton	150	15%	356	19%
Efekti				8,100	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Tabela 5: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga TVSH/ Diferencat Janar-Maj 2022/2021

Produktet me kontribut negativ					
	Njësia	Sasi	%	TVSH/milionë lekë	%
Automjeteve te perdorura	Copë	-3,937	-15.8%	-266	-8.9%
Pc. Kompjuter printer fotokopje dhe pjeset: bojra print	Ton	-86	-11%	-262	-34.8%
Telefona celulare	Ton	-15	-64.7%	-113	-47.2%
Instrumented he aparatet fotografik dhe ato mates	Ton	-133	-15.6%	-93	-12.1%
Automjeteve te reja	Copë	-111	-10.5%	-52	-9.1%
Efekti				-786	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën 1.9 miliardë lekë, 78.7% krahasuar me vitin 2021, dhe realizim 51.6% kundrejt planit ose 642 milionë lekë më shumë. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur me 469 milionë lekë krahasuar me 2021. Rritja e të ardhurave të rentës nga nafta bruto ka ardhur si rjedhojë e rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, e cila ka sjellë efekt pozitiv krahasuar me +552 milionë lekë megjithëse sasia e eksportuar e naftës bruto ka pësuar rënie me -81 ton, me efekt -83.3 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Gjatë 5 mujorit 2022 kemi një rritje të rentës për njësi nga 3.19 lekë/ton në 5.42 lekë/ton. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rritje në masën 346 milionë lekë për shkak të rritjes së çmimit të mineraleve të eksportuar me efekt 917 milionë lekë krahasuar me 5 mujorin 2021, shoqëruar me efekt negativ -19.4 milionë lekë nga rënia e sasisë së eksportuar me 81 ton ose 9.8% më pak se viti 2021.


Tabela 6 : Të dhëna për Rentën Minerare, naftë bruto dhe minerale të tjera (në milionë lekë)

	Sasia në mijë ton				Të ardhura nga Renta në mijë lekë				Efektet		
	2021	2022	2022/ 2021	në %	2021	2022	2022/ 2021	në %	Sasi	Çmim	Efekt Total
Rentë minerare Naftë Bruto	274	248	-26	-9.5%	873	1,342	469	53.7%	-83,337	552	469
Rentë minerare Minerale të tjera	827	746	-81	-9.8%	198	544	346	174.8%	-19,379	365	346
Totali	1,102	996	-107	19.3%	1,072	1,887	815	229%	-102,716	917	815

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të Ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore (përfshirë kontributet) për 5 mujorin e vitit 2022 janë realizuar në vlerën 120.9 miliardë lekë, 22.4% ose 22.1 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe 7.9% ose 8.9 miliardë lekë më shumë se plani i vitit 2022.


Grafiku 5: Të ardhurat nga Tatimet Janar- Maj 2022, Mujore dhe Progressive (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga TVSH-ja neto brenda vendit janë realizuar në vlerën 16.6 miliardë lekë, 76.1% ose 7.2 miliardë lekë më shumë se 5 mujori i vitit 2021 dhe me një realizim të planit të periudhës në masën 102% ose 320 milionë lekë më shumë. Rimbursimi i TVSH-së krahasuar me 5 mujorin e vitit të kaluar është 54.8%, ose 6.8 miliardë lekë më pak dhe 20.8% ose 1.5 miliardë lekë më pak krahasuar me planin e vitit 2022.


Grafiku 6: Të ardhura nga TVSH dhe rimbursimi i TVSH, 5 mujori në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në vlerën 20.8 miliardë lekë, 37.2% ose 5.6 miliardë më shumë se 5 mujori 2021 si dhe 5.8 miliardë lekë ose 38.7% më shumë krahasuar me planin e vitit 2022 për Tatimin mbi Fitimin.


Grafiku 7: Të ardhurat nga Tatimi Fitimi, 5 mujori në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar 18.3 miliardë lekë, 14.1% ose 2.3 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë 2021 dhe 0.8% ose 137 milion lekë më shumë se plani i periudhës. Rritja më e madhe ka ardhur për shkak të rritjes nga të ardhurat nga tatimi mbi deklaratën individuale vjetore të të ardhurave me rritje 34% krahasuar me 5 mujorin 2021, tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme me rritje 124.7% krahasuar me 5 mujorin 2021 si dhe të ardhurat nga tatimi mbi dividendin dhe aksionet me rritje 12.8% më shumë krahasuar me 5 mujorin 2021.


Grafiku 8: Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Nga "Taksat Kombëtare" janë realizuar 17.4 miliardë lekë, 17.5% ose 2.6 miliard lekë më shumë se 5 mujori 2021 dhe 7.7% ose 1.2 miliardë lekë më shumë se plani. Rritja kryesore vjen si rezultat i rritjes në të ardhurat që mbliidhen për mjetet e përdorura të transportit me rritje 52% më shumë se 5 mujori 2021 si dhe të ardhurat që mbliidhen nga taksat për ambalazhet plastike me rritje 75% më shumë se 5 mujori 2021.


Grafiku 9: Të ardhurat 5 mujore nga Taksat nacionale, në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Të ardhurat nga “Kontributet e D.P.T-së” janë realizuar në vlerën 47.8 miliardë lekë, 4.4 miliardë lekë ose 10.2% më shumë krahasuar me 5 mujorin 2021 dhe 3% ose 1.4 miliardë lekë më shumë se plani. Rritja me vitin e kaluar në të ardhurat vjen si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve në sektorin privat, lufra kunder informalitetit me fokus deklarimi i punonjësve në skemën e sigurimeve shoqërore dhe deklarimi i pagës reale të tyre si dhe rritja e pagës minimale në shkallë vendi.

Grafiku 10: Të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT, në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

II.2 Pritshmëritë fiskale deri në fund të vitit 2022

Bazuar në performancën e 5 mujorit Janar-Maj 2022, si dhe në analizën e faktorëve që mund të impaktojnë realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore për 7 mujorin në vijim të vitit 2022, vlerësojmë se të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pritet të realizohen mbi 100%.

Ndër faktorët kryesorë të cilët do të ndikojnë në realizimin e pritshëm të të ardhurave deri në fund të vitit 2022 janë:

- ✓ *Thellimi i luftës kundër informalitetit, duke përmirësuar administrimin tatimor dhe atë doganor.*
- ✓ *Rritja e çmimimeve dhe ne veçanti e karburantit dhe energjisë elektrike në tregjet globale.*
- ✓ *Rimëkëmbja e ekonomisë pas situatës Covid 19 në vazhdimësi të vitit të kaluar.*
- ✓ *Përmirësimi i performancës së administratës tatimore në administrimin e TVSH-së së brendshme, duke nxitur vetëdeklarimin dhe kontrolluar mbi bazë risku sektorët dhe industritë që gjenerojnë këtë tatim.*
- ✓ *Ecuria pozitive e procesit të fiskalizimit nga administrata tatimore.*

III. BUXHETI I VITIT 2022

III.1 Shpenzimet e Përgjithshme Buxhetore gjatë periudhës Janar-Maj 2022

Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën 5 mujore të vitit 2022, arritën në rreth 213.4 miliard LEK me një realizim në masën 90.5 përqind të planit të periudhës ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ky zë ka rezultuar 0.6 përqind më i lartë ose 1.28 miliard LEK më shumë. Në terma vjetor, shpenzimet e përgjithshme për 5 mujorin 2022 u realizuan në masën 33.5 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 33 përqind të planit vjetor të ndryshuar sipas Aktin Normativ nr.3 datë 12.03.2022 (AN nr.3/2022).

Tabela 7: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2022 (në milion LEK)

Emërtimi	Maj 2022				Viti 2022			
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	në % mbi Plan	Plani Vjetor Buxhet Fillestar	Plani Vjetor AN nr.3	% e realizimit vjetor BF	% e realizimit vjetor AN nr.3
Të Ardhurat e Përgjithshme	218,090	233,309	15,219	107.0%	536,811	546,811	43.5%	42.7%
Shpenzimet e Përgjithshme	235,915	213,433	-22,482	90.5%	637,694	647,695	33.5%	33.0%
Shpenzimet Korente	189,490	183,259	-6,230	96.7%	507,349	501,549	36.1%	36.5%
Shpenzimet Kapitale	28,045	22,266	-5,779	79.4%	119,445	109,496	18.6%	20.3%
Deficit/Suficit	-17,825	19,876	37,701	-111.5%	-100,883	-100,883	-19.7%	-19.7%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Tabela 8: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2021 dhe 2022 (në milion LEK)

Emërtimi	Fakt Maj 2021	Maj 2022				Diferenca Fakt 2022 Fakt 2021	Rritja/Rënia në % ndaj Fakt 2021
		Plan	Fakt	Diferenca Fakt Plan 2022	Në % ndaj Plan 2022		
Të Ardhurat e Përgjithshme	191,482	218,090	233,309	15,219	107.0%	41,827	21.8%
Shpenzimet e Përgjithshme	212,153	235,915	213,433	-22,482	90.5%	1,280	0.603%
Shpenzimet Korente	175,247	189,490	183,259	-6,230	96.7%	8,012	4.6%
Shpenzimet Kapitale	36,618	28,045	22,266	-5,779	79.4%	-14,352	-39.2%
Deficit/Suficit	-20,671	-17,825	19,876	37,701	-111.5%	40,547	-196.2%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Grafiku 11: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet korente dhe ato kapitale për periudhën 5 mujore, kanë shënuar një realizim respektivisht në masën 96.7 përqind dhe 79.4 përqind të planit të periudhës. Ndërkohë që, në terma vjetorë ato janë realizuar përkatësisht në: 36.1 përqind dhe 18.6 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe 36.5 përqind dhe 20.3 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3/2022.

Shpenzimet korente për periudhën 5 mujore të vitit 2022 rezultuan në rreth 183.3 miliard LEK, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 4.6 përqind më i lartë ose rreth 8 miliard LEK më shumë.


Shpenzimet kapitale për periudhën 5 mujore të vitit 2022 paraqesin një realizim në masën rreth 22.27 miliard LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë është 39.2 përqind më i ulët ose rreth 14.35 miliard LEK më pak.

Grafiku 12: *Shpenzimet korente dhe kapitale Plan vs Fakt (në miliard LEK)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)*

Grafiku 13: *Struktura e shpenzimeve të përgjithshme, për periudhën 5 mujore 2022*




Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)*

Shpenzimet korente në raport me planin 5 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 96.7 përqind, duke rezultuar në rreth 183.3 miliard LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 5 mujor janë përkatësisht:


- ✓ shpenzimet për subvencione me 106.1 përqind të planit të periudhës dhe 26.6 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.
- ✓ shpenzimet e tjera sociale me 104.8 përqind të planit të periudhës dhe 40.1 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.
- ✓ shpenzimet për fonde speciale me 101.1 përqind të planit të periudhës dhe 38.8 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.

Grafiku 14: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Grafiku 15 : Struktura e shpenzimeve korente, për periudhën 5 mujore 2022



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet e Personelit për periudhën 5 mujore të vitit 2022, përfaqësuan 18.6 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 34.1 miliard LEK, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 5 mujore, në masën 99.1 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë është 0.3 përqind më i ulët ose 107 milion LEK më pak.


Grafiku 16: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Paga në fund të muajit të pestë të vitit 2022 u realizuan në masën rreth 29.2 miliard LEK, duke qenë 0.4 përqind më të ulëta se e njëjta periudhë e vitit 2021, ose 106 milion LEK më pak. Ndërkohë, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën 0.2 përqind më të larta se një vit më parë ose 8 milion LEK më shumë. Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku, është në nivelin 99.1 përqind krahasuar me planin e periudhës, ose 37.2 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 38.1 përqind e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3/2022.


Grafiku 17: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Interesa për periudhën 5 mujore të vitit 2022 kanë përfaqësuar 8.3 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 15.2 miliard LEK ka rezultuar në masën 94 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor fillestar dhe të ndryshuar, në nivel 5 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 29.9 përqind të tij, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë ka rezultuar 8.7 përqind më i lartë ose rreth 1.2 miliard LEK më shumë.


Grafiku 18: Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje gjatë periudhës 5 mujore të vitit 2022, kanë shënuar një realizim në masën rreth 20.2 miliard LEK ose 89.6 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 31.9 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 33.8 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ky zë ka rezultuar 0.07 përqind më i ulët ose 15 milion LEK më pak.


Grafiku 19: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të muajit të pestë të vitit 2022, arritën nivelin 412 milion LEK, me një realizim në masën 106.1 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor fillestar dhe të ndryshuar, ky zë është realizuar në masën 26.6 përqind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për subvencione rezultojnë 0.6 përqind më të ulëta ose 3 milion LEK më pak.

Grafiku 20: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet për Fondet Speciale në fund të periudhës 5 mujore të vitit 2022 rezultuan në nivelin rreth 82.3 miliard LEK, me një realizim prej 101.1 përqind kundrejt planit të periudhës dhe 38.8 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Përkatësisht:

- shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 60.4 miliard LEK,
- shpenzimet për sigurime shëndetësore u realizuan në masën rreth 20.6 miliard LEK dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve u realizuan në masën rreth 1.2 miliard LEK.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 6.5 miliard LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 981 milion LEK më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 198 milion LEK më të ulëta.

Grafiku 21: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Shpenzimet për Papunësinë për 5 mujorin e vitit 2022 janë realizuar në masën 297 milion LEK ose 88.7 përqind e planit të periudhës dhe 33.1 përqind e planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 38.2 përqind ose 184 milion LEK më pak.

Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 5 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën rreth 9.5 miliard LEK duke rezultuar 105.4 përqind e planit të periudhës ose 485 milion LEK më shumë. Në raport me planin vjetor fillestar dhe të ndryshuar, këto shpenzime janë realizuar në masën 40.2 përqind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 2.4% ose 238 milion LEK më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik për periudhën 5 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën 229 milion LEK ose 72.4 përqind të planit të periudhës dhe 22.9 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 28.1 përqind ose 90 milion LEK më pak.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 5 mujore të vitit 2022 u realizuan në masën 1.1 miliard LEK duke rezultuar 115.8 përqind e planit të periudhës ose 50 përqind e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar me AN nr.3/2022. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2021 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 8.3 përqind ose 100 milion LEK më pak.

Grafiku 22: Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet kapitale, për periudhën 5 mujore të vitit 2022 kanë një realizim në masën rreth 22.27 miliard LEK ose 79.4 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht:

- ✓ *Financimi i brendshëm ka shënuar një realizim prej rreth 8.2 miliard LEK ose 70 përqind të planit të periudhës.*
- ✓ *Investimet nga të Ardhurat e Arsimit të Lartë janë realizuar në masën 262 milion LEK ose 82.9 përqind të planit të periudhës.*
- ✓ *Financimi i huaj ka shënuar një realizim prej rreth 6.3 miliard LEK ose 69.8 përqind të planit të periudhës.*


Fondi i rindërtimit është realizuar në masën rreth 7.5 miliard LEK ose 107.6 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Nga shpenzimet për fondin e rindërtimit 3.09 miliard LEK janë shpenzime nga Qeverisja Qendrore dhe rreth 4.4 miliard LEK janë shpenzime nga Qeverisja Vendore.

Krahasuar me planin vjetor, për 5 mujorin e vitit 2022 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën 18.6 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 20.3 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3. Konkretisht:

- ✓ *Financimi i brendshëm është realizuar në masën 13.1 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 14.3 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3.*
- ✓ *Investimet nga të Ardhurat e Arsimit të Lartë janë realizuar në masën 26.2 përqind të planit vjetor fillestar dhe të ndryshuar.*
- ✓ *Financimi i huaj është realizuar në masën 18.3 përqind të planit vjetor fillestar dhe 21.1 përqind të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3.*


Fondi i rindërtimit është realizuar në masën 37.5 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.3.

Grafiku 23 Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Grafiku 24: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e shpenzimeve faktike korente dhe kapitale për periudhën 5 mujore të vitit 2022. Shpenzimet korente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve me 89.2 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale përbëjnë 10.8 përqind.


Grafiku 25: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskal të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme për periudhën 5 mujore të vitit 2022 është rreth 213.4 miliard LEK ose 90.5 përqind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një suficit buxhetor prej rreth 19.9 miliard LEK. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Grafiku 26: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficit/suficiti - Plan vs Fakt 5 Mujori 2022 (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


III.2 Financat Vendore gjatë Janar-Maj 2022

Procesi i menaxhimit të financave publike në nivel vendor ka hyrë në një fazë të re konsolidimi nën regjimin e Ligjit nr.68 datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë kuadër Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndjek vazhdimisht treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor me qëllim monitorimin dhe asistencën e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Referuar të dhënave fiskale të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë është realizuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve 5M të buxhetit vendor në nivel kombëtar.

Të ardhurat vendore

Për 5 mujorin e vitit 2022, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura në masën 14,098 milionë lekë, shifër kjo që është rreth 3.13 miliard lekë më shumë ose rreth 29 përqind më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2021. Edhe në raport me planin e periudhës shikojmë që ka një realizim më të lartë të të ardhurave të pushtetit vendor dhe ky realizim është rreth 1.1 miliard lekë ose 9% më i lartë se plani i miratuar për 5 mujorin 2021. Ky realizimi i të ardhurave vendore gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2022, tregon se buxheti vendor ka patur një performancë pozitive gjatë kësaj periudhe.


Grafiku 27: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Ndër vite, të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për 5 mujorin e parë të vitit nga *taksat lokale*, janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 78.7% të shumës totale të këtyre të ardhurave për 5 mujorin e vitit 2022. Nga ana tjetër nga *taksa e pasurisë* (ndërtesa, trualli dhe toka bujqësore) janë mbledhur 2.96 miliard lekë apo rreth 21% e totalit të të ardhurave vendore. Kurse taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël) pas ndryshimeve fiskale ligjore të cilat e kanë bërë zero (Ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, ka ardhur drejt uljes duke zënë vetëm 0.3% të të ardhurave vendore në 5 mujorin 2022 të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonësë. Nga realizimi faktik gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 38 milion lekë nga 278 milion lekë që u mbledhën një vit më parë që reflekton këtë ndryshim ligjor.

Grafiku 28: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere por edhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës mbi këtë burim financimi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë, nëse marrim në analizë 5 mujorin në vite do të kemi rezultatet si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 29: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa mbi pasurinë




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Duke analizuar në raport me një vit më parë, për 5 mujorin, nga taksa mbi pasurinë janë siguruar rreth 169 milion lekë më shumë të ardhura. Në total për 5 mujorin e vitit 2022 nga taksa mbi pasurinë pushteti vendor ka siguruar rreth 3 miliard lekë, duke shënuar një rritje me 6% të të ardhurave të kësaj takse në raport me një vit më parë, duke shënuar kështu jo vetëm përmirësim në mbledhjen e kësaj takse, por edhe nivelin më të lartë të mbledhjes së saj në vite.

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi mbi biznesin e vogël në vite si pasojë e ndryshimeve ligjore fiskale siç e theksuam më sipër, ka patur një rënie në peshën që zë në buxhetin vendor, duke ardhur drejt zerimit. Në këto kushte mund të evidentohet lehtësisht në grafikun e mëposhtëm ndryshimi në vite i këtij burimi:

Grafiku 30: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa e biznesit të vogël




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Taksat Lokale

Taksat lokale janë një ndër burimet më të rëndësishme të financimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat gjithmonë e më shumë po konsolidohen në këndvështimin financiar dhe këtë e dëshmon rritja e të ardhurave nga ky burim. Në total për vitin 2022, të ardhurat nga taksat lokale zënë rreth 78.7% të të ardhurave të veta vendore, dhe krahasur me një vit më parë, ky burim ka një rritje me 41 % ose 3.2 miliard lekë, ndryshime të cilat reflektohen në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 31: Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksat lokale



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Të ardhurat nga taksat lokale në 5 mujorin e parë të vitit 2022 kanë arritur në rreth 11.1 miliard lekë, ose rreth 3.2 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, duke shënuar kështu jo vetëm rritje në mbledhjen e kësaj takse, por edhe nivelin më të lartë të mbledhjes së taksave lokale në vite.

Vazhdimisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vënë theksi jo vetëm në mënyrën e përdorimit të fondeve publike, por edhe në rëndësinë që ka rritja e të ardhurave të veta vendore në zhvillimin cilësor të shërbimeve që ofron pushteti vendor për qytetarët. Njësitë e vetëqeverisjes vendore synojnë rikuperimin e gjendjes financiare brenda një periudhe afatmesme me qëllim rikthimin e trendit normal të të ardhurave nga burimet e veta vendore, gjë që reflektohet edhe në të dhënat e mësipërme.

Shpenzimet vendore

Shpenzimet e Pushtetit Vendor janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Ndër vite shpenzimet e pushtetit vendor janë një tregues në rritje të lehtë dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që pushteti vendor ofron për qytetarët e saj. Buxheti vendor për 5 mujorin e parë të vitit 2022, nga të dhënat faktike të thesarit rezultojn të jetë realizuar në masën 24.5 miliard lekë, rreth 4.67 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë ose rritje me 23.6%. Nga analiza e të dhënave vihet re që të gjithë zërat e shpenzimeve kanë rritje, por pjesën më të madhe të kësaj rritjeje të shpenzimeve vendore krahasuar me një vit më parë e kanë, shpenzimet operative, shpenzimet e tjera korente dhe shpenzimet kapitale. Kjo evidentohet qartë nëse këto shpenzime i analizojmë në nivel llogarie, ku pjesën më të madhe të rritjes së shpenzimeve në vlerë absolute e ka zëri i shpenzimeve kapitale, me rreth 2.7 miliard lekë më shumë ose një rritje nga viti paraardhës me rreth 67%, ndërsa në përqindje rritjen më të lartë e ka zëri i shpenzimeve të tjera korente me 191%.


Grafiku 32: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet e pushtetit vendor në vite sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qëndrueshmërisë së shpenzimeve të personelit, e shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë përmes përdorimit në formën e shpenzimeve operative. Sipas të dhënave në nivel llogarie ekonomike, struktura e shpenzimeve rezultojn si në grafikun më poshtë:

Grafiku 33: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës buxhetore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 5 mujorit të vitit 2022 dhe vitit 2021.

Tabela 9: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)

Nr	EMËRTIMI	Fakt 5 mujori		Diferenca	
		2022	2021	2022 ndaj 2021 në vlerë	2022 ndaj 2021 në %
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	14,098	10,961	3,137	129%
I.1	Taksa mbi pasurinë	2,958	2,789	169	106%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	38	278	-240	14%
I.3	Taksa Lokale	11,102	7,894	3,208	141%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	24,479	19,809	4,670	124%
II.1	Shpenzime Korente	17,730	15,759	1,972	113%
	Personeli	10,108	9,872	236	102%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	5,886	5,257	629	112%
	Subvencione	71	58	13	122%
	Te tjera	1,666	572	1,094	291%
II.2	Shpenzime Kapitale	6,749	4,050	2,699	167%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Shpenzimet e Personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësisve të veqeverisjes vendore me rreth 41%. Për 5 mujorin e vitit 2022 këto shpenzime janë realizuar në masën 10.1 miliard lekë ose rreth 236 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e një vitit më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2022, argumentohet me faktin se tashmë njësitë vendore me shtimin e kompetencave dhe funksioneve që ata duhet të ushtrojnë kanë të domosdoshëm shtimin e personelit që ofron këto shërbime, por edhe përmirësimin e politikave të pagave në NJVQV-të.

Shpenzimet Operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Këto shpenzime në 5 mujorin 2022 rezultojnë me një rritje të ndjeshme sipas të dhënave faktike të thesarit. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 24% të shpenzimeve korrente në total për 5 mujorin e parë të vitit 2022, një pjesë kjo e konsiderueshme për buxhetin njësisve të vetëqeverisjes vendore. Këto shpenzime gjatë periudhës 5 mujore 2022 janë realizuar afërsisht në masën 5.9 miliard lekë ose rreth 629 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipërme në raport me 5 mujorin e parë të vitit 2021, këto shpenzime për të njëjtën periudhë në vitin 2022 janë rritur me 22% ose 13 milion lekë për zërin subvencione. Ndërkohë, shpenzimet e tjera janë realizuar në masën rreth 1.7 miliard lekë ose rreth 1.09 miliard lekë më shumë se 5 mujori i parë i vitit 2021, që në përqindje përfaqëson edhe rritjen më të madhe të zërit të shpenzimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shpenzimet Kapitale janë një zë mjaft i rëndësishëm në buxhetin vendor, për shkak sepse këto shpenzime sjellin në mënyrë direkte dhe indirekte zhvillim ekonomik dhe për rrjedhojë ndikojnë mirëqënien e qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me një vit më parë gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2022 shpenzimet për investime janë rritur me rreth 2.7 miliard lekë ose 67% më shumë. Rritja e peshës së tyre në raport me totalin e shpenzimeve vendore përbën një shtysë të rëndësishme në angazhimin për zhvillimin infrastrukturor përmes pushtetit vendor. Sa i përket këtij treguesi për vitin 2022, raporti që zënë shpenzimet kapitale ndaj shpenzimeve totale të buxhetit vendor është rritur në 27.6% nga 20.4% që ishte në 5 mujorin e parë të vitit 2021.

Vlen të theksohet fakti që treguesit e vitit 2022, krahasuar me vitin 2021, në përgjithësi janë të gjithë në rritje si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet, duke vijuar kështu rritjen e ekonomisë në përgjithësi dhe asaj vendore në veçanti.

Fondi i rindërtimit është pjesë e shpenzimeve të buxhetit vendor që ka ndikuar gjithashtu në rritjen ekonomike të njërive të vetëqeverisjes vendore. Financimi për NJVQV për 5-mujorin 2022, ku përfshihet edhe mbartja e fondit të akorduar me VKM, por e papërdorur në vitin 2021, është 14.5 miliard lekë, ndërkohë që përdorimi deri në fund të 5 mujorit 2022 është rreth 4.9 miliard lekë. Detajimi i fondit të Rindërtimit sipas natyrës së shpenzimeve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10: Shpenzimet e fondit të rindërtimit akorduar për pushtetin vendor sipas natyrës (në milion lekë)

E M Ë R T I M I	Buxheti total 5-mujor	Fakt 5 mujori
	2022	
Fondi i Rindërtimit	14,572	4,913
<i>Shpenzime kapitale</i>	8,760	3,121
<i>Shpenzime operative e mirëmbajtjeje</i>	2,116	574
<i>Transferta për familjet dhe individët</i>	3,696	1,218

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

III.3 Fondi Rezervë, Fondi i Kontigjencës, Fondi i Rindërtimit

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2022, janë përfshirë edhe shpenzimet e realizuara nga përdorimet e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, të fondit të rindërtimit dhe të fondit të kontigjencës. Më konkretisht:

Fondi Rezervë – Ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën 2.9 miliardë lekë, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:

- 2 400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
- 500 milionë lekë për projektin për fëmijët dhe rininë.

Me AN nr.3 datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Fondi Rezerve ndryshoi në masën 2.65 miliard lekë, ndërkohë që Neni 5 përcakton përdorimin e tij:

- Fondi rezervë prej 2 650 milionë lekësh përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme.

Deri në datën 30 Qershor 2022, përdorimi ka qenë si mëposhtë (tabela analitike mëposhtë):

- Fondi Rezervë për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej 1 263.6 milionë lekësh, nga 2.65 miliardë lekë të planifikuara ose në rreth 48 përqind të planit. Nga këto:
 - ✓ 53.1 milion lekë ose 2 përqind e planit janë përdorur për shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore).
 - ✓ 1 210.5 milionë lekë ose 45.6 përqind e planit janë akorduar për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme e të jashtme).
- Gjendja e papërdorur e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në datën 30 Qershor 2022, rezulton 1 386.3 milionë lekë.

					Perdorimet e Fondit Rezerve te Buxhetit te Shtetit, per vitin 2022									
										ne 000/leke				
Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	EMERTIMI I VKM	Buxhet 2022 i ndryshuar	SIPAS ARTIKUJVE								
					2,650,000	600	601	602	604	605				
1	INSTAT	50	Nr.32, date 19.01.2022	Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2022, miratuar per Agjencine per Dialog dhe Bashkeqeverisje dhe INSTAT-in, per financimin e peogramit te Keshillimit Kombetar"	5,300	3,660	740	900						
2	ADB	87	Nr.32, date 19.01.2022	Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2022, miratuar per Agjencine per Dialog dhe Bashkeqeverisje dhe INSTAT-in, per financimin e peogramit te Keshillimit Kombetar"	19,700			19,700						
3	Min Financave dhe Ekonomise	10	Nr. 29, date 19.01.2022	Per ekzekutimin e Vendimit te Gjykates Evropiane per te Drejtit e Njeriut, dt 12.01.2021, per ceshtjen "Budokunder Shqiperise" (10 700 euro *122= 1 220 000)	1,305			1,305						
4	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	73	Nr.100, date 9.02.2022	Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2022, miratuar per komisionin qendror te zgjedhjeve, per mbulimin e shpenzimeve te organizimit te zgjedhjeve te pjesshme per organet e veteqeverisjes vendore, te datës 6 mars 2022	190,000	46,300	2,400	141,300						
5	MTM	26	Nr. 248, date 20.04.2022	Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2022, miratuar per ministrine e turizmit dhe mjedisit nga fondi rezervë i buxhetit te shtetit per vitin 2022, per pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit icsid case nr. Arb/14/26"	65,000			65,000						
6	MK	12	Nr.287, date 10.05.2022	Per nje shtese fondi ne Buxhetin e vitit 2022, miratuar per Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit "Tirana Youth European Capital, 2022"	700,000				700,000					
7	MFE	10	Nr. 290, date 11.05.2022	"Per ekzekutimin e VGJEDNJ per ceshtjen "Laci kunder Shqiperise"(10500euro)	1,319			1,319						
8	MAS	11	Nr.330, date 18.05.2022	"Per nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2022, miratuar per MAS"	160,000				160,000					
9	MPJ	15	Nr.406, date 10.06.2022	"Për dhënie ndihme humanitare nga KM i RSH, për mbështetjen e qeverisë së Ukrainës (1 milion EUR)	121,000						121,000			
TOTALI I PERDORIMEVE					1,263,625	49,960	3,140	229,525	860,000	121,000				
MBETUR PA PERDORUR					1,386,375									

Kontingjenca për Risqet e Borxhit – Ky fond prej 4 800 milionë lekë përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa. Deri në 30.06.2022, ai rezultoi i papërdorur.

Fondi i Rindërtimit – Në Ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar", në nenin 7 të tij është përcaktuar se:

"Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, prej 20 000 milionë lekë përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.

Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11 si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4 të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji."

Deri në datën 30 Qershor 2022, përdorimi i Fondit të Rindërtimit me Vendime të Këshillit të Ministrave, rezultoi si mëposhtë:

- ✓ Fondet e pashpenzuara nga viti 2021 dhe të mbartura në vitin 2022 janë 9 880 379 mijë lekë, nga të cilat:
 - 378 736 mijë lekë për Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)
 - 9 501 641 mijë lekë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV)
- ✓ Fondet e akorduara gjatë vitit 2022 janë 11 140 508 mijë lekë, nga të cilat:
 - 4 994 696 mijë lekë, shpenzime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)
 - 6 145 812 mijë lekë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NVQV).

III.4 Pritshmëria e Shpenzimeve Buxhetore deri në fund të vitit 2022

Sjellim në vëmendje se përgjatë 6-mujorit të parë Janar-Qershor 2022, ligji i buxhetit është rishikuar një herë tashmë, përmes procedurës së Aktit Normativ. Më konkretisht:

Akti Normativ nr.3 datë 12.03.2022:

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në rrethana aspak tipike për një vit buxhetor të sapo startuar, ndërmoi ndryshimin e parë të ligjit të buxhetit 2022, përmes hartimit dhe miratimit të Aktit Normativ Nr.3 datë 12.03.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Ky rishikim u përgatit si përgjigje ndaj situatës së vecante të krijuar nga kriza energjitike dhe ajo e cmimeve të karburanteve dhe mallrave të konsumit të gjere, por duke vijuar të ruaje objektivin e konsolidimit fiskal duke mbajtur të pandryshuar nivelin e deficitit buxhetor. Mbi këto baze, efektet e perballimit të krizës energjitike dhe të rritjes së cmimeve të mallrave të konsumit u përballuan nepermjet dy instrumentave; rialokimit të shpenzimeve buxhetore dhe rritjes së të ardhurave.

- *Te ardhurat e buxhetit të shtetit me këte Akt Normativ u rriten me 10 miliarde leke mbështetur në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, për 2M 2022 dhe në parashikimet për realizimin e tyre deri në fund të vitit.*
- *Shpenzimet buxhetore u rialokuan/shkurtuan në masën 16 miliarde leke, duke synuar shpenzimet jo prioritare, shpenzimet administrative dhe shpenzime të vlerësuar që mund të shtyhen në vitet në vijim.*

Konkretisht, Akti Normativ nr.3/2022 pati si synim kryesor:

- *Akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë, në shumën 20 miliardë lekë, e cila përdoret nepermjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave, në përputhje me situatën energjitike*
- *Financimin e një pakete ndihme për konsumatorët për të përballuar pasojat e rritjes së cmimeve të konsumit, nëpërmjet një fondi kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës, me kosto 6 miliardë lekë, e cila përdoret me VKM për zbutjen e efekteve të krizës aktuale, në mbështetje të:*
 - ✓ *Shtresave në nevojë, rreth 5mld lekë*
 - ✓ *Sektorit të transportit publik, rreth 0.5mld lekë*
 - ✓ *Sektorit të bujqësisë, rreth 0.5mld lekë*

Nga kjo Paketë përfituan shtresat më të vulnerabël të shoqërisë si pensionistët me të ardhura të ulta, pensionistët e vetmuar, të paafetë, familjet në ndihmë ekonomike etj. Gjithashtu kjo paketë ndihmoi sektorin e transportit publik dhe atë të mekanikës në bujqësi, për shkak të rritjes së cmimit të naftës në nivele tepër të larta e të paperballueshme.

- *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje në masën 10 miliardë lekë. Kjo rritje vjen e bazuar në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, për 2 mujin 2022.*
 - ✓ *Propozimi për këtë rritje, erdhi si rrjedhojë e një analize të mirëfilltë nga ana e MFE, e cila dëshmoi një rritje të të ardhurave si rezultat i mireadministrimit, luftës ndaj informalitetit dhe kontrollit të zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve duke u fokusuar në ato segmente dhe tatimpagues që kontribuojnë më shumë tek të ardhurat, dhe duke reflektuar në këtë mënyrë rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit tonë pas krizës dhe pasojave që shkaktoi tërmeti, shoqëruar kjo me rritjen ekonomike.*

Është me rëndësi të theksojmë se, përtej rialokimit mes zërave dhe balancimit të rritjes së shpenzimeve prioritare përmes rritjes së të ardhurave, ky akt normativ nuk preku deficitin buxhetor i cili mbeti i pandryshuar

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2022, vlerësuar mbi bazën e ecurisë dhe performancës së tyre gjatë periudhës Janar-Maj 2022, paraqesin një pritshmëri përgjithësisht në linjë me parashikimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas drejtimeve të politikave kryesore. Sidoqoftë, një parashikim më i saktë lidhur me pritshmërinë deri në fund të vitit 2022 të realizimit të shpenzimeve, sidomos investimeve publike, do të jetë i mundur vetëm pas analizës së ecurisë 9 mujore të tyre. Kjo, duke konsideruar tremujorin e fundit të çdo viti buxhetor, si periudhën me performancë më të lartë përse i përket investimeve publike në tërësi dhe atyre në infrastrukturë në veçanti

IV. BORXHI PUBLIK

Borxhi publik gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2022 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB).

Huamarrja në tremujorin e parë është realizuar në linjë me buxhetin e vitit 2022 dhe përgjithësisht në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve. Nëpërmjet burimeve të huamarrjes u mundësua refinancimi i borxhit ekzistues, si edhe financimi i deficitit të planifikuar për vitin 2022. Gjatë këtij tremujori nevojat për huamarrje kanë qenë pothuajse në të njëjtin nivel me tremujorin e vitit 2021.


Gjatë periudhës janar-mars 2022, menaxhimi i borxhit ka vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të mëtejshëm të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston nën kontroll. Një përpjekje e tillë, në vite atipike të nevojave të larta për financim nuk është e lehtë të realizohet. Përmirësimi i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të refinancimit dhe riskut të normave të interesit do vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë tremujorit të parë 2022 është vijuar me praktikën që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it.

IV.1 Stoku i Borxhit Publik

Në fund të muajit mars 2022, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,399.2 miliard Lekë ose 69.6% e PBB . Në terma nominal, stoku i borxhit publik është rritur me rreth 16.2 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2021, nga të cilat 4.0 miliard Lekë i korrespondojnë borxhit të brendshëm dhe 12.2 miliard Lekë borxhit të jashtëm. Në vitet në vijim, duke filluar nga ky vit, raporti i borxhit publik ndaj PBB do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45% e PBB.


Grafiku 34: Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2017–Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit publik janë përkatësisht rreth 50.5% dhe 49.5%, duke ruajtur pothuajse të njëjtin raport si në fund të vitit 2021. Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se gjysmën e peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, abond), ndjekur nga huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve dhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore. Borxhi i pushtetit lokal vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta (rreth 286.6 milion Lekë), kryesisht për shkak të kapaciteteve të ulëta që kanë njësitë e qeverisjes vendore për të akumuluar borxh të ri. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 nuk ka pasur asnjë kërkesë nga njësitë e qeverisjes vendore për huamarrje të re

Grafiku 35: Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me totalin (2017-Mars 2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2022 portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të dominohet me mbi 50% nga titujt shtetërorë të tregtuar në tregun vendas, në përputhje me objektivat strategjikë për mbajtjen nën kontroll të riskut të kursit të këmbimit.


Grafiku 36: Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2017–Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Për sa i përket kompozimit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve afatgjatë ka pësuar një rritje të lehtë në krahasim me atë të fundit të vitit 2021. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar edhe përgjatë këtij tremujori, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.


Grafiku 37: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2017-Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Ndërkohë, për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme (p.sh. Eurobond-i), peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë kreditë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Grafiku 38: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit & instrumenteve (2017-Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

IV.2 Menaxhimi i Borxhit

Huamarrja gjatë tremujorit të parë 2022 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2022. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua refinancimi i borxhit ekzistues, si edhe financimi i deficitit të planifikuar për vitin 2022. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 119.6 miliard Lekë, nga të cilat 92.8% (ose 111.0 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 7.2% (ose 8.6 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Huamarrja e Brendshme

Gjatë periudhës janar-mars 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 111 miliard Lekë, nga të cilat 69.9 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe 41.1 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatgjatë. Huamarrja ka shërbyer totalisht për refinancimin e titujve ekzistues ndërkohë që financimi neto ka rezultuar në vlerën -1.8 miliard Lekë.


Tabela 11: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto & neto (Janar-Mars 2022)

Lloji i Titullit	TM1 2022		
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)
Tituj Afatshkurtër	69.9	72.7	-2.7
Bono Thesari në Lekë	69.9	72.7	-2.7
Tituj Afatgjatë	41.1	40.1	1.0
Obligacione 2 vjeçare	13.6	11.9	1.6
Obligacione 2 vjeçare në Euro	0.0	0.0	0.0
Obligacione 3 vjeçare	10.0	18.2	-8.2
Obligacione 5 vjeçare	6.3	6.5	-0.2
Obligacione 7 vjeçare	3.5	3.5	0.0
Obligacione 10 vjeçare	5.5	0.0	5.5
Obligacione 15 vjeçare	2.3	0.0	2.3
Gjithsej Tituj Shtetërorë	111.0	112.8	-1.8

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Për sa i përket raportit të huamarrjes së brendshme me të ardhurat tatimore vërehet një rënie e konsiderueshme e këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, i ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit të të ardhurave, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku masat e marra kundrejt përhapjes së pandemisë në vend, impaktuan në mënyrë të menjëhershme treguesin e të ardhurave tatimore.

Grafiku 39: Huamarrja e brendshme në raport me të ardhurat tatimore (TM. I 2017-TM. I 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Huamarrja e Huaj

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2022, huamarrja e huaj u realizua në nivelin 8.6 miliard Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, huamarrja e huaj është ulur me rreth 15.5 miliard Lekë, duke qenë se për vitin 2022 disbursimet për mbështetje buxhetore planifikohen më të ulëta se në vitin 2021. Mbi 50% e huamarrjes së huaj bruto është realizuar nga disbursimi i huave në formën e mbështetjeve buxhetore, dhe pjesa tjetër për projekte, kryesisht nga projekte të transportit, ndjekur nga sektori i infrastrukturës urbane dhe ai i ujësjellës kanalizimeve.

Tabela 12: Huamarrja e huaj në terma bruto (TM. I 2021-TM. I 2022)


Huajamarrja e Huaj Bruto	TM1 2021		TM1 2022	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Kredi për financim projektsh	4.7	19.4%	3.4	39.9%
Energjia	0.6	2.6%	0.1	1.0%
Transporti	1.8	7.3%	2.2	25.9%
Ujësjellës Kanalizime	1.4	5.9%	0.4	4.5%
Infrastruktura Urbane	0.6	2.6%	0.0	0.0%
Të Tjera	0.3	1.1%	0.7	8.5%
Mbështetje Buxhetore	19.4	80.6%	5.2	60.1%
Eurobond	0.0	0.0%	0.0	0.0%
Total Huamarrja e Huaj	24.1	100.0%	8.6	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Kostot

Kosto për njësi e portofolit të borxhit shtetëror ka vazhduar të ulet edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit 2022, kryesisht si rezultat i normave të interesit në nivele ende të ulëta, shoqëruar me rifinancimin e borxhit që maturohet (kryesisht atij afatgjatë) me borxh më pak të kushtueshëm. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2021, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 1.4 miliard Lekë më të larta, kjo për shkak të një niveli të rritur të stokut të borxhit. Ndërsa në terma relativë, treguesi i interesave të paguara kundrejt të ardhurave tatimore, ka pësuar rënie në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2021 si rezultat i rritjes së të ardhurave tatimore krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2021.


Grafiku 40: Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (TM1 2017-TM1 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Nga ana tjetër, kosto mesatare e borxhit të brendshëm shtetëror është ulur nga 3.53% në fundin e vitit 2021, në 3.50% në Mars 2022.

Grafiku 41: Jetëgjatësia & kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm shtetëror (2017-Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Risqet

Gjatë periudhës janar-mars 2022, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit shtetëror nuk ka mundur të evoluojë plotësisht në drejtim të objektivave strategjike afatmesëm. Jetëgjatësia e borxhit është rritur me 54 ditë duke prekur nivelin e 847 ditëve në fund të muajit mars 2022 krahasuar me 793 ditë në muajin dhjetor 2021. Ndërkohë, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është rritur krahasuar me fundin e vitit 2021, përkatësisht nga 46.6% në dhjetor 2021 në 47.3% në mars 2022, për shkak të vlerës së lartë (rreth 20 mld Lekë) të titujve referencë 3 vjecare që do maturohen në tremujorin e parë të vitit 2023. Për sa i përket riskut të normave të interesit, është rritur koha mesatare në rifiksion nga 2.19 vite në dhjetor 2021 në 2.33 vitë në muajin mars 2022.

Tabela 13: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2021–Mars 2022)

Treguesi i riskut	2021	Mar-22
Koha Mesatare ne Maturim (në vite)	2.20	2.35
Pesha e Instrumenteve qe maturohen brenda nje viti	46.61%	47,34%
Borxh i rivlersuar ne nje vit	48.0%	48.7%
Koha Mesatare ne rifiksion (në vite)	2,19	2,33

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)


Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar-mars të vitit 2022 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, kryesisht në 2 muajt e parë të vitit 2022, ndërkohë në muajin mars tregu u ndikua nga efektet e konfliktit Rusi-Ukrainë dhe prithsmëritë në rritje për normat e interesit. Pavarisht kësaj, gjatë tremujorit të parë të vitit ka vijuar emetimi i titujve reference 3 dhe 5 vjecare në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të projektit Market Maker.

Ecuria e ankandëve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë periudhës janar-mars 2022 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 140.0 miliard Lekë, nga të cilat 80.5 miliard Lekë për bono thesari dhe 59.5 miliard Lekë për obligacione. Kërkesa gjatë këtij tremujori ka qenë më e lartë se oferta e qeverisë gjatë muajit janar dhe shkurt, ndërkohë në muajin mars është vënë re një rënie e kërkesës për tituj qeveritar, e ndikuar kryesisht nga prithshmëria për rritje të normave të interesit gjatë vitit 2022.

Grafiku 42: Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Mars 2022)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Nga pikëpamja e investitorëve, baza e investitorëve, vijon të jetë e përqëndruar në mbi 60% tek sektori bankar duke e bërë portofolin e borxhit të brendshëm të ndjeshëm ndaj risqeve sistemike që mund të paraqesë ky sektor. Struktura e tregut primar të titujve ka vijuar të konsolidohet nëpërmjet strategjisë e cila synon emetimin e titujve referencë, si shtysë për zhvillimin e tregut sekondar në të ardhmen. Në këtë drejtim, gjatë tremujorit të parë është vijuar me emetimin e obligacioneve 3 dhe 5 vjeçare referencë.

Ecuria e normave të interesit

Normat mesatare të ponderuara gjatë T1 2022 kanë shënuar ulje krahasuar me fundin e 2021. Instrumentat afatshkurtër, si edhe obligacionet 2VJ, 5VJ dhe 15VJ kanë pësuar një ulje të lehtë të normës mesatare të ponderuar, ndërkohë që Yield-et mesatare të ponderuara të instrumenteve me maturitet 3VJ, 7Vj dhe 10Vj kanë qenë më të larta se vitin e kaluar. Ndërkohë, normat e interesit në çdo ankand të titujve shtetërorë kanë shënuar rritje gjatë T1 2022, krahasuar me fundin e 2021, ndikuar nga pasiguritë e shkaktuara në vend si rezultat i pasojave të shkaktuara nga keonflikti Rusi-Ukrainë, si edhe nga deklaratat në tregjet e huaja për rritje të normave të interesit. Pritshmëritë për rritjen e normave të intersit u forcuan më shumë pas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që më datë 23 Mars vendosi të rrisë normën bazë për herë të parë pas 10 vjetësh, duke e çuar në 1% nga 0.5%.

Grafiku 43: Norma mesatare e ponderuar e titujve shtetërorë³ (Shtator 2021 - Mars 2022)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

³ I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.

IV.3 Pritshmëritë e Borxhit për vitin 2022

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë Covid-19, dhe ndikimit të konfliktit Rusi-Ukrainë, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostos.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër do të synohet kryesisht rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet.

Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit.

Financimi i huaj do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit.

V. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka nisur monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente.

Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente.

Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit Afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori risqesh:

- *“Eksplícite”, Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.*
- *“Implícite”, kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.*

Tabela 14: Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet eksplicite	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet implicite dhe detyrimet kontigjente	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Gjatë vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi monitorimin e risqeve kryesore fiskale/buxhetore, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.1 datë 10.01.2022 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022" dhe Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".


Kryesisht, raportimi në adresë të MFE u kanalizua përmes skeduleve kohore strikte dhe formateve standarde të miratuara, një proces tashmë i institucionalizuar për monitorimin e risqeve, krahas intensifikimit të punës në drejtim të rritjes së cilësisë së përpunimit, raportimit dhe publikimit të informacionit të grumbulluar, me synim final:

- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të performancës financiare të ndërmarrjeve kryesore shtetërore;
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme;
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë mujore, të performancës së kontratave konçesionare/PPP, me mbështetje buxhetore.

Mëposhtë jepet një tablo e vlerësimeve mbi disa nga tipologjitë e risqeve fiskale, si rezultat i monitorimit nga njësitë përgjegjëse në MFE, për periudhën Janar-Maj 2022:

V.1 Ndërmarrjet shtetërore

Grafiku 44: Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve Burimi: INSTAT (2022)



Në zbatim të Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, specifikisht nenit 4/2 sipas së cilit: “...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave...” dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1/2022 “Për zbatimin e

Buxhetit të vitit 2022”, MFE monitoron dhe përgatit periodikisht mbi baza tremujore, analizat financiare të performancës së NSH-ve kryesore bazuar në potencialin e tyre për të ndikuar në financat dhe buxhetin e shtetit. Monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit energjetik, që është thelluar në kuadër të reformës të këtij sektori. Këto raporte analitike, të cilat përgatiten rregullisht në baza tremujore, bëhen pjesë/publikohen në të gjitha raportet periodike të MFE/DMB, si Buxheti Faktik, Raporti i Mesvitit, dhe Projektbuxheti.

Gjatë vitit 2022, FRU ka zgjeruar procesin e monitorimit të Ndërmarrjeve Shtetërore dhe ka mbledhur të dhëna financiare nga Albgaz sh.a, Albcontrol sh.a, UKT sh.a (Ujësjetllës Kanalizime Tiranë), UKD (Ujësjetllës Kanalizime Durrës), Posta Shqiptare sh.a, Hekurudhat Shqiptare sh.a dhe RTSH sh.a (Radio Televizioni Shqiptar), duke analizuar të dhënat përkatëse financiare. Mëposhtë paraqitet performanca financiare e pesë ndërmarrjeve shtetërore, për T1 2022:

➤ Performanca financiare e UKT sh.a.

Në fund të 2021, për UKT sh.a (Ujësjetllës Kanalizime Tiranë) niveli i të ardhurave ishte 4,347 milion LEK dhe shpenzimet 3,461 milion LEK, duke regjistruar një fitim neto pozitiv prej 886 milion LEK. Ky trend pozitiv vazhdoi dhe në T1 2022, ku të ardhurat e UKT sh.a arritën në 1,015 milion LEK ndërsa totali i shpenzimeve ishte 816 milion LEK. Kjo tregon një vazhdimësi të ecurisë pozitive të kompanisë ku fitimi neto për periudhën rezuloi rreth 199 milion LEK.

Tabela 15: Të dhënat financiare për UKT sh.a (2020 – T1 2022) (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	2020	T1 2021	2021	T1 2022
Të ardhurat	3,903,002	983,149	4,347,387	1,014,607
Shpenzimet	3,537,874	807,654	3,461,223	815,963
Humbje/Fitim	365,128	175,495	886,165	198,644
Aktivitet Afatshkurtra	5,848,201	5,702,996	5,943,437	5,651,363
Aktivitet Afatgjata	20,501,194	20,542,550	21,334,917	21,601,921
Total Aktive	26,349,395	26,245,546	27,278,354	27,253,284
Detyrimet Afatshkurtra	8,401,274	7,896,755	8,544,381	8,461,014
Detyrimet Afatgjata	8,028,275	8,261,064	7,927,963	7,802,181
Total Detyrime	16,429,549	16,157,819	16,472,344	16,263,195
Kapital	9,919,846	10,087,727	10,806,011	10,990,090

Burimi: UKT sh.a.

➤ *Performanca financiare e Hekurudhës Shqiptare sh.a.*

Në fund të vitit 2021, Hekurudha Shqiptare nëpërmjet pasqyrave financiare ka raportuar se të ardhurat arritën në 587 milion LEK, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në masën 1,014 milion LEK. Shoqëria regjistroi një humbje neto prej 427 milion LEK për vitin 2021. Sipas raportimit për T1 2022, të ardhurat nga hekurudhat shqiptare arritën në 104 milion LEK, ndërsa shpenzimet e përgjithshme 221 milion LEK. Ndërmarrja ka vazhduar të ketë një trend negativ me një humbje neto prej 118 milion LEK, por krahasuar me vitin 2021 vihet re tendenca e uljes së shpenzimeve.

Tabela 16: Të dhënat financiare për Hekurudha Shqiptare sh.a (2020 – T1 2022) (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	2020	T1 2021	2021	T1 2022
Të ardhurat	632,374	143,229	586,655	103,506
Shpenzimet	2,687,612	256,829	1,013,804	221,178
Humbje/Fitim	(2,055,238)	(113,600)	(427,149)	(117,672)
Aktivet Afatshkurtra	371,760	366,116	373,301	519,245
Aktivet Afatgjata	80,748,980	80,645,012	80,422,273	80,323,161
Total Aktive	81,120,740	81,011,128	80,795,573	80,842,406
Detyrimet Afatshkurtra	959,306	962,734	1,026,315	1,190,351
Detyrimet Afatgjata	1,649,856	1,650,416	1,694,432	1,694,901
Total Detyrime	2,609,162	2,613,150	2,720,747	2,885,252
Kapital	78,511,578	78,397,978	78,074,827	77,957,154

Burimi: Hekurudha Shqiptare sh.a.

➤ *Performanca financiare e AlbGaz sh.a.*

Në fund të vitit 2021, AlbGaz raportoi të ardhura në rreth 163 milion LEK dhe shpenzime në rreth 198 milion LEK. Në fund të vitit 2021 raportohet një humbje neto prej 35 milion LEK për shoqërinë, duke treguar kështu një performancë të dobët për periudhën. Për T1 2022 shoqëria AlbGaz sh.a raportoi të ardhurat në vlerën rreth 104 milion LEK, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 38 milion LEK. Shoqëria rezultoi me një fitim neto prej 66 milion LEK, me një trend pozitiv krahasuar me vitin e kaluar.

Tabela 17: Të dhënat financiare për AlbGaz sh.a (2020-T1 2022) (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	2020	T1 2021	2021	T1 2022
Të ardhurat	145,044	313	162,587	104,402
Shpenzimet	170,209	37,492	197,657	38,348
Humbje/Fitim	(25,165)	(37,179)	(35,070)	66,054
Aktivet Afatshkurtra	188,432	151,023	255,294	329,661
Aktivet Afatgjata	688,986	688,240	714,965	713,930
Total Aktive	877,418	839,262	970,259	1,043,592
Detyrimet Afatshkurtra	79,163	78,499	40,171	48,103
Detyrimet Afatgjata	607,603	607,290	774,507	773,854
Total Detyrime	686,767	685,790	814,678	821,957
Kapital	190,651	153,472	158,581	221,635

Burimi: AlbGaz sh.a.

➤ *Performanca financiare e Albcontrol sh.a.*

Të ardhurat e AlbControl në fund të vitit 2021 ishin 2,777 milion LEK, ndërkohë shpenzimet 2,264 milion LEK. Shoqëria regjistroi një fitim neto prej 513 milion LEK për vitin 2021. Për T1 2022, të ardhurat e AlbControl sh.a ishin në vlerën prej 630 milion LEK ndërsa shpenzimet në total ishin në vlerën prej 523 milion LEK. Albcontrol Sh.a ka vazhduar të ndjekë trendin pozitiv të fundvitit 2021 duke regjistruar një fitim neto për T1 2022 në një vlerë prej rreth 107 milion LEK.

Tabela 18: Të dhënat financiare për Albcontrol sh.a (2020-T1 2022) (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	2020	T1 2021	2021	T1 2022
Të ardhurat	1,721,796	304,609	2,777,397	629,966
Shpenzimet	2,273,054	483,760	2,263,931	522,827
Humbje/Fitim	(551,258)	(179,151)	513,466	107,139
Aktivet Afatshkurtra	1,978,366	1,893,376	3,325,735	3,876,514
Aktivet Afatgjata	5,464,013	5,368,346	4,843,166	4,660,898
Total Aktive	7,442,379	7,261,722	8,168,901	8,537,412
Detyrimet Afatshkurtra	781,692	570,246	1,095,950	1,364,628
Detyrimet Afatgjata	150,050	359,990	38,572	31,265
Total Detyrime	931,742	930,236	1,134,522	1,395,893
Kapital	6,510,637	6,331,486	7,034,380	7,141,519

Burimi: Albcontrol sh.a.

➤ Performanca financiare e RTSH sh.a.

Për T1 2022 të ardhurat e RTSH sh.a kapën vlerën rreth 538 milion LEK, ndërsa shpenzimet arritën në vlerën prej 483 milion LEK, duke rezultuar me një fitim neto prej 55 milion LEK. Kundrejt vitit 2021 kur shoqëria regjistroi një humbje neto prej 461 milion LEK, gjatë fillimit të 2022 vërehet një përmirësim i treguesve.

Tabela 19: Të dhënat financiare për RTSH sh.a (2020-T12022) (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	2020	T1 2021	2021	T1 2022
Të ardhurat	2,075,073	513,410	2,109,207	537,925
Shpenzimet	2,284,627	461,819	2,570,379	482,599
Humbje/Fitim	(209,554)	51,591	(461,173)	55,326

Burimi: RTSH sh.a.

V.1.1 Ndërmarrjet shtetërore – Sektori Energjetik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH Sh.a, OSHEE Group Sh.a dhe OST Sh.a. Projektet e investimeve me financim të huaj për Sektorin e Energjisë për vitin 2022, u miratuan në nivelin 2.1 miliardë LEK sipas buxhetit fillestar dhe Aktit Normativ nr.3 datë 12.03.2022. Gjatë 4M I 2022, sektori energjetik është përballur me një situatë jo të favorshme në terma financiarë, një vazhdimësi kjo e fund-vitit 2021, si pasojë e situatës jo të mirë meteorologjike në vend e cila ka ulur nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a. Mosplotësimi i planit të furnizimit me energji elektrike si pasojë e motit të thatë ka detyruar KESH sh.a të plotësojë këtë mungesë me blerje në tregun e lirë. Ndikim në sektor kanë patur dhe goditjet që tregjet evropiane të energjisë pësuan përgjatë kësaj periudhe si pasojë e konfliktit në Ukrainë dhe rritjes së paparashikuar eksponenciale të çmimit të energjisë në Tregun e Lirë. Për rrjedhojë, KESH sh.a si pasojë e motit të thatë është detyruar të plotësojë këtë mungesë në prodhim me blerje në tregun e lirë, duke ndikuar negativisht kjo në një ulje të performancës financiare të shoqërisë dhe duke sjellë mungesë likuiditeti për të. Krahasuar me 4M I 2021 vërehet se:

- Niveli i përgjithshëm i prodhimit vendas është ulur me rreth 37.6 përqind krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë.
- Prodhimi neto vendas është vetëm 2.71 TËh krahasuar me të njejtën periudhë të vitit të kaluar ku prodhimi neto vendas ka qenë rreth 4.34 TËh.
- Konkretisht, gjatë 4M 2022, KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 1.25 TËh, krahasuar me 2.41 TËh realizuar në të njejtën periudhë të vitit të kaluar, një ulje kjo prej rreth 48.2%.

- Ky është një tregues përkeqësimi i konsiderueshëm që tregon që deri në 4M e vitit 2022 situata hidrike nuk është në kushte shumë të favorshme. Për pasojë, pritet një përkeqësim i situatës financiare për KESH sh.a, e cila është larg arritjes për të siguruar furnizimin e një viti normal prej 3.85 TËh.
- Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ato rezultuan në nivelin 22.81 përqind për 4M 2022, duke shënuar një rënie të mëtejshme të nivelit të humbjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku humbjet figuruan në nivelin 23.91 përqind.
- Niveli i arkëtimeve për 4M 2022 arriti vlerën prej 91.9 përqind, relativisht e pandryshuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, e cila dëshmon stabilitetin e operatorit në këtë drejtim.

Nisur nga treguesit e parashtruar sa më sipër, ku ndër më kyesorët që kanë ndikuar në performancën e sektorit janë, ulja e nivelit të prodhimit të energjisë vendase dhe përshkallëzimi i krizës globale energjitike shkaktuar nga konflikti në Ukrainë, nëpërmjet VKM nr.256 datë 04.29.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr.584 datë 8.10.2021 “Për Shpalljen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, Këshilli i Ministrave vendosi ndryshimin e kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike deri më 31 Dhjetor 2022. Kjo, me qëllim vazhdimin e mbështetjes nga buxheti i shtetit së këtij sektori gjatë kësaj periudhe, duke asistuar kështu KESH sh.a. në blerjen e energjisë elektrike në tregun e lirë për të plotësuar mangësitë në prodhim.

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike, për vitin 2022, vlerësohet në rreth 6 miliardë LEK për T1 2022 nga rreth 5.5 miliardë LEK në vitin 2021, duke treguar një përkeqësim të gjendjes së detyrimeve. Kjo situatë është ndikuar nga kushtet e pafavorshme atmosferike që ulën ndjeshëm nivelin e prodhimit dhe gjithashtu prej rritjes të paparashikuar eksponenciale të çmimit të energjisë në Tregun e Lirë (kriza globale e energjisë) që për rrjedhojë ndikuan negativisht në performancën financiare të kompanive të sektorit energjitik.

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 datë 30.09.2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, nëpërmjet së cilit, ndërmarrjet e sektorit energjitik raportojnë në mënyrë periodike mujore, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërsjella ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Përgjatë vitit 2022, në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, MFE ka monitoruar periodikisht mbi bazë mujore detyrimet e ndërsjella të raportuara nga ndërmarrjet e sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Në nivel 5M vërehet një trend rritës i detyrimeve të ndërsjella. Nga ana e ndërmarrjeve raportohet se, mos shlyerja e detyrimeve të ndërsjella në kohë ka ardhur si pasojë e situatës jo të mirë financiare të tyre, rrjedhojë kjo edhe e paqëndrueshmërisë ekonomike të tregjeve globale. Mëposhtë jepet një tablo e detyrimeve të ndërsjella, të regjistruara deri në Maj 2022

Tabela 20: Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjitik, ML/IB, MFE dhe DPT:

Deri në 31 Maj 2022 (në mld LEK)	KESH	OST	OSHEE	MFE	DPT	Total
KESH ndaj:		0**		18.41	0.01	18.42
OST ndaj:	6.9*		1.03	14.93		22.86
OSHEE ndaj:	53.70	19.39		4.60	6.70	84.40
Ndërmarrjet UK ndaj:			22.71		0.76	23.47
ML/IB			5.50			5.50
Total	60.60	19.39	29.24	37.94	7.47	154.65

Burimi: KESH, OST, OSHEE Group, AKUM, 2022

*Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 6.9-7.36 mld LEK, per shkak të mosrakovitit mes kompanive.

**Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 0-0.621 mld LEK, per shkak të mosrakovitit mes kompanive.

Lidhur me detyrimet e mësipërme, vërehet se:

- Totali i detyrimeve të ndërsjellta që KESH sh.a ka deri në fund të muajit Maj 2022 ndaj palëve të treta rezulton në një shumë totale progresive 18.42 miliardë lekë, një rritje kjo me 1.6% krahasuar me totalin e detyrimeve të ndërsjella që KESH sh.a ka patur ndaj palëve të treta deri në fund të 2021 (18.13 mld lekë).
- Totali i detyrimeve të ndërsjella që OST sh.a ka deri në fund të muajit Maj 2022 ndaj palëve të treta rezulton në një shumë totale progresive 22.86 miliardë lekë, një rritje kjo me 3.3% krahasuar me totalin e detyrimeve të ndërsjella që OST sh.a ka patur ndaj palëve të treta deri në fund të 2021 (22.13 mld lekë).
- Totali i detyrimeve të ndërsjella që OSHEE Group sh.a ka deri në fund të muajit Maj 2022 ndaj palëve të treta rezulton në një shumë totale progresive 84.40 miliardë lekë, një rritje kjo me 10.3% krahasuar me totalin e detyrimeve të ndërsjella që OSHEE Group sh.a ka patur ndaj palëve të treta deri në fund të vitit 2021 (76.55 miliardë lekë).
- Totali i detyrimeve të ndërsjella që Ndërmarrjet UK sh.a kanë deri në fund të muajit Maj 2022 ndaj palëve të treta rezulton në një shumë totale progresive 23.47 miliardë lekë, një rritje kjo me 7.2% krahasuar me totalin e detyrimeve të ndërsjella që Ndërmarrjet UK sh.a kanë patur ndaj palëve të treta deri në fund të vitit 2021 (21.90 miliardë lekë).
- Totali i detyrimeve të ndërsjella që Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore kanë deri në fund të muajit Maj 2022 ndaj palëve të treta rezulton në një shumë totale progresive 5.5 miliardë lekë, duke rezultuar me të njëjtin nivel me detyrimet e ndërsjella deri në fund të vitit 2021.
- Totali i detyrimeve të prapambetura të ndërsjellta në fund të muajit Maj 2022, krahasur me vitin 2021, ka patur një trend rritës.

Të Dhëna Financiare për Sektorin Energjetik

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.1/2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë. Bazuar në të dhënat më të fundit të raportuara pranë MFE-së për T1 2022, mëposhtë paraqitet performanca financiare e tre ndërmarrjeve të sektorit energjetik (KESH sh.a, OSHEE Group sh.a dhe OST sh.a) mbi bazë krahasimore për të njëjtat periudha pararendëse:

➤ Performanca financiare e Sektorit Energjetik.

Tabela 21: Të dhënat financiare 3 mujore për Sektorin Energjetik (në mijë LEK)

	T1 2020	T1 2021	T1 2022 ⁴
Të ardhurat	18,580,708	23,864,065	32,210,088
Shpenzimet	21,661,885	23,016,261	35,122,675
Humbje/Fitim	(3,081,176)	847,804	(2,912,587)

Burimi: OSHEE Group, OST, KESH sh.a.

➤ Performanca financiare e OSHEE Group sh.a.


Tabela 22: Të dhënat financiare 3 mujore për OSHEE Group sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	T1 2020	T1 2021	T1 2022
Të ardhurat	15,367,773	16,372,799	20,188,305
Shpenzimet	16,366,384	16,095,026	20,543,688
Humbje/Fitim	(998,611)	277,773	(355,383)

Burimi: OSHEE Group sh.a.


⁴ Të dhënat financiare për OSHEE Group sh.a, për 3- mujorin 2022, janë paraprake (jo finale) të përcjella nga kompania.

Grafiku 45: Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Grafiku 46: Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

➤ Performanca financiare e KESH sh.a.

Tabela 23: Të dhënat financiare 3 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	T1 2020	T1 2021	T1 2022
Të ardhurat	1,330,726	5,585,454	9,251,120
Shpenzimet	1,616,076	5,118,573	11,695,287
Humbje/Fitim	(285,350)	466,881	(2,444,167)
Aktivet Afatshkurtra	77,437,596	83,517,089	80,613,342
Aktivet Afatgjata	90,334,171	91,549,285	91,820,953
Total Aktive	167,771,767	175,066,373	172,434,296
Detyrimet Afatshkurtra	58,633,350	68,070,490	64,792,559
Detyrimet Afatgjata	33,201,684	31,157,917	28,711,413
Total Detyrime	91,835,034	99,228,408	93,503,972
Kapital	75,936,733	75,837,966	78,930,323

Burimi: KESH sh.a.

➤ Performanca financiare e OST sh.a.

Tabela 24: Të dhënat financiare 3 mujore për OST sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	T1 2020	T1 2021	T1 2022
Të ardhurat	1,882,209	1,905,813	2,770,662
Shpenzimet	3,679,425	1,802,663	2,883,700
Humbje/Fitim	(1,797,216)	103,150	(113,037)
Aktivet Afatshkurtra	18,574,275	21,498,065	18,223,864
Aktivet Afatgjata	53,874,419	54,073,729	63,760,203
Total Aktive	72,448,694	75,571,795	81,984,067
Detyrimet Afatshkurtra	21,201,268	23,186,705	28,336,816
Detyrimet Afatgjata	21,116,985	19,001,032	19,830,925
Total Detyrime	42,318,253	42,187,738	48,167,741
Kapital	30,130,440	33,384,057	33,816,326

Burimi: OST sh.a.

V.1.2 Ndërmarrjet shtetërore – Sektori i Ujësjellës-Kanalizimeve

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes Sektorit të Monitorimit të Risqeve, ka monitoruar disa tregues kryesorë financiarë të ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizimeve. Treguesit kryesorë të performancës për T1 2022 për ndërmarrjet e U-K të analizuar, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korente dhe të prapambetura, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër, krahasuar me vitin 2021. Impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K patën edhe pasojat nga pandemia COVID19. Ndërkohë, në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, është planifikuar fondi prej 360 milion LEK, alokuar në strukturën buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili detajohet nga AKUM/MIE bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve...”, miratuar nga Ministri përgjegjës për Infrastrukturën dhe Energjinë. Ky subvencion akordohet për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë kostot/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes.

Një problematikë e rëndësishme mbetet edhe stoku i detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet U-K sh.a ndaj sektorit të energjisë. Vlen për t’u theksuar se, në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, si ndërmarrjet U-K, MIE dhe ndërmarrjet e energjisë. Plani i masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me Urdhërin e Përbashkët MIE/MFE nr.304/2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, përfshin në procesin e shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella edhe sektorin e ujit. Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, MIE dhe MFE, bashkëfirmosën Urdhërin e dytë të Përbashkët nr.379/2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”. Urdhëri i sipërcituar krahas ndërmarrjeve të sektorit energjitik, ngarkon edhe AKUM për raportimin mujor, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe statusin e tyre. Kështu, për periudhën deri në Mars 2022, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) pas rakordimit të të dhënave me OSHEE Group Sh.a, raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën 22.71 miliardë LEK. Sipas të njëjtit raportim, 12.19 miliard LEK janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe 10.52 miliard LEK janë detyrime për kamatëvonesa. Nga totali i detyrimeve të raportuara, vetëm ndërmarrja e UK sh.a Durrës ka 7.47 miliard LEK detyrime të akumuluar në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve ndaj OSHEE sh.a.

Tabela 25: Stoku i detyrimeve të prapambetura të UK ndaj OSHEE Group sh.a (në mld LEK)

5 UK kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group	14.01
Durrës UK Sh.a	7.47
Vlorë UK Sh.a	2.42
Patos UK Sh.a	1.70
Fier UK Sh.a	1.37
Kavajë UK Sh.a	1.04

Burimi: AKUM (2022)


Akumulimi i detyrimeve të prapambetura vazhdon trendin rritës, kryesisht për shkak të performancës së ulët të shumicës së shoqërive U-K sha. Nisur nga kjo, ka startuar aktualisht procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Synimi është ridimensionimi i 61 ndërmarrjeve U-K aktuale, përmes rigrupimit të tyre në 15 drejtori qëndrore U-K, me qëllim final menaxhimin optimal dhe rritjen e performancës së tyre financiare.

V.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme

Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, MFE ka ndërmarrë dhe intensifikuar hapat konkretë në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura. Duke nisur nga viti 2021, ky monitorim dhe raportim gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37 të datës 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme”. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura përveç se rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar raportin për të gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimit të auditues për vitet 2021 – 2023” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësitë publike. Kjo, përse kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësitë publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e detyrimeve të prapambetura deri në T1 2022:

Grafiku 47: Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln LEK



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

Konkretisht, deri në fund të muajit Mars 2022 (T1) u regjistrua një stok kumulativ prej 14.54 miliardë LEK⁵ i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- ✓ Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6.76 miliardë LEK
- ✓ Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 7.30 miliardë LEK.
- ✓ Totali detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së rreth 0.48 miliardë LEK

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara T1 2021, rezulton se:

- ✓ Niveli total i detyrimeve të prapambetura është ulur me 6.2 miliardë LEK, rreth 30% më i ulët.
- ✓ Rimbursimet e prapambetura të TVSH-së janë ulur ndjeshëm me 5.4 miliardë LEK, rreth 92% më i ulët.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për vitin 2021, rezulton se:

- ✓ Niveli total i detyrimeve të prapambetura është rritur me 1.3 miliardë LEK, ose rreth 9.9% më i lartë.
- ✓ Detyrimet e qeverisjes qendrore janë rritur me 0.61 miliardë LEK, ose rreth 9.9% dhe ato të qeverisjes vendore janë rritur me 0.70 miliardë LEK, ose rreth 10.6%.


Për vitin 2022, efektet e krizës globale energjitike, lufta në Ukrainë, rritja e kostove të mallrave të konsumit, kanë sjellë një rritje të lehtë të stokut të detyrimeve të prapambetura në nivel të përgjithshëm. Specifikat që do të karakterizojnë vazhdimësinë e kësaj situatë, do të kushtëzojnë edhe ‘sjelljen’ që do të ketë ky zë për pjesën e mbetur të vitit. Duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t’u shlyer gjatë vitit 2022 karakterizohen nga një “moshë mesatare” e re e krijimit të tyre.

⁵ Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës Kanalizime dhe Universiteteve

V.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e qeverisjes QENDRORE

Sipas informacionit të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për T1 2022, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore është rreth 6.76 miliardë LEK, duke rezultuar 1.19 miliardë LEK më pak ose rreth 15% më i ulët krahasuar me stokun e regjistruar në T1 2021. Sipas kategorive të shpenzimeve rezulton:

Grafiku 48: Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë



Siç vërehet, zë me peshë të konsiderueshme në ecurinë e detyrimeve të prapambetura mbetet ai i vendimeve gjyqësore administrative të formës së prerë, të cilat:

- ✓ Kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura. Për T1 2022, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore për njësitë e qeverisjes qendrore rezultuan në rreth 3.23 mld LEK ose rreth 47.8% e stokut total të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky nivel është ulur me 54 milion LEK, ose 14.3%. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2021, niveli i detyrimeve për vendimet gjyqësore qendrore është rritur me 7 milion lekë ose 2.2%.
- ✓ Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumenteve të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.

V.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes VENDORE

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit Mars 2022, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është rreth 7.3 miliard lekë. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është rritur me rreth 0.7 miliard lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2021, që ishte rreth 6.6 miliard lekë.

Sipas kategorive, për bashkitë peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54%. Më pas, kategoria “Të tjera” me 19.7%, “Shërbime” me 10.6%, dhe “Vendime Gjyqësore” me 8%. Ndërsa sa i përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat vazhdojnë të zënë 96.4% të totalit të detyrimit të qarqeve.

Tabela 26: Stoku i detyrimit të mbetur vendor – T1 2022 (në lekë)


Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha në % Bashki	Pesha në % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqësore	574,331,516	115,236,636	8%	96.4%
4864200	Det.Prap. Shërbime	763,752,696	1,448,121	10.6%	1.2%
4864300	Det.Prap.Mirëmbajtjeje	158,485,503	0	2.2%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	3,879,277,143	739,225	54%	0.6%
4864500	Det.Prap.Rimbursim TVSH	758,305	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	310,033,276	705,546	4.3%	0.6%
4864900	Det.Prap.Të Tjera	1,412,861,315	1,435,940	19.7%	1.2%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqërore	56,593,941	0	0.8%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shëndetsore	3,921,652	0	0.1%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personale	21,047,502	0	0.3%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	1,738,144	0	0.1%	0.0%
	TOTAL	7,182,800,993	119,565,468	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022);

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 1.2 miliard lekë, e cila përbën 16.3% të totalit të detyrimeve. Më pas vjen bashkia Kavajë në vlerën rreth 813 milion lekë, e cila përbën 11.3% të totalit të detyrimeve; bashkia Vorë në vlerën rreth 516 milion lekë, e cila përbën 7.2% të totalit të detyrimeve; bashkia Lezhë në vlerën rreth 477 milion lekë, e cila përbën 6.6% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Malësi e Madhe dhe bashkia Pogradec.

Ndërsa, sa i përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit vazhdon ta ketë qarku Durrës në vlerën rreth 55.6 milion lekë, e cila përbën 46.5% të totalit të detyrimeve; qarku Berat në vlerën rreth 47 milion lekë, e cila përbën 39.2% të totalit të detyrimeve; qarku Gjirokastër në vlerën rreth 15 milion lekë, e cila përbën 12.9% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen qarku Vlorë dhe qarku Korçë.

Grafiku 49: Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore (bashki+qarqe) sipas zerave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

V.3 Pagesat Faktike të Kontratave Koncesionare/PPP, me Mbështetje Buxhetore

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Gjatë vitit 2022, MFE ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar, për secilën kontratë koncesionare/PPP.

Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar edhe përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.1 datë 10.01.2022 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022*", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë mujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre. Në fund të 5M 2022, në nivel total rezultoi se, nga 12 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore:

- 9 kontrata koncesionare/PPP kanë pagesa faktike buxhetore, për periudhën 5 mujore,
- Për 3 kontrata nuk është kryer asnjë pagesë referuar periudhës 5 mujore.

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2022 me destinacion mbështetjen nga buxheti i shtetit për kontratat koncesionare/PPP, sipas planit vjetor të ndryshuar, në total janë rreth 12.17 miliard LEK. Nga këto, rreth 4.58 miliard LEK janë investime dhe rreth 7.6 miliard LEK shpenzime korente. Krahasuar me pagesat faktike të vitit 2021 të cilat arritën vlerën rreth 11.52 miliard LEK, pagesat e planifikuara për vitin 2022, janë rreth 648.7 milion LEK më të larta ose rreth 5.6% më shumë.

Pagesat faktike për 5M 2022, rezultojnë në masën rreth 3.75 miliard LEK ose 30.8% të pagesave të planifikuara vjetore 2022. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ato rezultojnë rreth 320.2 milion LEK më të larta ose rreth 9.3% më shumë.

Pagesat faktike për muajin Maj 2022 rezultojnë rreth 896.9 milion LEK ose rreth 7.4 përqind e pagesave të planifikuara vjetore 2022. Pagesa më e lartë e realizuar në muajin Maj është pagesa prej rreth 188.2 milion LEK për kontratën "*Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier*", pagesë e cila përbën 21 përqind të totalit të pagesave faktike të realizuara në muajin Maj.

Respektimi i rregullit fiskal të PPP-ve, për vitin 2022

Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP për vitin 2022, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, përlllogaritet në rreth 23.78 miliard LEK.

Në nivel vjetor, pagesat e planifikuara për vitin 2022, për kontratat koncesionare/PPP, përbëjnë 2.56 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, duke respektuar dukshëm në këtë mënyrë rregullin fiskal prej jo më shumë se 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës.

Tabela 27: Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK)

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Viti 2022			
										Plan	Fakt 5M	% e realizimit Fakt 5M/Plan 2022	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investim	752,770	752,770	690,040	188,200	188,193	100%	
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investim	581,936	582,720	40,292				
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investim	1,505,822						
	2	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbit	2018	2031	04520	Investim	3,910,860	2,691,055	3,392,727	2,940,000	420,000	14.3%	
	3	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investim	570,643	811,734	790,027	743,000	380,859	51.3%	
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum - Dukat	2021	2033	04520	Investim		0	47,069	312,000	0	0%	
	5	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	2020	2033	04520	Investim		0	3,100	0	0	0%	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korente	1,509,659	1,140,893	1,660,686	1,965,913	772,513	39.3%	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Konçesioni/PPP Kontrolli bazë i popullsisë (check up)	2015	2025	07220	Korente	876,083	322,322	219,021	876,090	365,035	41.7%	
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korente	2,163,282	1,288,269	1,564,982	1,700,000	595,525	35%	
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	07330	Korente	804,388	733,203	754,000	835,000	309,785	37.1%	
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korente	0	30,670	1,106,402	1,574,900	531,392	33.7%	
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës (Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbiqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1")	2018	2029	09120	Investim			0	395,074	0	0%	
MIE / Bashkia Tiranë	1	Inceneratori i Tiranës	2017	2047	06220	Korente	977,125	1,280,000	1,249,399	636,315	183,786	28.9%	
	12	TOTALI						13,652,568	9,633,635	11,517,745	12,166,493	3,747,088	30.8%
		Totali i të Ardhurave Tatimore						426,270,680	398,657,710	475,611,880	510,167,000		
		Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)						3.26%	2.26%	2.89%	2.56%	0.79%	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

V.4 Detyrime të tjera Kontigjente

V.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve. MFE ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likujdimit të VKM respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonese. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit.

Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ, ku specifikisht në nenin 19/4 përcaktohen dy mënyra ekzekutimi të shpërblimit:

- ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ.*
- ✓ *Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.*

Për periudhën Janar – Qershor 2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar tre VKM në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së, me një vlerë totale prej 36.200 Euro (rreth 4.4 milion LEK), konkretisht:

- ✓ *VKM nr.29, datë 19.01.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 12.01.2021, për çështjen ‘Budo kundër Shqipërisë’” (kërkesa nr.75763/17),*
- ✓ *VKM nr. 290, datë 11.05.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 19.10.2021, për çështjen ‘Laçi kundër Shqipërisë’” (kërkesa nr.28142/17) dhe*
- ✓ *VKM nr. 369, datë 01.06.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 09.12.2021, për çështjen ‘Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë’” (kërkesa nr.45022/16),për çështjet “Budo kundër Shqipërisë” (kërkesa nr.75763/17), “Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë” (kërkesa nr.45022/16) dhe “Laçi kundër Shqipërisë” (kërkesa nr.28142/17),*

Efektet financiare të VKM-ve të sipërcituara përballohen nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2022. Nga këto, deri tani:

- ✓ *Është zbatuar vetëm VKM për çështjen “Budo kundër Shqipërisë” me vlerë 10.700 Euro (rreth 1.3 milion LEK) dhe janë në proces zbatimi VKM-të për çështjet “Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë” dhe “Laçi kundër Shqipërisë”, me vlera përkatëse prej 15.000 Euro & 10.500 Euro.*
- ✓ *Ndërkohë, MFE ka ekzekutuar edhe tetë vendime të GJEDNJ-së, vlerat përkatëse të të cilave janë nën 10.000 Euro. Totali i pagesave për këto vendime rezulton në vlerën 25.600 Euro (rreth 3.17 milion LEK).*

Tabela 28: Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ-së (në Euro)

Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi faktik	Detyrimi kontigjent	Totali i detyrimit faktik dhe kontigjent
Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
Prizreni kundër Shqipërisë	13,400 €		13,400 €
Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa:DHimertika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
Sharrxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë (çështjet “Maçi dhe Vrioni”)		3,811,365 €	3,811,365 €
Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 45022/16)	15,000 €		15,000 €
Laçi kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 28142/17)	10,500 €		10,500 €
Strazimiri kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 34602/16)	17,500 €		17,500 €
Çështjet: “Milo kundër Shqipërisë”, “Kalemaj kundër Shqipërisë”, “Jahbala kundër Shqipërisë”, “I.M.S kundër Shqipërisë”, “Sovjani kundër Shqipërisë”		16,800 €	16,800 €
Çështjet: “Sulçe kundër Shqipërisë”, “Kalia kundër Shqipërisë”, “Habilaj kundër Shqipërisë”, “Bekteshi kundër Shqipërisë”, dhe “Danushi kundër Shqipërisë”.		25,000 €	25,000 €
Çështjet: “Peshkopia dhe Talipi kundër Shqipërisë”, kërkesa nr.16351/15 dhe “Proda kundër Shqipërisë”, kërkesa nr.20127/16		6,350 €	6,350 €
Totali	17,937,050 €	3,859,515 €	21,796,565 €

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

V.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT

Këto vendime kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit.

Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likujdohen përmes buxhetit të MFE dhe/ose Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

MFE, në vazhdimësi dhe me këmbëngulje, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

Për periudhën Janar-Maj 2022, bazuar në raportimin e institucioneve buxhetore, vlera totale e paguar nga ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, për vendimet e arbitrazhit, rezultoi në masën rreth 243.65 milion LEK. Nga këto:

- ✓ 12.1 milion LEK nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin në procedurat e anullimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen "ICC Case no.22919/GR" (Hydro S.R.L kundër Republikës së Shqipërisë).
- ✓ Rreth 3.7 milion LEK nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin në procedurat e anullimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar "ICC Case 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)".
- ✓ 87.7 milion LEK nga Agjencia Kombëtare Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësim dhe mbrojtje, lidhur me vendimin e arbitrazhit ndërkombëtar "ICC Case no.24140/MHM/HBH".
- ✓ Rreth 30.5 milion LEK nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për pagesën e kostove për përfaqësimin e MIE/AKBN në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar "ICC Case 21349/EMT/GR".
- ✓ Rreth 19.35 milion LEK nga Autoriteti Portual Durrës, për shërbime ekspertimi dhe konsulencë ligjore dhe financiare për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.
- ✓ 36.6 milion LEK nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për pagesën e shërbimeve juridike të studios ligjore, të kontraktuar për anulimin e vendimit të arbitrazhit "ICSID Case no. ARB/14/26 Albaniabeg Ambient shpk, Angelo Noveli, Construzioni S.R.L".
- ✓ Rreth 31 milion LEK nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e shërbimeve juridike, për 1 çështje të arbitrazhit ndërkombëtar "PCA Case 2018-49 VALERIA SRL".
- ✓ 22.7 milion LEK nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë".

Mëposhtë paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tabela 29: Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)

ML	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Totali i detyrimit	Detyrimi i Faturuar	Likuidimi/Paguar	Detyrimi i mbetur	Detyrime Kontigjente	Totali i detyrimit të mbetur dhe detyrimeve kontigjente
MIE	ICC Case 23998/MHM (c - 24011/MHM/HBH). Vendimi i Arbitrazhit datë 01.09.2020, në favor të JV Copri-Aktor dhe palë të paditur ARRSH.	42,915,256	0	0	0	42,915,256	42,915,256
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICC Case 23998/MHM (c - 24011/MHM/HBH)	541,400	400,400	400,400	141,000	0	141,000
	ICC Case no.24140/MHM/HBH Construzioni DONDI S.P.A me palë të paditur AKUM. Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore.	2,074,022	1,924,022	1,924,022	150,000	0	150,000
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit dhe mbrojtjes së RSH në procedurën e anulimit të vendimit të arbitrazhit datë 11.02.2020, kundër rishikimit të vendimit të përfundimtar të Arbitrazhit datë 04.06.2019 ICC Case no.22919/GR	491,400	380,250	96,305	283,945	111,150	395,095
	Kosto të studios ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të RSH, në çështjen e arbitrazhit ICSID Case no.ARB/20/54 Arka Energy B.V kundër RSH.	1,900,000	400,000	0	950,000	950,000	1,900,000
	Kosto administrative në çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë)	127,118	127,118		127,118		127,118
	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë)	1,900,000	300,000		1,600,000		1,600,000
	Shërbim e ekspertim në kuadër të çështjes ICSID Case no.ARB/20/37	83,805	83,805	83,805	0	0	0
	Kontratë përfaqësimi MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (BPAL v MIE/AKBN dhe Albpetrol)	1,750,000	800,000	250,000	1,500,000		1,500,000
	Përfaqësimi i MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR	827,200	399,500	0	827,200		827,200
	Konsulencë ligjore dhe financiare për projektin e Investimit strategjik Marina & Jahet Durrës	299,000	150,000	75,000	224,000		224,000
	Shërbim e ekspertim në kuadër të çështjes ICSID Case no.ARB/20/37	360,000			360,000		360,000
MIE	Arbitrazhi me kompaninë Starbridge për Portin e Karpenit, "HFW" LLP *	500,000	132,457	100,000	32,457	0	32,457
MFE			132,457	132,457	0	0	0
MIE	Arbitrazhi për TIA shpk	250,000	75,000	75,000	0	50,000	50,000
MFE			75,000	75,000	0	50,000	50,000
MFE	Kosto paraprake për procesin e arbitrazhit SCC Case no.V2021/155	272,550	272,550		272,550		272,550
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	108,000,000	0	0	0	108,000,000	108,000,000
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	2,617,754	1,391,095	1,391,095	142,379	1,084,280	1,226,659
MBZR	Arbitrazhi me Valeria Italia S.r.l, me shpenzime për avokatët, kontratë agazhimi për ofrimin e shërbimeve ligjore datë 06.11.2018	750,000	450,000	450,000	300,000	0	300,000
	Pagesë e kostove fillestare të arbitrazhit dhe pagesa për mbulimin e shpenzimeve administrative të Gjykatës (PCA) për çështjen e Arbitrazhit ndërkombëtar PCA Case 2018-49 VALERIA SRL	319,500	319,500	319,500	0	0	0
MTM	Anullimi i vendimit ICSID Case no. ARB/14/26 Albaniabeg Ambient shpk, Angelo Noveli, Construzioni S.R.L, kosto të studios ligjore.	1,269,850	1,269,850	920,350	349,500	0	349,500
	Total	172,482,031	12,798,521	10,008,451	7,693,528	154,244,966	161,938,494

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministritë e Linjës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2022)

* Sipas Avokaturës së Shtetit, bazuar në vendimin e Komisionit përkatës të negociimit u vendos mosvijimi i negociatave me Starbridge. Rrjedhimisht kontrata e shërbimeve me kosulentin nuk ezauroi të 3 fazat e kontratës. Rrjedhimisht as vlerën e plotë të saj prej 500.000 Euro.

Shënim: Informacioni i mësipërm bazohet në të dhënat e raportuara në MFE. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit.

VI. KONKLUZIONE DHE PROPOZIME

Perspektiva për ekonominë shqiptare ka ardhur në përmirësim. Parashikimi për vitin aktual 2022 është pozitiv dhe pritet që ekonomia të vazhdojë në ritmet pozitive të rritjes dhe pse më një normë më të përmbajtur në krahasim me vitin e kaluar, në nivelin prej 3.2%. Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të ketë një efekt të moderuar pozitiv.

Pritshmëria e borxhit publik – Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus plotësimin e nevojave për huamarrje në kuadër të rimëkëmbjes së ekonomisë pas situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë Covid-19 dhe ndikimit të konfliktit Rusi-Ukrainë, duke mbajtur në konsideratë përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve e mbajtjes nën kontroll të kostos.

Pritshmëria në kahun e të ardhurave buxhetore – Bazuar në performancën e 5M Janar-Maj 2022 dhe në analizën e faktorëve që mund të impaktojnë realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore për 7M në vijim, vlerësojmë se të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, pritet të realizohen mbi 100%. Ndër faktorët kryesorë që do të ndikojnë në realizimin e pritshëm të të ardhurave deri në fund të vitit 2022 janë:

- ✓ *Thellimi i luftës kundër informalitetit, duke përmirësuar administrimin tatimor dhe atë doganor.*
- ✓ *Rritja e çmimimeve dhe ne veçanti e karburantit dhe energjisë elektrike në tregjet globale.*
- ✓ *Rimëkëmbja e ekonomisë pas situatës Covid 19 në vazhdimësi të vitit të kaluar.*
- ✓ *Përmirësimi i performancës së administratës tatimore në administrimin e TVSH-së së brendshme, duke nxitur vetëdeklarimin dhe kontrolluar mbi bazë risku sektorët dhe industritë që gjenerojnë këtë tatim.*
- ✓ *Ecuria pozitive e procesit të fiskalizimit nga administrata tatimore.*

Pritshmëria lidhur me ecurinë e shpenzimeve buxhetore – Tashmë në kushtet e një rishikimi të parë të ligjit të buxhetit 2022, të kushtëzuar tërësisht nga thellimi i krizës energjitike dhe rritjes së ndjeshme të çmimit të inputeve bujqësore & industriale si pasojë e përshkallëzimit të konfliktit Rusi-Ukrainë, pritshmëria e performancës së zërave të shpenzimeve publike vlerësohet të jetë:

- ✓ *Nga njëra anë, në linjë me parashikimet që kanë karakterizuar tashmë rishikimin e parë të buxhetit 2022, të karakterizuar nga siguri i financimeve/sistemimeve të vlefshme për mbarëvajtjen e vitit buxhetor në tërësi, të nevojshme për mbështetjen e shtresave më vulnerabël dhe jo vetëm;*
- ✓ *Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore ato do të vazhdojnë të mbeten subjekt i analizave dhe vlerësimeve intensive nga ana e MFE, duke patur parasysh aspektet specifike që kanë karakterizuar vitin 2022 nga pikëpamja e efekteve të rritjes së çmimeve kryesisht dhe rrjedhimisht, nevojat eventuale për financim për këtë qëllim.*

Në përfundim, nën dritën e analizës së mësipërme mbi ecurinë thuhet se 6-mujore dhe pritshmëritë deri në fund të vitit fiskal 2022, si edhe në vijim të rishikimit të ligjit të buxhetit 2022 përmes AN nr.3 datë 12.03.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjykon se vlerësimi i performancës së ecurisë së treguesve të konsoliduar makro-fiskal dhe buxhetorë, si të të ardhurave ashtu edhe të shpenzimeve të paktën në nivel 9-mujor, do të jetë vendimtar në drejtim të angazhimit për një rishikim tjetër eventuale të ligjit të buxhetit të vitit 2022.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

VII. SHTOJCAT

VII.1 Ecuria e detajuar e treguesve makroekonomikë gjatë Janar-Maj 2022⁶

Sektori real

Mbështetur në informacionet më të fundit të disponueshme, INSTAT jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2021, i cili bazuar në vlerësimet tremujore, shënoi një rritje prej 8.54%, krahasuar me vitin 2020. Zgjerimi i kërkesës për mallra e shërbime solli rritjen e prodhimit, të pagave e të punësimit, si dhe përmirësimin e situatës financiare të bizneseve dhe familjeve.

Të gjitha kategoritë e shpenzimeve vijuan rritjen gjatë periudhës, duke tejkaluar ndjeshëm bazën e ulët të vitit 2020, si efekt i pandemisë. Kërkesa e brendshme kontribuoi me 7.33 pikë përqindje në rritjen ekonomike, 2.57 pikë përqindje e së cilës ishte kontribut i konsumit privat, i cili u rimëkëmbë si rezultat i përmirësimit të besimit të konsumatorit, uljes së pasigurisë në lidhje me pandeminë dhe rritjes së të ardhurave të disponueshme. Formimi bruto i kapitalit fiks kontribuoi me 4.59 pikë përqindjeje, nëpërmjet investimeve më të larta publike dhe private. Eksportet u zgjeruan me 46.51 për qind në vitin 2021, ndërkohë kontributi i eksporteve neto ishte negativ për shkak të përmbajtjes së lartë të rritjes së importeve.

Nga optika e ofertës, aktiviteti ekonomik në vitin 2021 ishte me bazë të gjerë. Faktorët kryesorë që përcaktuan përbërjen sektoriale të rritjes ishin ri-ndërtimi, rimëkëmbja e turizmit dhe prodhimi i energjisë elektrike. Ndërtimi kontribuoi me 1.83 pikë përqindje në rritje, mbështetur nga rindërtimi dhe shpenzimet publike për infrastrukturën. Nga të gjithë sektorët, bujqësia ka pasur kontributin më të vogël, për shkak të rritjes së kostove të prodhimit. Në tërësi, fillimi i vitit 2022 e gjeti ekonominë shqiptare në një moment pozitiv zhvillimi.

Shifrat e punësimit kanë mbështetur vijimin e ecurisë së aktivitetit ekonomik ku për tremujorin e parë të vitit 2022 papunësia ka vijuar të shënojë rënie dhe papunësia për grup moshën mbi 15 vjeç ka shënuar nivelin prej 11.3%, duke u ulur me 0.6 pikë përqindje në terma vjetorë, dhe duke rënë me 0.1 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021. Ndërkohë që edhe shkalla e punësimit ka vijuar të shënojë rritje duke rezultuar në 54.2% për popullsinë mbi 15 vjeç. Ritmi vjetor i ndryshimit të punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i parë i vitit 2021 në tremujorin e parë 2022, është +3.4%. Në terma vjetorë, punësimi është rritur me 8% në sektorin e industrisë, me 1.7% në sektorin e shërbimeve, dhe me 2.8% në sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, edhe paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë ka ndjekur të njëjtin trend gjatë tremujorit të parë 2022, duke u rritur në terma vjetorë me 5.8%, në 59,242 lekë. Pra, tendencat e punësimit dhe papunësisë, sipas vlerësimeve të INSTAT për tremujorin e parë 2022, tregojnë vlera të qëndrueshme pranë mesatareve pozitive të viteve të fundit, ku efektet nga pandemia tashmë janë pasqyruar dhe vërehet se pasojat nuk janë aq të rënda sa parashikohej në fillim të pandemisë.

Një tjetër tregues i rëndësishëm që jep sinjale mbi rritjen ekonomike është treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) që në muajin maj të vitit 2022 shënoi nivelin 107.2 duke pësuar një rritje prej 4.6 pikësh nga muaji i kaluar dhe një rritje me 3.5 pikë përqindje në krahasim me maj 2021. Niveli aktual

⁶ Analiza e zhvillimeve ekonomike në këtë seksion, bazohet në statistikat/informacionin më të fundit zyrtar të disponueshëm, në momentin e hartimit të këtij raporti.

i TNE-së qëndron 7.2 pikë mbi mesataren afatgjatë (në nivelin 100), dhe rreth 7.2 pikë përqindje mbi mesataren e 5 viteve të fundit (maj_2017 – maj_2022). Rritja e TNE u përcaktua nga përmirësimi i besimit në pothuaj të gjithë sektorët e ekonomisë, me kontribute më të theksuara nga sektori i shërbimeve dhe i tregtisë. Treguesi i besimit në sektorin e industrisë (TBI) shënoi nivelin -1.4 në maj 2022 (7.3 pikë përqindje më shumë krahasuar me maj 2021), dhe një rritje mujore prej 4.3 pikë përqindje. Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) shënoi nivelin -17.3 në maj 2022 (1.4 pikë përqindje më pak krahasuar me maj 2021), dhe duke pësuar një rënie mujore prej 0.6 pikë përqindje. Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) shënoi nivelin 26.7 në maj 2022 (17.7 pikë përqindje më shumë krahasuar me maj 2021), dhe duke pësuar një rritje mujore me rreth 7.2 pikë përqindje. Treguesi i besimit të tregtisë shënoi nivelin 9.18, duke pësuar një rënie vjetore prej 0.3 pikë përqindje dhe një rritje mujore me 6.8 pikë përqindje. Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK) shënoi nivelin -34.13 në maj 2022 (7.3 pikë përqindje më pak krahasuar me një vit më parë), dhe duke u rritur me 2.0 pikë përqindje në ndryshim me një muaj më parë.

Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar - maj 2022 shënuan rritje prej 46% krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu vetëm për maj 2022, eksportet shënuan rritje prej 36.8% në krahasim me maj 2021. Në maj 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 44.93 miliardë lekë, duke u rritur me 38.6%, krahasuar me një vit më parë. Rritja vjetore e eksporteve prej 36.8% është ndikuar nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me kontribut +9.1 pikë përqindje “Tekstile dhe këpucë” me +6.7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +13.1 pikë përqindje.

Tabela 30: Rritja e eksportit të mallrave, sipas kategorive kryesore


Tab. 1	Rritja e eksporteve	Në terma vlerë				Në terma peshe	
		Maj 2022 / 2021		Janar-Maj 2022 / 2021		Janar-Maj 2022 / 2021	
		Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %) mujore	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)
	Ushqime, pije, duhan	18.4	2.5	20.3	2.4	18.1	1.3
	Minerale, lëndë djegëse, en. elektrike	45.0	9.1	74.3	14.4	-8.0	-5.3
	Produkte kimike dhe plastike	41.4	1.0	82.5	2.2	39.6	1.7
	Lëkurë dhe artikujt prej tyre	65.7	0.3	48.9	0.3	14.0	0.0
	Prodhime druri dhe letre	73.5	1.7	58.3	1.5	3.9	0.1
	Tekstile dhe këpucë	22.5	6.7	23.5	7.6	6.6	0.1
	Materiale ndërtimi dhe metale	63.6	13.1	72.9	14.4	10.2	1.7
	Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	26.7	2.1	34.0	2.7	16.6	0.1
	Të tjera	9.5	0.3	18.4	0.5	2.4	0.0
	Gjithsej	36.8	36.8	46.0	46.0	-0.3	-0.3

Burimi: INSTAT, Qershor 2022

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të eksporteve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë.

Grafiku 50: Rritja mujore e totalit të eksporteve, në përqindje

Graf. 1 - Rritja e Eksportit Maj 2021 - Maj 2022 (në %)



Burimi: INSTAT, Qershor 2022

Importet e mallrave për periudhën janar – maj 2022 shënuan rritje prej 27.1% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për maj 2022 importet shënuan rritje vjetore prej 28.6% në krahasim me maj 2021. Në maj 2022 importet e mallrave arritën vlerën 79.4 miliardë lekë duke u rritur me 28.6%, krahasuar me një vit më parë. Rritja vjetore e importeve prej 27.1% është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me kontribut +8.9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me kontribut +5 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me kontribut +4.5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me kontribut +3.1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me kontribut 2.4 pikë përqindje. Zhvillimet sipas kategorive kryesore të mallrave të importit, si dhe kontributi i tyre në totalin e importeve, paraqiten në tabelën e mëposhtme


Tabela 31: Rritja e importit të mallrave, sipas kategorive kryesore

Tab. 2	Rritja e importeve	Në terma vlere				Në terma peshe	
		Maj 2022 / 2021		Janar-Maj 2022 / 2021		Janar-Maj 2022 / 2021	
		Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %) mujore	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)
	Ushqime, pije, duhan	26.1	4.5	24.8	4.0	8.6	1.6
	Minerale, lëndë djegëse, en. elektrike	102.2	8.9	122.4	10.7	-4.9	-1.5
	Produkte kimike dhe plastike	13.9	2.1	3.6	0.6	-29.7	-3.2
	Lëkurë dhe artikujt prej tyre	6.7	0.2	28.6	0.6	30.7	0.0
	Prodhime druri dhe letre	57.1	1.9	37.6	1.3	6.9	0.5
	Tekstile dhe këpucë	18.2	2.4	18.8	2.3	4.3	0.1
	Materiale ndërtimi dhe metale	21.2	3.1	39.3	5.6	-4.0	-1.1
	Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	24.2	5.0	7.9	1.8	-4.2	-0.2
	Të tjera	11.0	0.5	4.3	0.2	-7.3	-0.1
	Gjithsej	28.6	28.6	27.1	27.1	-3.8	-3.8

Burimi: INSTAT, Qershor 2022

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të importeve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë.

Grafiku 51: Rritja mujore e totalit të importeve, në përqindje



Burimi: INSTAT, Qershor 2022

Këto zhvillime në tregtinë e jashtme janë reflektuar dhe tek deficitin tregtar. Gjatë periudhës janar-maj 2022, bilanci tregtar u rrit me rreth 8.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ndërsa vetëm për muajin maj 2022 bilanci tregtar u rrit me 19.4% krahasuar me muajin maj 2021.

Deficiti tregtar i këtij muaji është 34.74 miliardë lekë, duke u rritur me 19.4%, krahasuar me muajin maj të vitit 2021 dhe duke u përmirësuar lehtë me 3%, në krahasim me muajin prillin të vitit 2022. Në pesëmujorin e 2022, deficitin tregtar arriti vlerën 157.88 miliardë lekë, duke u rritur 8.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Tabela 32: Bilanci tregtar, sipas kategorive kryesore


Bilanci tregtar për periudhën Janar-Maj 2018-2022 (në milion Lekë)					
	05 M_18	05 M_19	05 M_20	05 M_21	05 M_22
Ushqime, pije, duhan	-30,228	-28,921	-29,471	-29,815	-37,949
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	-243	-13,776	-5,413	2,339	-8,017
Produkte kimike dhe plastike	-33,281	-32,294	-31,329	-41,344	-39,797
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-6,876	-6,704	-4,007	-5,046	-6,318
Prodhime druri dhe letre	-6,099	-5,900	-5,704	-6,583	-8,320
Tekstile dhe këpucë	16,538	15,505	13,052	10,972	15,162
Materiale ndërtimi dhe metale	-7,584	-12,843	-15,444	-13,197	-9,008
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-49,921	-46,669	-34,086	-54,036	-55,297
Të tjera	-6,260	-5,864	-4,537	-8,552	-8,338
Gjithsej	-123,954	-137,465	-116,936	-145,261	-157,882

Burimi: INSTAT, Qershor 2022

Sektori monetar

Në muajin Maj 2022 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është +6.7%, një vit më parë ky ndryshim ishte +1.8%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2022, krahasuar me Prill 2022, është -0.5%. Inflacioni mesatar për periudhën Janar – Maj 2022 është +5.2%. Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria mujore e çmimeve të konsumit për tre vitet e fundit:

Grafiku 52: Ndryshimi vjetor i Inflacionit, në përqindje



Burimi: INSTAT, Qershor 2021

Përgjatë kësaj periudhe, nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm e ka pasur zëri i ushqimeve dhe pije jo alkoolike. Në tabelën e mëposhtme mund të vihen re kontributet dhe rritjet respektive në çmime për çdo grup mallrash për muajin maj 2022.


Tabela 33: Rritja vjetore e çmimeve, në përqindje

	Rritja (në %)	Kontributi në inflacion (në pikë %)
Ushqime	11.4	4.01
Pije alkoolike dhe duhan	5.0	0.25
Veshje dhe këpucë	1.3	0.05
Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji	2.7	0.52
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	3.2	0.24
Shëndeti	0.2	0.01
Transport	21.7	1.21
Komunikim	0.8	0.03
Argëtim dhe kulturë	1.2	0.05
Shërbimi arsimor	0.6	0.02
Hotele, kafene dhe restorante	5.3	0.25
Mallra dhe shërbime të ndryshme	0.9	0.04
Inflacioni i përgjithshëm	6.7	6.7

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e parë të vitit 2022 tregojnë se standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan vetëm në segmentin e biznesit të vogël e të mesëm në tremujorin e parë të vitit 2022, si pasojë e ecurisë së çmimeve në tregjet ndërkombëtare e ato vendase, ka nxitur bankat të jenë disi më konservatore ndaj këtij segmenti të biznesit. Nga ana tjetër, standardet e kreditimit nuk ndryshuan për segmentin e biznesit të madh. Standardet e kreditimit për individët u lehtësuan në tremujorin e parë. Njëkohësisht, bankat lehtësuan edhe kushtet e termat për kreditë e reja akorduar individëve. Bankat raportuan për një shtrëngim të standardeve për kredinë dhënë bizneseve gjatë tremujorit të parë të 2022 në nivelin 5.7% për biznesin e vogël dhe të mesëm për biznesin e madh nuk pati ndryshim, për kredinë

dhënë me qëllim investimi u shtrëngua në nivelin -8.1%, dhe për likuiditete nuk pati ndryshim. Gjithashtu, edhe kërkesa e individëve për kredi u perceptua e lartë në tremujorin e parë të vitit, nxitur kryesisht nga kredia për blerjen e banesave. Për individët, bankat raportuan se përgjatë tremujorit të parë kërkesa për kredi për shtëpi shënoi një rritje prej +22.6%, nga një rënie e lehtë prej -0.5% të shënuar në tremujorin e katërt të vitit 2021. Ndërkohë, për kredinë e individëve për konsum u raportua një rënie prej -3.5%, nga niveli prej 0.9% që u shënuar në tremujorin e mëparshëm. Referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit prill të vitit 2022 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 8.9% krahasuar me prillin e vitit 2021. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 2.8%, ndërsa ai në valutë është rritur me 14.1% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2021. Në muajin prill 2022 rezulton se rreth 43.8% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 56.2% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj. Stoku total i depozitave vetëm për muajin Prill 2022 shënoi rritje me 0.9 miliardë Lekë kundrejt muajit paraardhës (Mars 2022). Stoku total i depozitave të bizneseve në muajin Prill të vitit 2022 shënoi rritje prej 20.4% krahasuar me Prillin e vitit 2021, ndërsa stoku total i depozitave të individëve ka shënuar rritje prej 6.0% krahasuar me Prill 2021.

Grafiku 53: Ecuria e stokut të depozitave 2021-2022, në përqindje



Referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit prill të vitit 2022, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 12.1%, krahasuar me muajin prill të vitit 2021. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.8%, ndërsa ai në valutë rritje prej 15.9%, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar. Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin prill 2022 shënoi një rritje me 11.5%. Kredia vetëm për bizneset private jo-financiare u

rrit me 9.2%, duke kontribuar pozitivisht me 5.6 pikë përqindje në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar bizneseve publike jo-financiare për muajin Prill të vitit 2022 ka shënuar rritje me 76.1%, krahasuar me prillin e vitit 2021, duke kontribuar pozitivisht prej 1.6 pikë përqindje. Në prill 2022 rezulton se rreth 51.5% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 48.5% përbëhet nga kreditë në valutë.

Tabela 34: Ecuria e kredisë për bizneset dhe individët, në përqindje

Treguesit e kredisë	Rritja vjetore e stokut të kredisë (në %)												2022			
	2021												Jan	Shk	Mar	Prill
	Jan	Shk	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Jan	Shk	Mar	Prill
Stoku total i kredisë	6.5	5.1	2.2	6.4	6.3	5.9	6.5	6.6	7.1	9.9	10.4	9.4	9.6	10.9	11.9	12.1
Stoku i kredisë për biznesin	10.4	8.6	5.0	7.8	7.1	5.9	6.7	6.9	7.5	10.4	10.2	6.7	7.1	7.8	8.2	9.2
Stoku i kredisë për individët	6.5	6.1	4.8	7.6	8.6	10.1	10.7	10.6	10.4	10.6	10.7	11.8	12.3	12.8	13.8	14.0

Burimi: Banka e Shqipërisë, Maj 2022

Gjatë muajit Prill të vitit 2022, sasia e re e kredisë së dhënë nga sistemi bankar në Lek shënoi rënie me 28.7% kundrejt muajit paraardhës (mars 2022) dhe një rritje me 20.0% kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë (prill 2021). Ndërkohë, sasia e re e kredisë së dhënë në Euro u zvogëluar me 1% krahasuar me mars 2022, dhe u rrit me 54.7%, krahasuar me prill 2021. Niveli i kredive me probleme ndaj totalit të kredive në fund të muajit prill 2021 arriti në 5.24%.

Tabela 35: Ecuria e kredive të këqija, në përqindje

2021												2022			
Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill
8.20	8.15	7.96	7.88	7.80	7.12	7.05	6.96	6.49	6.35	6.20	5.65	5.45	5.39	5.24	5.42

Burimi: Banka e Shqipërisë, Maj 2022

Referuar të dhënave të deritanishme, sa i takon ecurisë së normave të interesit vihet re:

- ✓ **Për depozitat në Lekë** - Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave (duke përfshirë të gjitha maturimet) për muajin prill 2022 shënoi vlerën 0.89%, duke u rritur me 0.19 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraardhës. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12-mujore u rrit me 0.33 muaj më parë.
- ✓ **Për depozitat në US (\$)** – Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave shënoi vlerën 0.46%, ose 0.18 pikë përqindje më shumë krahasuar me një vit më parë dhe nuk pati ndryshim me një muaj më parë. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12 mujore u rrit me 0.07 p.p krahasuar me një vit më parë dhe u zvogëlua me 0.2 p.p, në krahasim me një muaj më parë.
- ✓ **Për depozitat në EUR (€)** - Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave shënoi vlerën 0.44%, duke u rritur me 0.22 p.p krahasuar me një vit më parë dhe duke u rritur me 0.22 p.p krahasuar me një muaj më parë. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12 mujore u rrit me 0.39 p.p në krahasim me muajin paraardhës dhe u rrit me 0.36 p.p krahasuar me një vit më parë.
- ✓ **Për kreditë në Lekë** - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive (duke përfshirë të gjitha maturimet) për prill 2022 shënoi vlerën 6.68%, ose 0.68 p.p. më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 1.21 p.p. më shumë se muaji paraardhës. Ndërkohë, norma e interesit për kreditimin mbi 5 vjeçarë ka shënuar rritje prej 0.57 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe rritje me 1.11 p.p krahasuar me muajin mars 2022.
- ✓ **Për kreditë në US(\$)** - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive shënoi vlerën 5.4%, duke shënuar rritje me 1.04 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe një rritje me 0.4 p.p krahasuar me muajin paraardhës.
- ✓ **Për kreditë në EUR (€)** - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive për prill 2022 shënoi vlerën 4.41%, ose 0.44 p.p. më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 0.22 p.p.më shumë krahasuar me një muaj më parë. Norma e interesit për kreditimin mbi 5 vjeçar u rrit me 0.29 p.p krahasuar me një vit më parë, ndërkohë, u rrit me 0.27 p.p. krahasuar me muajin mars 2022.

Gjatë muajit maj 2022, kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros arriti 120.46 lekë/euro duke pësuar një rënie mujore në vlerë me 0.43% dhe një rënie me 2.07 % në terma vjetore. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin maj arriti në 113.94 lekë/dollar amerikan duke shënuar një rritje mujore me 2.01% dhe një rritje vjetore me 12.55%.

Tabela 36: Ecuria e kursit të këmbimit 2015-2022

Periudha kohore	Kursi zyrtar i këmbimit												
	Mesatare vjetore për periudhën 2015-2022, dhe mesatare mujore për periudhën Janar - Maj 2022												
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022					
								Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	
USD	126.0	124.1	119.1	108.0	109.9	108.6	103.5	107.3	107.0	111.6	111.7	113.9	
EUR	139.7	137.4	134.2	127.6	123.0	123.8	122.5	121.5	121.3	123.0	121.0	120.5	

Burimi: Banka e Shqipërisë, Qershor 2022

VII.2 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2022

Buxheti i vitit 2022, ka financuar 131 programe buxhetore si edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve. Realizimi i buxhetit për 5 mujorin e vitit 2022 për ministrinë dhe disa nga institucionet qendrore kryesore, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 37: Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 5M I 2022

në mijë lekë

Institucionet	2022 Plani Fillestar	2022 Plani i Rishikuar	2022 Fakti 5 Mujor	Total Fakt/Plan Vjetor 2022	Shpenzime korrente Fakt/Plan 2022	Shpenzime kapitale Fakt/Plan 2022
Presidenca	258,920	244,078	74,948	31%	33%	0%
Kuvendi	1,431,566	1,354,516	387,564	29%	36%	2%
Kryeministria	428,000	401,974	188,779	47%	54%	0%
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	12,736,369	12,544,304	3,451,598	28%	32%	21%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	47,471,725	43,009,733	8,843,814	21%	28%	20%
Ministria e Financave dhe Ekonomise	65,473,059	71,142,949	24,862,088	35%	36%	10%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	45,458,347	45,775,102	16,769,986	37%	40%	5%
Ministria e Kultures	4,312,260	4,968,713	606,657	14%	32%	0.23%
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	77,075,882	77,850,218	30,200,908	39%	39%	46%
Ministria e Drejtesise	11,280,132	10,886,660	3,664,080	34%	36%	1%
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	3,120,143	2,887,947	611,570	21%	21%	24%
Ministria e Brendshme	21,191,400	20,550,822	8,240,516	40%	40%	35%
Ministria e Mbrojtjes	32,632,805	29,001,892	7,410,121	26%	32%	8%
Akademia e Shkencave	152,800	143,567	37,197	26%	26%	41%
Kontrolli Larte i Shtetit	508,960	491,154	165,047	32%	35%	8%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,439,460	2,399,432	790,058	33%	29%	38%
Prokuroria e Pergjithshme	2,294,270	2,303,413	839,371	36%	39%	1%
Keshilli i Larte Gjyqesor	3,347,808	3,636,726	1,128,768	31%	35%	2%
Gjykata Kushtetuese	152,760	166,109	53,327	32%	36%	0%
Keshilli i Larte i Prokurorise	150,800	149,775	63,544	42%	40%	87%
Institucionet e sistemit te drejtesise	712,656	759,053	231,877	31%	34%	0%
Institucione te tjera Qeveritare	8,980,927	8,641,846	3,464,175	40%	44%	31%

SHËNDETËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022, performanca e treguesve buxhetorë për programet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 38: Shëndetësia dhe mbrojtja sociale

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4-mujori 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	340,479	3,000	118,560	1,980	35	66
2	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	8,494,899	147,052	3,832,268	1,884	45	8
	Financimi i huaj		158,000				4
3	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	30,927,809	1,159,212	8,191,747	126,995	26	11
	Financimi i huaj		1,152,000		815,655		41
4	Shërbime të Shëndetit Publik	6,222,423	13,680	1,686,242	0	27	0
5	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	310,460	0	60,151	0	19	-
6	Përkujdesi Social	27,766,629	20,000	8,424,700	0	30	0
	Financimi i huaj		100,000		5,890		5
7	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,034,575	0	172,646	0	17	-
	Totali	75,097,274	2,752,944	22,486,314	962,403	30	35

Për programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”** është realizuar qëllimi i programit i cili synon *“Mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor, nëpërmjet ofrimit të vizitave falas nga mjeku i familjes, kontrollit mjekësor bazë dhe programeve parandaluese”*. Ky qëllim është arritur nëpërmjet objektivit, *“Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve”*. Qëllimi dhe objektivi i programit është realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4M I 2022, është realizuar si më poshtë:

- ✓ Janë ofruar 2,5 milionë vizita në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor.
- ✓ Me rifillimin e veprimtarisë lidhur me kontrollin bazë (Chek-up), kanë përfutur rreth 150,784 individë të moshës 35 - 70 vjeç.
- ✓ Janë trajtuar rreth 341,347 pacientë me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes, me një kosto faktike prej 2.5 miliardë lekë.

Për programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”** është realizuar qëllimi i programit i cili synon *“Mbulim universal i nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar, nëpërmjet ngritjes së një kuadri ligjor modern për një sistem financimi adekuat, modeleve bashkëkohore të manaxhimit të spitaleve, ngritjes së një sistemi monitorimi i cili do të masë performancën dhe do të lejojë akreditimin e spitaleve, deri në vitin 2022, zhvillimin e partner-shipit publik privat në shërbimet mjekësore dhe jo mjekësore në spitale”*. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivit *“Ofrimi cilësor dhe gjithëpërfshirës i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dytësor”*. Qëllimi dhe objektiva e programit janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4 mujorin e parë të vitit 2022, është realizuar si më poshtë

- ✓ Janë trajtuar rreth 86,392 pacientë të shtruar në spitale, me një kosto faktike prej rreth 7.3 miliardë lekë.
- ✓ Janë kryer rreth 62,452 seanca për trajtimin e pacientëve me dializë, shoqëruar me një kosto faktike prej rreth 250 milionë lekë.

- ✓ Janë trajtuar 749 pacientë në spitalet psikiatrike, me një kosto prej 223 milionë lekë.
- ✓ Janë trajtuar rreth 3,016 pacientë nga paketat spitalore të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë, me një kosto faktike prej 7 milion lekë;
- ✓ Janë trajtuar 2 pacientë nga paketat e transplanteve renale përgjatë 4M I 2022.
- ✓ Janë trajtuar 1,263 pacientë me katarakte, shoqëruar me një kosto prej 3.7 milionë lekë.
- ✓ Janë trajtuar 8,293 pacientë me radioterapi, shoqëruar me një kosto prej 11 milionë lekë.
- ✓ Janë kryer rreth 1.6 milionë ekzaminime laboratorike, shoqëruar me një kosto prej 343 milionë lekë.

Për programin **“Shërbime të Shëndetit Publik”** është realizuar qëllimi i programit i cili synon *“Mbrojtja e shëndetit dhe promovimi i jetësës së shëndetshme përmes, kontrollit të sëmundjeve infektive; forcimit të programit të imunizimit; sigurimit të vaksinave 100% sipas kalendarit të vaksinimit dhe mbulesën vaksinale të tyre mbi 95%; forcimit tëurvejancës epidemiologjike; monitorimit të ujit të pijshëm; kontrollit i sëmundjeve jo infektive përmes vlerësimit të faktorëve të riskut; nxitjes së procesit të depistimit; forcimi i shëndetit riprodhues dhe promovimit të një jete të shëndetshme. Zgjerimi dhe forcimi i monitorimit të agjenteve mjedisore bazuar në standartet e BE (ajri, zhurmat dhe ujrat sipërfaqësore). Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivave, sa më poshtë:*

- *Sigurimit të qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinare, për vaksinat e kalendarit të vaksinimit në masën 95%.*
- *Reduktimit të numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit.*
- *Mbulimi i grave me shërbim të depistimit të kancerit të gjirit.*

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4 mujorin e parë të vitit 2022, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *Janë vaksinuar rreth 61 mijë fëmijë të moshës 0-18 vjeç.*
- ✓ *Janë kryer rreth 1,314 monitorime të situatave epidemologjike, me një kosto faktike prej rreth 767 milionë lekë.*
- ✓ *Është kryer depistimi i 1,499 grave për kancerin e gjirit dhe 3,520 grave për kancerin e qafës së mitrës, me një kosto faktike prej 3.3 milionë lekë.*
- ✓ *Janë kryer rreth 8,100 inspektime nga inspektoriatet, shoqëruar me një kosto prej prej 115 milion lekë.*
- ✓ *Janë trajtuar 175 punonjës/personel mjekesor dhe jo mjekësor me bonus për COVID-19”, me kosto faktike rreth 13.6 milionë lekë, për 4 mujorin e parë të vitit 2022.*
- ✓ *Janë vaksinuar rreth 75,290 persona me vaksinën anti COVID-19 për 4M I 2022.*

Për programin **“Përkujdesi Social”**, është realizuar qëllimi i programit i cili synon *“Ndëtimi i një sistemi mbrojtje sociale nëpërmjet politikave dhe mekanizmave për të mbrojtur individët ne nevojë”*. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivave, sa më poshtë:

- *Reformimit të programit të përkujdesit social në tre shtylla kryesore të tij NE, PAK dhe Shërbimet*
- *Përfshirja e barabartë sociale dhe ekonomike e burrave, grave, fëmijëve dhe grupeve të margjinalizuara.*

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2022, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ Kanë përfituar rreth 64,363 familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE shoqëruar me një kosto faktike prej 1.6 miliard lekë.
- ✓ Kanë përfituar rreth 160,815 persona me aftësi të kufizuar nga programi i aftësisë së kufizuar, shoqëruar me një një kosto faktike prej 5.7 miliard lekë.
- ✓ Kanë përfituar 193 persona përfitimin e shërbimit të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike, shoqëruar me një kosto faktike prej rreth 82.3 milionë lekë.
- ✓ 12,628 bebe kanë përfituar shpërblimin e lindjes, me një kosto faktike totale prej rreth 900 milionë lekë.

ARSIMI

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022, performanca e treguesve buxhetorë për programet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për 4 mujorin e parë të vitit 2022, paraqitet si më poshtë:

Tabela 39: Arsimi

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 5-mujori 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	700,865	80,000	218,899	0	31	0
2.	Arsimi Bazë	23,034,152	1,108,0000	7,637,527	0	33	0
	Financim i huaj		0		0		0
3.	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	6,535,828	1,012,000	2,136,094	0	33	0
4.	Arsimi i Universitar	10,279,701	606,000	3,107,548	6,312	30	1
	Financimi i huaj		200,00		44,085		22
5.	Fonde për Shkencën	461,517	250,000	44,375	30,222	10	12
	Financimi i huaj		100,000		48,626		49
6.	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	134,901	270,000	39,553	0	29	0
	Financimi i huaj		20,000		0		0
Totali		41,146,965	3,646,000	13,183,995	129,244	32	4

“Arsimi Bazë”, qëllimi i këtij programi është “Sigurimi i një arsimit cilësor për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar”. Përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ Ndjekin programin parashkollor publik rreth 61,953 fëmijë të grup moshës 3-6 vjeç.
- ✓ U ofrua shërbimi i transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin e rreth 35,000 nxënës që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe 10,400 mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë me një kosto prej rreth 791.8 milion lekë.
- ✓ Për vitin shkollor 2021-2022 përfituan tekste shkollore falas për përdorim rreth 259 mijë nxënës nga klasa e parë në klasën e nëntë me një efekt financiar prej 964.5 milionë lekë.
- ✓ Janë rreth 140 nxënës me aftësi të veçanta që përfitojnë shërbim arsimor, me një kosto prej 30 milionë lekë për 4 mujorin e parë të vitit 2022

Programi **“Arsimi Mesëm i Përgjithshëm”** objektivat e të cilit janë:

- ✓ *Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijë 95-97% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë.*
- ✓ *Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve të klasës së 11 në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.*
- ✓ *Realizimi i Maturës Shtetërore 2021-2022, realizimi i testimit “Mësues për Shqipërinë”, në formë elektronike.*
- ✓ *Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm (rehabilitimi i 9-10% të klasave në gjimnaze në zonat urbane, shtimi me 5-8% i klasave të reja në zonat urbane, pajisja me mjete didaktike për Fizikë-Kimi-Biologji, për 8% në vit të shkollave të mesme, pajisja e shkollave me klasa mësimore inteligjente/ digjitale, si dhe pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat me 10 të fondit ekzistues të bibliotekave).*

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4 mujorin e parë të vitit 2022, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *Në vitin shkollor 2021-2022, marrin shërbim arsimor në AML rreth 86,186 nxënës, nga të cilët në arsimin publik janë 76,069 nxënës, shoqëruar me një kosto prej 2.1 miliardë lekë për 4 mujorin e parë të vitit 2022.*
- ✓ *Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin e rreth 5,300 mësues të AML për vitin shkollor 2021-2022, shoqëruar menjë kosto prej 24.4 milionë lekë.*
- ✓ *Kanë përfituar tekste mësimore falas 18,000 nxënës të grupeve sociale në nevojë, për vitin shkollor 2021-2022.*

Në programin **“Arsimi Lartë”**, gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa çenuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar, **objektivat** e të cilit janë:

- ✓ *Rritja e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik 5% deri 8% në vit dhe nëpërmjet rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë duke synuar uljen e raportit pedagog/student në 1/20.*
- ✓ *Garantimi i aksesit në bazë të meritës dhe rritja e dimensionit social në arsimin e lartë duke mbështetur me bursë financiare individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë nga kategoritë sociale në nevojë në masën 18% deri 20% të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë dhe në përputhje me parimet e barazisë gjinore.*
- ✓ *Akreditimi i 90-100 programeve të studimit nga 905 ose 8-10% e programeve mësimore të IAL publike të cilat janë në proces vlerësimi.*
- ✓ *Përmirësimi i standardeve infrastrukturore duke rritur raportin sipërfaqe/student së paku me 1 /student dhe vende për punë dhe kërkim në laboratorë e biblioteka.*

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4 mujorin e parë të vitit 2022, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *Ndërmarrja e paketës për studentët ku synimi kryesor, ka qenë i fokusuar në financimin me bursa i studentëve me notën mesatare 9 deri në 10-të, i studentëve nga kategorive sociale në nevojë, si dhe përjashtimi 100 % nga tarifa vjetore e shkollimit apo reduktimi në masën 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë. Për vitin akademik 2021-2022 kanë përfituar bursa dhe mbështetje financiare, nëpërmjet akomodimit në shtëpitë e trajtimit të studentëve të rreth 41,000 studentëve, shoqëruar me një kosto rreth 3.2 miliardë lekë për 4 mujorin e parë të vitit 2022.*

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si më poshtë:

Tabela 40: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4M 2022		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	303,394	5,000	131,442	0	43.3	0.0
2.	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,519,231	690,523	363,037	16,597	23.9	2.4
3.	Mbështetje për Peshkimin	126,570	201,132	30,389	16,661	24.0	8.3
4.	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	621,740	992,841	204,025	152,467	32.8	15.4
5.	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	3,594,824	3,359,599	194,702	573,716	5.4	17.1
6.	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	441,450	170,000	139,032	250	31.5	0.1
7.	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	18,000		0		0.0	-
	TOTAL	6,625,209	5,419,095	1,062,626	759,690	16.0	14.0

Në programin e “Zhvillimit rural duke mbështetur prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun”, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 768.4 milionë lekë, të tilla si:

- Hartimi i bazës ligjore për masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për 4 mujorin e parë të vitit 2022, VKM “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022” si dhe udhëzimi me bashkë firmosje midis MBZHR dhe MFE “Për kriteret procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.” Lidhur me masat mbështetëse, ka përfunduar procesi i aplikimit, ka filluar puna për vlerësimin e aplikimeve, shqyrtimin dhe disbursimin.
- Kanë aplikuar gjithsej 61 654 fermerë deri tani janë shqyrtuar 22 412 aplikime, nga të cilat 18 136 për skemën e naftës. Numri më i madh i aplikimeve rreth 80%, e zë skema e naftës, e më pas me 11.4% skema e matrikullimit të bagëtive, 5% skema e bletarisë.
- Janë paguar rreth 16 887 përfitues dhe janë shpërndarë rreth 3.5 milion litra naftë.
- Programi IPARD II është në fazën e përfundimit të vlerësimit dhe disbursimit të aplikimeve, të thirrjes së dytë dhe të tretë. Aktualisht janë disbursuar 50 kontrata. Është miratuar IPARD III dhe ka filluar puna për akreditimin e masave.
- Organizimi i 2 aktiviteteve promovuese ;
- Certifikimi dhe testimi i rreth 340 mijë fara dhe fidanë;
- Degustimi i rreth 71 mostrave të cigareve.

Në programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”, janë realizuar për 4 mujorin e parë produkte me një kosto faktike prej 379.6 milionë lekë, ku ndër to përmendim:

- Janë kryer 4 152 kontrolle në fermat e kafshëve të gjalla, farmacitë veterinare dhe depot farmaceutike;
- Janë realizuar 10 395 analiza nga ISUV në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale;
- Janë realizuar për vitin 2022 në të gjithë territorin e vendit deri në fund të muajit prill 34 590 inspektime në fushën e sigurisë ushqimore;
- Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve, me fokus shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve ka kryer 4.933 inspektime në terren.

Në programin “**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**”, janë parashikuar disa produkte dhe janë realizuar një pjesë e tyre me një kosto totale prej 356.4 milionë lekë, ndër to përmendim:

- Janë punuar rreth 8 000 hektar sipërfaqe kulluese me rrjetin kryesor të pastruar;
- Rreth 7 000 hektar sipërfaqe ujitëse me rrjet kryesor ujitës te mirëmbajtur;
- Mirëmbajtje për funksionimin normal të 27 hidroforëve për kullimin e rreth 70 000 hektarëve;
- Në lidhje me projektet e investimeve për rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes, investimi aktualisht nga 29 objekte, 10 prej tyre janë objekte në vazhdim, ndërsa për 19 objekte të tjerë janë në procedurë prokurimi.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Performanca e treguesve buxhetorë për 4 mujorin e parë të vitit 2022 për 12 programet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 41: *Infrastruktura dhe Energjia*

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4-mujori 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	483,668	26,786	149,093	0	31	0
	Financimi i huaj		0		0		0
2.	Transporti Rrugor	2,552,794	15,575,164	376,699	3,380,462	15	22
	Financimi i huaj		4,580,132		1,468,250		32
3.	Mbështetje për Energjinë	52,811	200,000	21,567	64,078	41	32
	Financimi i huaj		2,780,000		90,322		3
4.	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	449,418	7,118,185	17,864	39,509	4	1
	Financimi i huaj		6,669,274		619,837		9
5.	Menaximi i Mbetjeve Urbane	180,000	1,067,042	178,310	0	99	0
	Financimi i huaj		476,000		0		0
6.	Transporti Hekurudhor	413,201	400,000	134,198	84,616	32	21
	Financimi i huaj		1,958,349		4,575		0.2
7.	Transporti Detar	105,513	80,000	28,282	1,291	27	2
	Financimi i huaj		10,000		85		1
8.	Transporti Ajror	19,793	71,200	2,560	0	13	0
9.	Planifikimi Urban	65,402	94,000	15,531	12,844	24	14
	Financimi i huaj		0		0		-
10.	Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit	0	4,000	0	0	-	-
	Financimi i huaj		20,000		0		-
11.	Mbështetje për Burimet natyrore	216,921	91,000	63,009	24,429	29	27
12.	Mbështetje për Industrinë	267,032	64,000	80,871	17,352	30	27
	Totali	4,806,551	41,285,132	1,067,984	5,807,651	22	14

Programi “**Transporti Rrugor**” synon:

- ✓ Zhvillimin më tej të sistemit kombëtar të transportit,
- ✓ Përmirësimin e ndjeshëm të qëndrueshmërisë, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integrimin e tij me gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin,
- ✓ Mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standarteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm.

Qëllimi i programit është realizuar nëpërmjet dy objektivave specifikisht, Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar dhe Sistemit asfaltim e riveshje për rrugë të rrjetit kombëtar. Produktet që kanë kontribuar në realizimin e këtyre objektivave janë:

Për objektivin **“Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar”**, janë realizuar fondet në vlerën 1.2 miliard lekë apo 27% e planit të akorduar për vitin 2022. Disa nga produktet kryesore të realizuara përgjatë periudhës 4 mujore janë:

- Tipi i rrugës A2’ 2x2 me trotuar dhe ndriçim, për të cilin fondet e planifikuara për 4 mujorin e parë të vitit 2022 paraqiten të realizuar në masën 65 milionë lekë apo 22% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces:
 - *“Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit”;*
 - *“Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti2;*
 - *“Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3”;*
 - *“Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh;*
- Rruga tip B1’ me dy korsi, për të cilën janë realizuar fondet në masën prej 133 milionë lekë ose 24% ndaj totalit të planifikuar për vitin 2021. Objekti, në të cilin punohet me ritme të parashikuara është:
 - *“Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, shtesë punimesh, Loti 7 dhe Loti 8, ”*
- Për rrugën tip C2 me dy korsi, janë realizuar fondet përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 në masën 298 milionë lekë ose 14% e fondeve të planifikuara. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet normalisht dhe që janë në proces janë:
 - *Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1+shtesë punimesh;*
 - *Ndërtim rruga Korçë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë) dhe pjesa e dytë;*
 - *Ndërtim rruga Palas – Dhërmi;*
 - *Rikonstruksion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë;*
 - *Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit;*
 - *Zgjerim i rrugës Elbasan – Qafë – Thanë (Faza I)*
 - *Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)-Autostrada Fier-Vlorë.*
- Për rrugën Tip A e modifikuar, janë realizuar fondet në masën 81 milionë lekë ose 86% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Objekti që përfshihen në këtë kategori rruge është Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3.

Lidhur me objektivin **“Sinjalistikë dhe siguri rrugore”**, nuk ka patur realizim përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022.

Për programin “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime” përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 është realizuar qëllimi i cili konsiston në ofrimin e *Shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare*. Qëllimi i politikës së programit është realizuar nëpërmjet përmbushjes së objektivit i cili synon mbulimin e plotë dhe më cilësi me shërbim të furnizimit me ujë në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive UK, si edhe nëpërmjet produkteve të paraqitur si më poshtë:

- *Realizimi i 5,415 ml linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë, shoqëruar me një kosto prej 220 milionë lekë.*
- *U realizua rreth 7% e sasisë së planifikuar për vitin 2022 për produktin “Kanalizimi i Ri”.*

Në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore” përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, është realizuar qëllimi i cili lidhet me *“Realizimin e politikave të promovimit, mbikqyrjes, monitorimit dhe transparencës në fushën e gjeologjisë, minierave, ambientit dhe ujërave”*. Qëllimi i programit u realizuar përmes 2 objektivave të cilat janë *“Shfrytëzimi me efikasitet të burimeve natyrore minerare nga shoqëritë e licensuara për këtë veprimtari nëpërmjet zbatimit të kushteve tekniko-profesionale dhe mjedisore sipas standarteve europiane”* si dhe *“Promovimi i burimeve hidrologjike dhe minerare të pashfrytëzuara”*.

Produktet që kanë kontribuar në realizimin e tyre paraqiten të renditura sa më poshtë:

- Janë përditësuar 695 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinor, me kosto prej 1 milionë lekë.
- U realizua mbikqyrja e 360 burimeve të shfrytëzimit minerare, metale dhe jo metale, me kosto prej 3.8 milionë lekë.
- Është realizuar promovimi i minierave të rinj dhe kërkimeve teknologjike e mjedisore me një kosto prej 0.8 milionë lekë.
- Është kryer monitorimi i Fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura me një kosto prej 1.6 milionë lekë.
- Është realizuar projekti i studimit mbi zonimin minierar dhe hartimit të planit vjetor dhe 3-vjecar minierar, me një kosto prej rreth 1 milionë lekë.
- U realizua projekti mbi “Raportin vjetor të gjëndjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji”, me një kosto prej 1 milionë lekë

Me programin “Mbështetje për Energjinë” është realizuar qëllimi i programit i cili konsiston në *“Krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave dhe strategjive për një ecuri të qëndrueshme dhe të sigurt të sektorit të energjisë, në zbatim të programit dhe prioriteteve të qeverisë”*. Qëllimi është arritur nëpërmjet realizimit të produkteve të paraqitura si më poshtë:

- Monitorime të kryera në sektorin energjistik
- Kryerjes së 16 studimeve për përmirësimin e sektorit energjistik, përmirësimin e efikasitetit të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme apo 16% e sasisë së planifikuar për vitin 2022.
- Promovimin e efikasitetit të energjisë.

Turizmi dhe Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si më poshtë:

Tabela 42: TURIZMI DHE MJEDISI

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4M 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikim, Administrim	174,807	2,000	68,524	-	39.2%	0.0%
2	Mbrojtja e Mjedisit	422,308	120,000	130,182	10,816	30.8%	9.0%
	<i>Financimi i huaj</i>	-	390,000	-	1,919	-	0.5%
2	Administrimi i Pyjeve	325,539	39,500	95,361	-	29.3%	0.0%
4	Zhvillimi i Turizmit	391,039	369,240	34,274	233,397	8.8%	63.2%
	<i>Financimi i huaj</i>	-	100,000	-	0	-	0.0%
Totali		1,313,692	1,020,740	328,341	246,132	25.0%	24.1%

Në programin “Mbrojtja e Mjedisit” për 4 Mujorin e parë të vitit 2022, fondet janë realizuar në nivelin 26% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

- Produkti “Inspektime të kryera”, është realizuar në masën 23% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Raporte monitorimi” është realizuar në masën 32% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Akte ligjore dhe nënligjore, dokumenta strategjike”, është realizuar në masën 47% përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Dosje të shqyrtuara” është realizuar në masën 37% përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.

Në programin “Administrimi i Pyjeve” për 4 Mujorin e parë të vitit 2022, fondet janë realizuar në nivelin 26% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Produktet, të cilët kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit paraqiten si vijon:

- Produkti “Raporte monitorimi në Zonat e Mbrojtura”, është realizuar në masën 31% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Objekte të administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura” është realizuar në masën 25% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Inventarizim dhe kadastër e kryer” është realizuar në masën 23% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Plane menaxhimi për pyjet” është realizuar në masën 22% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.

Në programin “Zhvillimi i Turizmit” për 4 Mujorin e parë të vitit 2022, fondet janë realizuar në nivelin 35% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Produktet të cilët kanë kontribuar në realizimin e objektivave të këtij programi paraqiten si vijon:

- Produkti “Monitorime të kryera përgjatë gjithë vijës bregdetare”, është realizuar në masën 23% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Turizëm i promovuar” është realizuar në masën 14% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2022.
- Produkti “Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit”, pritet të realizohet në periudhën e sezonit veror.

DREJTËSIA

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet në Ministrinë Drejtësisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 43: Drejtësia

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4-mujori 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	428,087	205,600	97,935	735	22.9	0.4
2.	Publikimet Zyrtare	54,522	2,000	12,480	0	22.9	0.0
3.	Mjekësia Ligjore	82,850	5,000	17,166	0	20.7	0.0
4.	Shërbimi për Çështjet e Birësimit	14,965	200	3,426	73	22.9	36.6
5.	Agjencia e trajtimit të pronave	3,738,820	6,000	53,603	0	1.4	0.0
6.	Ndihma juridike	76,900	2,000	9,683	0	12.6	-
7.	Shërbimi i Përmbarrimit gjyqësor	146,854	3,000	38,451	0	26.2	-
8.	Sistemi i Burgjeve	5,607,275	360,900	1,871,243	0	33.4	0.0
9.	Shërbimi i Provës	149,687	2,000	41,101	0	27.5	0.0
	TOTAL	10,299,960	586,700	2,145,087	808	20.8	0.1

Në programin “**Sistemi i burgjeve**” për 4 mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar produkte, janë realizuar produktet për të matur performancë e Sistemit të Burgjeve, si dhe projekte që shërbejnë për përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar, me një kosto faktike 1.8 miliardë lekë.

- Rezultojnë se për 4 mujorin janë trajtuar 4,957 të dënuar burra në IEVP;
- Janë trajtuar 362 raste të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor;
- Janë të trajtuara në kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit 62 të dënuara femra;
- Janë trajtuar 20 të mitur të dënuar të cilët vuajnë dënimin në ambientet të përshtatshme për vuajtjen e dënimit;

Në programin “**Agjencia e Trajtimit të Pronave**” janë realizuar produkte me kosto faktike prej 53.6 milionë lekë, ndër produktet përmendim:

- Shpërndarja e fondit fizik dhe financiar për 206 subjekte të planifikuara me një kosto faktike prej afërsisht 52.5 milionë lekë.
- Mbrojtja e interesave të ATP në proceset gjyqësore, janë ndjekur 148 raste gjyqësore që kanë të bëjnë me çështje njohje të drejte pronësie apo që kanë të bëjnë me vlerësimin e pronës së njohur për kompensim me një kosto faktike prej 1 milionë lekë.
- Shpërndarja e fondit të ish-ALUIZNIT, janë trajtuar 244 subjekte, pagesa e të cilëve është bërë me fondet e mbartura nga viti 2021 dhe 2022 që ndodhen në Bankën e Shqipërisë e cila i korrespondon një shume prej 553 milionë lekë. Ndërsa për 640 aplikimet e bëra në 4 mujorin e parë ende nuk ka nisur procesi i pagesave.

INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për 4 mujorin e parë të vitit 2022 për institucionet e Sistemit të Drejtësisë, paraqiten si më poshtë:

Tabela 44: Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit/Institucionit	Plani 2022		Fakti 4-mujori 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Inspektoriat i Lartë i Drejtësisë	196,443	64,000	40,966	0	21	0
2	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	228,435	2,000	73,565	0	32	0
3	Kolegji i Posaçëm i Apelit	192,840	2,000	48,352	0	25	0
4	Komisionerët Publikë	71,335	2,000	21,762	0	31	0
5	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	974,301	30,000	127,866	0	13	0
6	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3,224,726	412,000	885,082	2,383	28	1
7	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	141,775	8,000	45,126	6,956	32	87
8	Gjykata Kushtetuese	147,109	19,000	42,575	0	29	0
	Totali	5,176,964	539,000	1,285,294	9,339	25	2

Në lidhje me disa nga treguesit e performancës për institucionet e drejtësisë përmendim:

- Institucioni i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), tregues të performancës ka numrin e dosjeve të shortuara, numri i dosjeve të shqyruara dhe vendime të marra. Konkretisht raportohet se prej fillimit të veprimtarisë, janë shortuar 805 subjekte rivlerësimi dhe për 4 mujorin e parë të vitit 2022 janë marrë 31 vendime dhe janë shqyrtuar afërsisht 300 dosje.

- Për Komisionerin Publik produkti është “Çështje të njoftuara nga KPK dhe shqyrtuar nga KP brenda afateve ligjore”, ku rezulton se përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 nga 160 të planifikuara për vitin 2022, janë realizuar në sasi 33 çështje, shoqëruar me një kosto prej 22 milionë lekë.
- Për Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë produkti Inspektime të kryera, përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 është realizuar me rreth 20% kundrejtë sasisë vjetore të planifikuar, Pranë zyrës së ILD gjatë periudhës janar – prill 2022 janë depozituar 585 ankesa nga 2,963 të planifikuara për vitin 2022.
- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për përmbushjen e objektivit të saj “Lufta kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, ustrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës pranë Gjykatave të Posaçme dhe Gjykatës së Lartë” ka përfunduar 26 % të çështjeve të regjistruara si edhe ka përfunduar gjykimi për 39 % të personave të regjistruar për tu gjykuar.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka si tregues performance numër çështjesh të gjykuara, ku përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 janë gjykuar rreth 44,518 çështjem shoqëruar me një kosto prej 819 milionë lekë.

FINANCAT, EKONOMIA, PUNËSIMI DHE ARSIMI PROFESIONAL

Shpenzimet e planifikuara për vitin 2022 dhe ato faktike për 4M I, si dhe realizimi në përqindje për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për disa nga programet kryesore, paraqiten si mëposhtë:

Tabela 45: Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4 mujour		Përqindja e realizimit	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	525,599	203,000	154,208	170	29.34	0.08
Financim i huaj		350,000		19,250		5.50
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	359,421	0	128,032	0	35.62	-
Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	586,889	0	156,119	0	26.60	-
Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,853,699	342,640	651,545	40,142	22.83	11.72
Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,602,600	153,220	1,151,677	7,070	31.97	4.61
Financim i huaj		120,690		669		0.55
Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	74,775	2,000	20,102	0	26.88	-
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	360,470	71,800	77,694	0	21.55	-
Financim i huaj		150,000		7,134		4.76
Mbështetje për Mbikq. e Tregut, Infrast. e Cilës. dhe Pron. Industr.	296,100	16,500	90,366	40	30.52	0.24
Inspektimi në Punë	162,697	4,500	48,160	2,000	29.60	44.44
Strehimi	1,322,400	400,000	808,159	41,654	61.11	10.41
Arsimi i Mesëm Profesional	2,032,277	280,669	602,605	3,224	29.65	1.15
Financim i huaj		317,310		2,540		0.80
Sigurimi Shoqëror	53,999,424	0	14,272,931	0	26.43	-
Tregu i Punës	2,303,235	71,000	557,229	0	24.19	-
Totali	68,479,585	2,483,329	18,718,829	123,894	27.33	4.99

Sipas të dhënave të 4 mujorit nxjerr nga Sistemi Financiar dhe Informatik i Qeverisjes, realizimi faktik i shpenzimeve korentë paraqitet në mesataren e periudhës, ndërsa investimet sipas raportimit për 4 mujorin të dërguar nga MFE pritet të kenë realizim më të lartë në periudhën në vazhdim.

Sa i përket programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**”, objektivi i këtij programi është “*Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, aplikimi i metodave dhe sistemeve të reja; modernizimi, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore si rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë; Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore; hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor; zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut; përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore; mbledhja efikase dhe efektive e borxhit*”.

Për arritjen e këtij objektivi, për 4M I 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

- *Tatimpagues të asistuar, realizuar në masën 122 416 me vlerë 621 219 mijë lekë.*
- *Inspektime, hetime tatimore, realizuar 32 inspektime me vlerë 427 mijë lekë.*
- *Vendime gjyqësore të ekzekutuara, janë realizuar 139 nga 193 të planifikuara, në vlerën 29 900 mijë lekë.*
- *Kompensimi i shoqërive të linjave të transportit. U planifikua në vlerën për kompensimin e shoqërive të linjave të transportit, bazuar në VKM Nr.225 datë 13.04.2022, në vlerën 430mln lekë.*

Sa i përket programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Doganore**” objektivi kryesor i këtij programi është *krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomikë nëpërmjet lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave doganore*. Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet:

- *Deklarata doganore të procesuara në masën 194 974 deklarata nga 720 500 deklarata të planifikuara, me një kosto faktike prej 512 004 mijë lekë.*
- *Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara, realizuar 2 vendime gjyqësore me një kosto faktike prej 368 mijë lekë.*

Lidhur me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare nga: kontrabanda, trafiket paligjshme, mallrat e ndaluara e falsifikuara, evazioni fiskal etj.

- *Janë kryer 542 inspektime nga 1610 inspektime të planifikuara, në vlerën 1,532 mijë lekë.*
- *Janë kryer 1,497 hetimeve në vlerën 33,772 mijë lekë. Nga të cilat strukturat e antikontrabandës 697 inspektime doganore dhe nga Antitrafiku 800 inspektime.*
- *Shërbim skanimi, produkt i realizuar në vlerën 604,002 mijë lekë, shërbimi i skanimit është efektiv në pesë pika doganore.*

Në programin “**Tregu i Punës**” i cili ka si objektiv “*Nxitjen e mundësive për punë të denjë dhe rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës si dhe nëpërmjet përputhjes së kërkesës me ofertën për punë nga shërbimet e punësimit*” ku përfshihen: Informacioni për vendet e lira të punës; ndërmjetësimi për punësim; këshillimi dhe orientimi për karrierë; programet e nxitjes së punësimit; mbështetjes me të ardhura për të papunët nëpërmjet pagesës së papunësisë; Programet e formimit profesional; Ofrimi formimit profesional cilësor; Nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial; Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve. Për 4-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si më poshtë:

- *Janë realizuar 7 652 ndërmjetësime edhe punësime për punëkërkues të papunë me një kosto faktike prej 90 074 mijë lekë.*
- *Punëkërkues të papunë të trajtuar me pagesë papunësie, janë trajtuar 2 870 persona me një kosto faktike prej 233 047 mijë lekë.*
- *Punëkërkues të papunë pjesëmarrës në formimit profesional kanë marrë pjesë 2 736 pjesëmarrës, me një kosto faktike prej 91 198 mijë lekë.*
- *Leje pune për të huajt, evidenca statistikore, financiare, procedura prokurimi etj. janë nxjerr 1876 akte me një kosto faktike prej 27 112 mijë lekë.*

Programi “**Strehimi**” ka si objektiv të sigurojë strehim të përshtatshëm e të përbalueshëm për individë e familje që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave. Sa i takon realizimit të 4-mujorit të parë për vitin 2022 mund të rendisim sa më poshtë:

- *Subvencionimi i interesave për kreditë ekzistuese, është realizuar në vlerën 26 359 mijë lekë dhe kanë përfituar 4 330 familje.*
- *Subvencionimi i interesave të kredive të reja, me vlerën 1 267 mijë lekë, dhe kanë përfituar 95 familje.*
- *Subvencionimi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti, janë alokuar 1 000 000 mijë lekë për vitin 2022 dhe realizimi faktit i fondeve është në vlerën 736 736 mijë lekë. Numri i familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë për këtë vit është 10 630.*
- *Granti i menjëhershëm, nuk ka pasur përfitues pasi janë duke u shqyrtuar kërkesat e 7 bashkive dhe pritet të ketë realizim faktik për muajt në vijim.*
- *Përmirësim i kushteve të banimit, është alokuar vlera 270 000 prej mijë lekë tek Njësitë e Qeverisjes Vendore, nga atë cilat janë realizuar 31 901 mijë lekë, dhe kanë përfituar 72 familje nga 415 të parashikuara.*
- *Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për Strehim Social, është alokuar vlera prej 130 000 mijë lekë tek Njësitë e Qeverisjes Vendore, nga atë cilat janë realizuar 9 753 mijë lekë, dhe kanë përfituar 18 familje nga 81 të parashikuara për këtë vit.*

MBROJTJA

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për 4 mujorin e parë 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 46: Mbrojtja

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4M		Përqindja e realizimit	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,316,356	320,000	231,736	0	17.6%	0.0%
Forcat e Luftimit	5,928,739	4,136,500	1,465,306	19,031	24.7%	0.5%
Arsimi Ushtarak	803,551	500,000	237,950	0	29.6%	0.0%
Mbështetja e Luftimit	5,870,927	1,113,000	1,240,124	72,295	21.1%	6.5%
Mbështetje për Shëndetësinë	919,930	200,000	303,267	39,536	33.0%	19.8%
Emergjencat Civile	1,547,225	2,070,000	49,124	0	3.2%	0.0%
Sigurimet Shoqerore per ushtaraket	5,310,665	0	1,730,592	0	32.6%	0.0%
Totali	21,697,392	8,339,500	5,258,099	130,862	24.2%	1.6%

Për vitin 2022 objektivi kryesor në programin “**Planifikimi menaxhimi administrimi**” është Menaxhimi me efikasitet dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare. Realizimi i fondeve në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korentë rezulton në masën 18 përqind, ndërkohë për grupin e projekteve dhe investimeve ka mosrealizim të fondeve.

Treguesit e performancës për këtë objektiv janë:

- *Rritja e % e punonjësve të trajnuar kundrejt totalit.*
- *Numër raportesh vlerësimi të kryera,*
- *Numër Aktesh ligjore e nënligjore të përgatitura kundrejt planifikimit,*
- *Numër Auditimesh të kryera kundrejt planifikimit,*
- *Rritja e numrit të personave të rekrutuar,*
- *Rritja e numrit të Marrëveshjeve të realizuara kundrejt planifikimit.*

Për këtë program buxhetor janë realizuar 3 produkte si më poshtë:

- *Akte ligjore e nënligjore të përgatitura nga Ministria e Mbrojtjes, realizuar 100% kundrejt planit të periudhës.*
- *Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara, realizuar 100% kundrejt planit të periudhës.*
- *Sisteme të mirëmbajtura për aparatet e Ministrisë së Mbrojtjes*

Fondet e akorduara për programin “**Forca e Luftimit**” përbëjnë rreth 34 përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2022. Programi Forcat e Luftimit ka parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Realizimi i fondeve në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korrente rezulton në masën 25 përqind, ndërkohë për grupin e projekteve dhe investimeve ka realizim të ulët të fondeve, vetëm 0.5 përqind.

Objektivat e këtij programi për vitin 2022 janë:

- *Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Tokësore*
- *Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Detare*
- *Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Ajrore*

Treguesit e performancës për këto objektiva:

- *Përgatitja e trupave për misione paqeruajtëse.*
- *Aftësia dislokuese e trupave për përmbushjen e misionit në një kohë rekord.*
- *Ndërveprueshmëria e trupave për përmbushjen e misioneve në det.*
- *Kontrolli i hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.*

Fondet e akorduara për Programin “**Mbështetja e Luftimit**” përbëjnë rreth 23 përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për 4-mujorin e parë të vitit 2022. Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike për realizimin e tyre, si:

- *Sigurimi i logjistikes së nevojshme si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare. Treguesit e performancës për këtë objektiv janë:*
 - ✓ Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e Forcave të Armatosura.
 - ✓ Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC dhe CIMIC.
 - ✓ Dokumente të procesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- *Sigurimi i inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr.2:*
 - ✓ Përqindja e arritjes së përmbushjes së objektivave të kapaciteteve në fushën e inteligjencës ushtarake dhe të NATO-s.
 - ✓ Përqindja e arritjes së kapaciteteve të nevojshme operacionale.
- *Sigurimi dhe mbështetja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 3:*
 - ✓ Kapacitete operacionale për ASNI
 - ✓ Ruajtja e nivelit operacional për Repartin nr. 6630
 - ✓ Janë planifikuar 12 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente “ dhe 36 Projekte Investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”.

Realizimi i fondeve buxhetore për 4M I 2022 në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korrente rezulton në masën 21%, ndërsa realizimi i projekteve të investimeve arrin në masën 6.5%.

Fondet e akorduara për Programin “**Arsimi Ushtarak**” përbëjnë rreth 4.3 përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për 4-mujorin e vitit 2022. Ky program synon “Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet e NATO”.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- *Numër ushtarakësh të rinj të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve*
- *Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet.*
- *Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit.*
- *Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit.*
- *Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-ve.*
- *Numër personeli ushtarakë të gjinisë femra të pranuar në FA.*
- *Numër personeli i trajnuar/stërvitur.*

Realizimi i fondeve buxhetore sipas për 4-mujorin 2022 në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korente rezulton në masën 30 përqind, nërsa produktet e investimit janë në proces të përgatitjes së fillimit të procedurave të mëtejshme për realizimin e tyre.

Fondet e akorduara Mistrisë së Mbrojtjes për Programin “**Mbështetje për Shëndetësinë**” përbëjnë rreth 3.7 përqind të buxhetit me ndryshime, miratuar për MM në vitin 2022. Qëllimi i këtij programi është ‘Ofrimi i një Shërbimi sa më të Specializuar Mjekësor dhe Spitalor në nivel Universitar në trajtim në rang Kombëtar të politraumave”.

Treguesi i performancës për këtë qëllim:

- *Numri i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë dhe Terapisë*
- *Numri i Pacienteve të shtruar, të planifikuar dhe urgjente në SUT*
- *Numri i Operacioneve të sallës operatore të urgjencës*
- *Përqindja e vdekshmërisë.*

Objektivi i parë për këtë program është “Pritja dhe trajtimi i pacienteve të poli traumatizuar në kohe reale pranë Urgjencës të SUT”. Treguesi i performancës për këtë objektivi:

- *Nr. i Shtrimeve nga Urgjenca*
- *Nr. i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë*
- *Nr. i operacioneve në Sallat Operatore të Urgjencës*
- *Nr. i manipulimeve të ndryshme kirurgjikale*
- *% e Mortalitetit në Urgjencë*

Objektivi i dytë “Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacienteve të afuara nga specialitetet mjekësore pranë SUT”. Treguesi i performancës për këtë objektivi:

- *Nr. i shtrimeve reanimatore*
- *Nr. i operacioneve sipas specialiteteve mjekësore në bllokun operator të SUT*
- *Nr. i Ekzaminimeve imazherike*
- *Nr. i Ekzaminimeve Laboratorike*
- *Ditë Qëndrimi në spital*
- *Koeficienti i shfrytëzimit të shtratit etj*

Për programin “Mbështetje për Shëndetësinë”, realizimi i buxhetit për shpenzimet korrente të programit kundrejt buxhetit të akorduar për vitin 2022 është në nivelin 33%, ndërkohë realizimi i projekteve të investimeve arrin në masën 19.7 përqind.

Fondet e miratuara për vitin 2021 për programin “**Emergjencat Civile**” përbëjnë rreth 12% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave:

- *Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.*
Tregues performance:
 - ✓ *Jetë të shpëtuar*
 - ✓ *Familje të dëmshpërblyera*
 - ✓ *Infrastrukturë dhe mjedis i mbrojtur*
- *Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore.* *Tregues performance:*
 - ✓ *Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti, të cilat do të përdoren për t’i ardhur në ndihmë 4 000 familjeve të prekur nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore për një periudhë 1 mujore.*

Realizimi i fondeve buxhetore sipas për 4-mujorin 2022 në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korente rezulton në masën 3.17 përqind, nërsa produktet e investimit janë në proces të përgatitjes së fillimit të procedurave të mëtejshme për realizimin e tyre.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Performanca e treguesve buxhetorë për 5 programet e Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 47: Rendi dhe Siguria Publike

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4M		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	1,169,831	96,250	340,422	0	29.1%	0.0%
2	Policia e Shtetit	15,298,890	789,201	4,912,419	36,663	32.1%	4.6%
	<i>Financimi i huaj</i>		335,290		389,037	-	116.0%
3	Garda e Republikës	1,725,855	29,000	545,541	-	31.6%	-
4	Shërbimi i Gjendjes Civile	477,977	60,000	129,938	-	27.2%	-
5	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguar	490,914	62,000	137,725	0	28.1%	0.0%
	<i>Financimi i huaj</i>		15,000		3,252	-	21.7%
	Totali	19,163,468	1,386,741	6,066,044	428,951	31.7%	30.9%

Në programin “Policia e Shtetit”, realizimi i fondeve për shpenzimet korente është 32 % ndaj planit vjetor ndërsa produktet e investimit janë realizuar në masë 38%.

Qëllimi i këtij programi është: *“Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestëruar dhe goditur veprimtarinë e krimit të organizuar e rrjetet kriminale, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm. Përforcimi i zbatimit të ligjit për rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe asaj rrugore. Menaxhimi efektiv, efiçent dhe i integruar i kufijve nëpërmjet mirëfunksionimit të 27 pikave të kalimit kufitar në Republikën e Shqipërisë. Forcimi i kapaciteteve institucionale, garantimi i pavarësisë operacionale të policisë së shtetit dhe konsolidimi i arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit.”* Qëllimi i programit realizohet nëpërmjet 4 objektivave dhe 16 produkteve të realizuar përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, të cilat paraqiten si vijon:

Objektivi 1 *“Rritja e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndër-institucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit”.* Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Realizimi i 56 *“Operacione të posaçme Konvencionale”* apo 80 % e sasisë së planifikuar, me një kosto totale prej 102 milionë lekë.
- Janë kryer 12,388 *“Operacione policore të hetuara dhe shërbime”*, apo 94% e sasisë së planifikuar për periudhën, me një kosto totale prej 2,651 milionë lekë.
- Janë realizuar 15 *opracione ndaj ekstermisteve e grupeve terroriste*, apo 88% e sasisë së planifikuar për periudhën.
- 49 *“Persona me cilësi të veçantë të mbrojtur”*, apo 86% e sasisë së planifikuar për periudhën, me një kosto totale prej 48 milionë lekë.

Objektivi 2 *“Rritja e sigurisë Publike dhe Sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet”.* Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Realizimi i 2,076 *“Shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale”*, apo 91% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 85 milionë lekë.
- Janë realizuar 177 *“Shërbime të Forcave Speciale dhe e NSH për sigurimin e Rendit Publik”*, apo 87% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 309 milionë lekë.
- 19 *objekte dhe personalitete të siguruar*, apo 95% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 89 milion lekë.

Objektivi 3 *“Forcimi i masave për luftën kundë krimin ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standarteve të sigurisë së kufijve sipas standarteve të BE-së dhe Kodit Schengen”*.

Për realizimin e objektivit kanë kontribuar 3 produkte përgjatë 4 mujorit, të cilët konsistojnë në:

- U realizuan 12 operacione të sigurisë në kufirin blu, apo 86% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 38 milionë lekë.
- Janë procesuar 10,883,981 persona në PKK, kategoria I; II dhe e II-të (ajrore, detare, tokësore), apo 95% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 675 milionë lekë.
- Janë trajnuar 44 Qen policie në kushte shërbimi, apo 71% e sasisë së planifikuar për 4M.

Objektivi 4 *“Përafrimi i standarteve të shërbimeve policore me ato të BE-së”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar 3 produkte përgjatë 4 mujorit, të cilët konsistojnë në:

- U trajnuar 140 rekrut të trajnuar në auditore dhe në terren, apo 56% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 27 milionë lekë.
- U trajtuan 1618 punonjës me pagesë kalimtare, apo 72% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me kosto totale prej 74 milion lekë.
- Janë hartuar 7486 raporte për menaxhimin e burimeve finaciare dhe njerzore, apo 85 e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 896 milion lekë.

Programi “Garda e Republikës”, realizimi i fondeve për shpenzimet korente është 31 % ndaj planit vjetor ndërsa për produktet e investimit nuk ka realizim për periudhëm. Qëllimi i këtij programi është: *“Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e nivelit 100% të sigurisë”*. Qëllimi i programit realizohet nëpërmjet objektivave specifike të parashikuara dhe 1 produkti të realizuar përgjatë 4-mujorit, me specifikisht i paraqitur si më poshtë:

- Është realizuar ruajtja e 110 personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto prej 545mln lekë.

Në programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, ka realizim të fondeve rreth 24% ndaj planit vjetor, duke realizuar kështu edhe qëllimin e politikës së programit, e cila është : *“Konsolidimi i mëtejshëm të një sistemi të dixhitalizuar të regjistrimit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrimit kombëtar të adresave (RKA) dhe regjistrimit/përditësimi i të dhënave të shtetasve në Republikën e Shqipërisë me vërtetësi dhe në kohë reale.”* Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet produkteve:

- Rregjistrimit të 288,910 akte dhe dokumente të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 129 milionë lekë.
- Nëpërmjet funksionimit të sistemit të adresave të përmirësuar dhe rritjen e funksionalitetit të RKGJC.

Programi “Prefektura dhe Funksionet e Deleguara”, ka realizuar fondet për shpenzimet korrente për 4 mujorin e parë të vitit 2022 në masën 28%. Qëllimi i politikës së programit është: *“Ndjekia e zbatimit të programit të Qeverisë në nivel vendor si përfaqësues i qeverisë”, i cili synohet të realizohet nëpërmjet objektivit: “Rritja e performacës së Prefektit të Qarkut në nivel vendor për zbatimin e reformës Administrativo-Territoriale”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Janë kryer 462 monitorime në nivel qarku nga Perfekti i Qarkut, apo 58% e sasisë së planifikuar, me kosto prej 18.7 milionë lekë.
- Është dhënë ndihmë për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale, me kosto rreth 5.5 milionë lekë.
- Janë trajtuar 122 kërkesa për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, apo 77% e sasisë së planifikuar, me kosto rreth 20 milionë lekë.

KULTURA

Performanca e treguesve buxhetorë për programet e Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 48: Kultura

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4 mujori I 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikim, menaxhim administrim	159 390		44 589		28%	
2.	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	606 900	98 522	143 709	4 722	23.7%	0.8%
3.	Arti dhe Kultura	1 266 401	2 137 500	281 919	3	22.3%	
	Totali	2 032 691	2 236 022	470 216	4 724	23.1	0.2%

Në të gjitha programet, niveli i realizimit të planit të shpenzimeve korrente është i lidhur me mosplotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucioneve si edhe me procedurat e prokurimit të mallrave e shërbimeve, proces ky që zgjat deri në finalizimin e lidhjes së kontratës, por, është parashikuar që realizimi i këtyre shpenzimeve në periudhat në vijim do të ndryshojë ndjeshëm. Ndërsa niveli i ulët i realizimit të investimeve është lidhur me kohën procedurale që zënë prokurimet.

Në programin **“Trashëgimia Kulturore”** është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Kështu gjatë 4 mujorit 2022:

- Me një kosto rreth 72.9 milion lekë, janë kryer punime mirëmbajtje dhe restaurime në 73 objekte, si edhe ndërhyrje restauruese, konsoliduese, pastrime nga vegjetacioni apo mirëmbajtje.
- Gjithashtu janë zhvilluar 74 aktivitete edukuese dhe promovuese, ekspozita, botime, etj.
- Janë kryer 4 projekte pastrim mirëmbajtje-pastrim vegjetacioni në Kalanë e Shkodrës, në Kalanë e Drishtit dhe në Urën e Mesit. Janë kryer edhe 17 aktivitete mbi edukimin për kulturën dhe promovimin
- Në Berat është kryer ndërhyrje restauruese në fasadat e dy banesave në lagjen “Kala”, si edhe mirëmbajtje pastrim dhe punime mirëmbajtje në lagjen Kala.
- Në Korçë është në proces “Restaurimi i pikturave murale në kishën e Shën Kollit, Voskopojë”, ndërsa në muzeun kombëtar të artit Mesjetar janë zhvilluar 3 aktivitete.
- Në kalanë e Gjirokastrës gjatë 4 mujorit ka patur 6 681 vizitorë. Janë kryer 20 restaurime të pjesshme, mirëmbajtje e pastrim vegjetacioni në kalanë e Gjirokastrës, resaturim banesash.
- Në Krujë muzeu kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik Krujë, 9 698 vizitorë.
- Ndërsa në Vlorë muzeu kombëtar “Pavarësia” ka patur 277 vizitorë vendas dhe të huaj.
- Gjithashtu, veprimtaria muzeale vijoi nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, Muzeun Historik Kombëtar ku janë zhvilluar 43 aktivitete, 5 ekspozita, aktivitete për promovime librash.
- Janë zhvilluar aktivitete, të fushës së trashëgimisë jomateriale, ku, pas thirrjes së hapur që Ministria e Kulturës shpall për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë janë zhvilluar 6 aktivitete për promovimin e vlerave kulturore-artistike, ruajtjen/mbrojtjen/promovimin e trashëgimisë kulturore.

Programi **“Arti dhe Kultura** ka për qëllim, edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenes artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike. Kështu gjatë 4 mujorit të parë 2022 janë realizuar:

- 61 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar (94.5 milion lekë)
- 51 Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit teatror klasik dhe bashkëkohor (51mln leke);
- 127 premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror eksperimental klasik dhe bashkëkohor (10.3 mln lekë);

- 9 ekspozita me vepra pjesë e fondit të GKA, të përkohshme të traditës dhe bashkëkohore, autorë të diasporës dhe të huaj (10.5 milion lekë),
- 13 veprimtari edukuese të teatrit me dhe për fëmijë (12 milion lekë),
- 13 veprimtari artistike në zhanrin e cirkut dhe eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike bashkëkohore (12.6 milion lekë).
- 64 aktivitete për qytetarët përdorues dhe frekuentues të koleksioneve bibliotekare (30.9 mln lekë).

POLITIKA E JASHTME

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimit dhe fuqizimit të diplomacisë ekonomike si dhe bashkërendimin e ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian. Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 49: Politika e Jashtme

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2022		Fakti 4 M 2022		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	237,985	55,000	65,275	15,832	27.4	28.8
2.	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,238,809	15,000	289,602	0	12.9	0.0
3.	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	193,709	0	52,318	0	27.0	-
4.	Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit	77,429	101,780	18,366	13,783	23.7	13.5
	TOTAL	2,747,931	171,780	425,562	29,615	15.5	17.2

Programi **“Mbështetje diplomatike jashtë vendit”**, zhvillon aktivitetet që synojnë nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm, mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare dhe përkujdesin ndaj qytetarëve shqiptarë kudo ata ndodhen. Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 289.6 milionë lekë. Në këtë program ndër produktet kryesore përmendim:

- *“Mbështetja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese”, për 60 nga 364 punonjës të planifikuar.*
- *“Kuota ndërkombëtare” është kryer pagesa për 9 kuota nga 53 të planifikuara, ku veni ynë është palë si detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA-s; UNIDO-s; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO-s; OSBE-së etj.*

Programi **“Aktiviteti diplomatik dhe konsullor”** ka për qëllim:

zgjerimi, intensifikimi, diversifikimi dhe pasurimi i marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjik, vendet e Rajonit dhe Evropës dhe vende të tjera të botës, për të mbështetur mirëkuptimit dhe të respektit të ndërsjellët midis kombeve, respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit rajonal, dhe solidaritetit ndërkombëtar. Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 52.3 milionë lekë, ku përmendim:

- *Janë hartuar 8 nga 24 akte ligjore dhe nënligjore të planifikuara në kuadër të intensifikimit të punës, përpjekjeve dhe koordinimit ndër-institucional në procesin e përmbushjes së detyrimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE.*
- *Janë zhvilluar gjithashtu takime dypalëshe dhe shumëpalëshe, në kuadër të zhvillimit dhe forcimit të marrëdhënieve me partnerë strategjik, vendet e rajonit si dhe si dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare përfshirë këtu edhe në Këshillin e Sigurimit në OKB me një peridicitet 1-3 herë në muaj.*

Programi “**Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit**” synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet bashkërendimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, menaxhimit të fondeve të BE-së, zhvillimit të negociatave të anëtarësimit të RSH në BE. Në përmbushje të synimit janë kryer disa aktivitete, me një kosto faktike 33.3 milionë lekë, ndër to përmendim:

- *2 takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.*
- *U zhvillua takimi i Nën Komitetit Inovacionit, Shqipëria e Informacionit dhe Politikave Sociale, në 27 Janar 2022.*
- *U hartua kontributi i parë i qeverisë shqiptare në raportin e Komisionit 2022 dhe iu paraqit shërbimeve në Komisionit Evropian.*

VII.3 Ecuria e detajuar e projekteve të investimeve publike, gjatë Janar-Maj 2022

Ecuria e investimeve publike për 5-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet më e ulët krahasuar me vitet e mëparshme për të njëjtën periudhë raportimi. Realizimi i ulët është i lidhur me faktorë të jashtëm dhe të brendshëm si rritja e çmimeve të materialeve të ndërtimit, dhe inputeve të tjera të prodhimit, kujdesin e treguar kundrejt goditjeve të papritura që mund të sjellin çmimet e energjisë, vonesa në procedurat tenderuese për projektet e reja etj.

Nga ministritë e linjës pavarësisht realizimit të deritanishëm, është raportuar se deri në fund të vitit do të kryhen të gjitha procedurat e prokurimit dhe do të vijohet normalisht me realizimin e fondeve për projektet e investimeve. Deri në fund të muajit Maj 2022 janë raportuar disa kontrata për projekte investimi të përfunduara. Ndërkohë, po vijohet me zbatimin e kontratave për projektet e investimeve të parashikuara për vitin 2022. Numri më i lartë i kontratave për projektet e investimit të përfunduara i takon MIE dhe konkretisht projektet në Infrastrukturë.

Mëposhtë paraqitet shkurtimisht projektet kryesore të financuara deri në fund të muajit Maj dhe projektet kryesore të përfunduara nga ministritë e linjës.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 17.8% e buxhetit fillestar realizuar në masën 492.7 milionë lekë dhe 19.3 % referuar AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5-mujorin e vitit 2022 është 20.9 % e buxhetit fillestar realizuar në masën 662 milionë lekë dhe 23.1% të planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve. Procedurat e prokurimit janë në proces dhe në vijim do të realizohen edhe shpenzimet për projektet e investimeve.
- Programet me realizimin më të mirë përse i përket projekteve me financim të brendshëm janë: “Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.” realizuar 25.6% kundrejt planit prej 946 milionë lekë dhe “Menaxhimi i infrastruktures së kullimit dhe ujitjes” realizuar 20% kundrejt planit 993 milionë lekë.
- Programet me realizimin më të mirë përse i përket projekteve me financim të huaj janë: “Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.” realizuar 23.4% kundrejt planit prej 2,413 milionë lekë dhe “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” realizuar 24.9% kundrejt planit 388 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin 2022 paraqiten si vijon:

- ✓ *Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1 në vlerën 148 milionë lekë;*
- ✓ *Kosto Lokale "Fond garancie I Qeverise Shqiptare per projektin "Krijimi dhe lehtësimi i mbështetjes së agrobiznesit" (BERZH) në vlerën 75.7 milionë lekë;*
- ✓ *Rikonstruksion i Argjinatures se Selevecit, Vlore në vlerën 63.6 milionë lekë;*
- ✓ *Mbrojtje nga permbytja nga lumi Osum ne Uznove, Berat në vlerën 36 milionë lekë;*
- ✓ *Rehabilitim hidrovorit te Karavastase në vlerën 36 milionë lekë;*
- ✓ *Rikonstruksion I ISUV në vlerën 30 milionë lekë.*
- Për periudhën 5muajore të vitit 2022 është mbyllur kontrata për projektin:
 - ✓ *"Mbrojtje nga permbytja nga lumi Osum ne Uznove, Berat" me vlerë totale projekti 52 milionë lekë;*

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5muajorin 2022 është 19.7% e buxhetit fillestar realizuar ne masën 5,016 milionë lekë dhe 20.8% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5M 2022 është 15.9% e buxhetit fillestar, realizuar në masën 2,708 milionë lekë dhe 19.3% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Nga kjo ministri nuk është raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve.
- Ndërkohë, me VKM nr.111 datë 02.03.2022 është miratuar fusha e re e përgjegjësisë së MIE, e cila ka hequr programin *"Menaxhimin e mbetjeve urbane"*. Në këto kushte nuk është bërë detajimi dhe nuk ka realizim fondesh për këtë program, pasi fondet buxhetore në këtë program pritet që të rialokohen.
- Njëkohësisht për programin *"Furnizimi me ujë dhe kanalizime"* detajimi i fondeve është bërë me vonesë pasi me VKM nr.302 datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"* sistemi i ndërmarjeve të ujësjellës kanalizimeve është reformuar. Në këto kushte pavarësisht detajimit të projekteve me vonesë pritet që realizimi për projektet e investimeve të vijojë normalisht, sepse shumica e kontratave janë në vijim dhe kanë vijuar me punimet.
- Programet me realizimin më të mirë përse i përket projekteve me financim të brendshëm paraqiten: *"Mbeshtetje per Burimet Natyrore"* me realizim 44% kundrejt planit prej 91 milionë lekë, programi *"Mbeshtetje per Industrine"* me realizim 42.1 % kundrejt planit prej 64 milionë lekë, programi *"Mbeshtetje per Energjine"* me realizim 37.5% kundrejt planit prej 200 milionë lekë, programi *"Transporti Hekurudhor"* me realizim 34.5% kundrejt planit prej 400 milione lekë, programi *"Transporti Rrugor"* me realizim 26.6 % kundrejt planit prej 15,575 milionë lekë, programi *"Menaxhimi i Mbetjeve Urbane"* me realizim 17.6% kundrejt planit prej 1,067 milionë lekë dhe programi *"Furnizimi me Uje dhe Kanalizime"* me realizim 5.9 % kundrejt planit prej 6,486 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve me financim të brendshëm për 5muajorin 2022, paraqiten si vijon:
 - ✓ *Ndërtim i Tunelit të Llogarasë në vlerën 1.35 miliardë lekë;*
 - ✓ *Kontrata e Koncesionit /PPP për permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges se Arbrit në vlerën 420 milionë lekë;*
 - ✓ *Subvencioni I kontrates koncesionare per ndertimin, permiresimin, shfrytëzimin, mirembajtjen dhe rehabilitimin e autostrades Milot – Morine në vlerën 380 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim rruga Kardhiq - Delvine Loti 7 në vlerën 206 milionë lekë;*
 - ✓ *Plotesimi i punimeve dhe rruget lidhese ne Unazen lindore, Loti 2 në vlerën 190 milionë lekë;*
 - ✓ *Impjanti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier në vlerën 188 milionë lekë;*

- ✓ *TVSH per zbatimin projektit te linjes Tirane - Durres, per ndertimin e linjes se re Tirane-Rinas në vlerën 126 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Loti 2 në vlerën 120 milionë lekë;*
 - ✓ *Kosto Lokale projekti I kanalizimeve te Tiranës se madhe në vlerën 110 milionë lekë;*
 - ✓ *TVSH Programi i Infrastruktues Bashkiake, III dhe IV në vlerën 109 milionë lekë;*
 - ✓ *Shpronësime në vlerën 106 milionë lekë;*
 - ✓ *Përfundimi i punimeve në segmentet rrugore ura e Kranesë Qafë Botë, Ura e Kranesë Ura e Gajdarit dhe përmirësimi i segmentit rrugor Shijan Ura e Gajdarit në vlerën 93 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim rruga Palase – Dhërmi në vlerën 91 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim rruga Porto Romano Durres, Loti 3, vazhdimi në vlerën 81 milionë lekë;*
 - ✓ *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 3 në vlerën 75 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (Sinjalistike dhe Siguri rrugore nga Loti 1 deri ne Lotin6 në vlerën 70 milionë lekë;*
 - ✓ *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti1 në vlerën 70 milionë lekë;*
 - ✓ *TVSH e T.D. Ndërtim By Pass i Vlorës (Kontrate e Re) në vlerën 60 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim rruga Korce - Erseke Loti 2 (pjesa e pare) në vlerën 50 milionë lekë.*
- *Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e e investimeve me financim të huaj për 5-mujorin për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë paraqiten si vijon:*
 - ✓ *Programi i Infrastruktues Bashkiake III dhe IV (Kredi) në vlerën 544 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim By Pass i Fierit në vlerën 372 milionë lekë;*
 - ✓ *Bypass i Vlores, Grant në vlerën 276 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim By Pass i Fierit (Kontrate e Re) në vlerën 216 milionë lekë;*
 - ✓ *RRSMSP/CË/2015/1- Kontrata A (Projekti i Bankes Boterore) në vlerën 157 milionë lekë;*
 - ✓ *Manaxhimi i mbetejeve te ngurta Vlore në vlerën 152 milionë lekë;*
 - ✓ *Programi i infrastruktues Bashkiake III dhe IV në vlerën 127 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim Segmenti 1, Aksi "Tirane-Elbasan" (Sauk km 0-Hyrje tuneli i Krrabes km13, në vlerën 103 milionë lekë;*
 - ✓ *RRSMSP/CË/2015/2- Kontrata B (Projekti i Bankes Boterore) në vlerën 101 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim segmenti rrugor Qukës - Qafë Pllaçë Loti 1 në vlerën 90 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim By Pass i Vlorës(Kontrate e Re) në vlerën 60 milionë lekë;*
 - ✓ *Fuqia energjitike dhe Siguria e Diges ne Kaskaden e Drinit në vlerën 60 milionë lekë.*
- *Për periudhën 5mujore 2022 janë mbyllur kontratat e investimit, ku veçojmë:*
 - ✓ *Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti2 me vlerë të plotë projekti 1904 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim rruga By Pass Perendimor Shkoder, Loti1 (shtese punimesh) me vlerë të plotë projekti 282 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndertim i lidhjes se rruges se Oroshit me rrugen e Kombit me vlerë të plotë projekti 139 milionë lekë;*
 - ✓ *Projekt Pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza me vlerë të plotë projekti 62 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion i Godines se DPD me vlerë të plotë projekti 41 milionë lekë;*
 - ✓ *Supervizion Punimesh Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1 me vlerë të plotë projekti 18 milionë lekë;*
 - ✓ *Blerja e Pajisjeve teknike të auditimit për procesin e mbikëqyrjes CPE Projekt për standartet e ndricimit rrugor dhe urban në Shqipëri me vlerë të plotë projekti 12 milionë lekë;*
 - ✓ *Blerje automjeti per inspektim AKSEM me vlerë të plotë projekti 6 milionë lekë;*
 - ✓ *Oponence teknike per kontrates koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtje e rruges Milot - Balldre me vlerë të plotë projekti 6 milionë lekë;*
 - ✓ *Blerje mjet transporti per kimikatet QGKRR me vlerë të plotë projekti 3 milionë lekë;*

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 9.8% e buxhetit fillestar realizuar në masën 211.6 milionë lekë dhe 11% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5mujorin 2022 është 4.9% e buxhetit fillestar dhe të ndryshuar, realizuar në masën 46 milionë lekë.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve. Projektet e reja janë në proces prokurimi dhe projektet në vazhdim vazhdojnë normalisht punimet dhe pritet që realizimi i shpenzimeve të bëhet në muajt në vijim. Ndërkohë për disa projekte pritet miratimi i bazës ligjore për të vijuar me realizimin si psh projektet e transfertave kapitale për IBRD.
- Programet me realizimin më të mirë përse i përket projekteve me financim të brendshëm janë: “Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore” me realizim 23.8% kundrejt planit prej 342.6 milionë lekë dhe programi “Planifikimi Menaxhimi dhe administrimi” me realizim 27.4% ndaj planit.
- Programi me realizim më të mirë përse i përket projekteve me financim të huaj është: “Planifikimi Menaxhimi dhe administrimi” me realizim 7.1% ndaj planit prej 350 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin janë:
 - ✓ Rritja e kapaciteteve të Hë për sistemin AFMIS me vlerë 27 milionë lekë;
 - ✓ Mirembajtja e sistemit të thesarit dhe blerje licenca Oracle me vlerë 28 milionë lekë;
 - ✓ Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT me vlerë 40 milionë lekë;
 - ✓ Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja me vlerë 41mln lekë;
 - ✓ Janë paguar 58 milionë lekë për projekte të strehimit social.
- Njëkohësisht për periudhën 5-mujore të vitit 2022 janë mbyllur kontratat e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë:
 - ✓ Projekti “Sistemi e-tax fraud&investigation” me vlerë të plote projekti 92 milionë lekë;
 - ✓ Projekti “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT” me vlerë totale projekti 91 milionë lekë.
 - ✓ Projekti “Ngritja e sistemit për shkëmbimin e Informacionit financiar me entitetet e huaja” me vlerë totale projekti 80 milionë lekë.
 - ✓ Rikonstrukcion dhe sinjalistike Dega Doganore Berat me vlerë totale projekti 83 milionë lekë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 1.9% e buxhetit fillestar realizuar në masën 76.4 milionë lekë dhe 2% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5mujorin 2022 është 37.7% e buxhetit fillestar realizuar në masën 121 milionë lekë, të cilat vijnë nga projektet e granteve në arsimin universitar dhe fondeve për shkencën.
- Realizimi 5M në tërësi paraqitet tepër i ulët, por sipas raportimeve të MAS pritet që realizimi të përshpejtohet në muajt në vijim, pasi zbatimi për një pjesë të fondeve bëhet me thirrje të cilat janë shpallur për aplikime nga NJQV-te. Procedurat e prokurimeve sipas raportimit janë në proces dhe pritet të finalizohen në muajt në vijim.
- Ndërkohë, projekti “Studim, projektim i konvikteve” në vlerën e 500 milionë lekë sipas VKM nr.641 datë 20/07/2020 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet “Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtim i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë”, do të zbatohet nga Bashkia Tiranë.
- Programet “Arsimi Universitar” dhe “Fonde për Shkencën” paraqesin një realizim perkatesisht 2% dhe 21.8%. Programet e tjera të MAS nuk paraqesin realizim në zërin e investimeve.
- Kjo ministri, për periudhën 5mujore 2022 nuk ka mbyllur asnjë kontratë.

Ministria e Kulturës

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5muajor 2022 është vetëm 0.1% e buxhetit fillestar, realizuar në masën 1.6 milionë lekë.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5muajorin 2022 është 2.5% e buxhetit, realizuar në masën 4 milionë lekë.
- Realizimi i investimeve paraqitet tepër i ulët. Pjesa më e madhe e fondeve për MK është akorduar për projekte të reja si Godina e Teatrit Tiranë në vlerën e 900 milionë lekë, Ndërtimi i Qendres Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave në vlerën e 200 milionë lekë dhe disa projektë të tjera.
- Aktualisht nga Ministria e Kulturës nuk janë kryer procedurat e prokurimit për pjesën më të madhe të projekteve, duke rrezikuar realizimin e fondeve deri në fund të vitit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5muajorin 2022 është 13.2% e buxhetit fillestar dhe të ndryshuar, realizuar në masën 177.6 milionë lekë.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5muajorin e vitit 2022 është 80.6 % e buxhetit, realizuar në masën 1,137 milionë lekë.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve. Procedurat e prokurimit për projektet e reja për disa projekte janë realizuar dhe disa të tjera janë në proces. Në muajt në vijim do të bëhet edhe realizimi i fondeve për projektet e miratuara.
- Përsa i përket projekteve me financim të brendshëm, programi me planin më të lartë paraqitet “Sherbimet e Kujdesit Dytesor” i cili është realizuar në masën 14.1% kundrejt planit prej 1,159 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve me financim të brendshëm për 5muajorin 2022 janë:
 - ✓ *Rikonstruksion i godines se pediatrie sp.Elbasan me vlerë 67 milionë lekë;*
 - ✓ *TVSH Ndertimi I Spitalit te Semundjeve Interne Q.S.U.T. në vlerën 50 milionë lekë;*
 - ✓ *Pagese e taksës se infrastruktures per rikonstruksionin e godines se infektivit ne QSUT-nderhyrje nga UNOPS në vlerën 24 milionë lekë.*
- Projektet me financim të huaj të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5muajorin 2022, paraqiten si vijon:
 - ✓ *Projekti Emergjencia Covid-19- kredi e Bankes Boterore në vlerën 591 milionë lekë;*
 - ✓ *Permiresimi i sistemit te shendetesise në vlerën 348 milionë lekë;*
 - ✓ *Faza e dyte e zbatimit te master-planit te qsut- kredi e CEB-it (perfundimi i dy kateve te sp.te ri te ndertuar dhe rikonstruksioni i 6-katshit) vazhdim I Master Planit në vlerën 177mln lekë.*
- Njëkohësisht, për periudhën 5muajore janë mbyllur kontratat e investimit:
 - ✓ *F.V. pajisje kompjuterike per godinen e Drejtorise Qendrore te OSHKSH-se me vlere te plote projekti 1,8 milionë lekë;*
 - ✓ *F.V unite dentare per kujdesin dentar te femijet me vlere totale projekti 14 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion supervizim dhe kolaudim i pediatrie infektive ne QSUT me vlere te plote projekti 26,5 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion, supervizim dhe kolaudim i godines se Arkives se Kartelave Mjekesore ne QSU Nene Tereza Tirane me vlere te plote projekti 9 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion supervizim dhe kolaudim i QKMZHRF Tirane me vlere te plote projekti 127 milionë lekë.*

Ministria e Drejtësisë

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 0.7% e buxhetit fillestar realizuar ne masën 4 milionë lekë dhe 0.8 % të planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj nuk ka realizim për 5mujorin 2022.
- Për këtë ministri, realizimi i investimeve paraqitet tepër i ulët. Ky realizim lidhet me faktin se shumica e projekteve të MD janë projekte të reja dhe janë në proces prokurimi. Megjithatë, nga MD nuk është raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin e vitit 2022 është 29.8% të buxhetit fillestar realizuar ne masën 27.1 milionë lekë.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5-mujorin e vitit 2022 është 17.5% e buxhetit fillestar realizuar në masën 14.1 milionë lekë.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin 2022, janë:
 - ✓ *Rikonstruksion i ambjenteve të pritjes dhe hollit në vlerën 16 milionë lekë;*
 - ✓ *Blerje pajisje në vlerën 7 milionë lekë.*

Ministria e Brendshme

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 8.7% e buxhetit fillestar realizuar ne masën 87.5 milionë lekë dhe 8.4% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5mujorin 2022 është 114.8% e buxhetit realizuar në masën 403 milionë lekë.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika të cilat do të ndikojnë në realizimin e projekteve të investimeve.
- Përsa i përket projekteve me financim të brendshëm, programi me realizimin më të mirë dhe me planin më të lartë është programi “Policia e Shtetit” i cili paraqitet me realizim 10.3% kundrejt planit prej 789 milionë lekë.
- Përsa i përket projekteve me financim të huaj, programi me realizimin më të mirë dhe me planin më të lartë është programi “Policia e Shtetit” i cili paraqitet me realizim 117% kundrejt planit prej 335 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin 2022, janë:
 - ✓ *Projekti “Rikonstruksion i godines se DVP Diber” me vlerë 45 milionë lekë;*
 - ✓ *Projekti “Pagese TVSH-je, -Mbeshtetje e BE për menaxhimin efektiv të kufijve të gjelbër, kufijtë blu në Shqipëri - EU4 SAFE ALB” me vlerë 36 milionë lekë.*
- Përsa i përket projekteve me financim të huaj të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin 2022, janë:
 - ✓ *Mbeshtetje e BE për menaxhimin efektiv të kufijve të gjelbër, kufijtë blu në Shqipëri - EU4 SAFE ALB me vlerë 341 milionë lekë.*
 - ✓ *Programi Policimit ne Komunitet faza e dyte (qeveria suedeze) me vlerë 25 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtim /Rikonstruksion i godines se PKK Qafe -Boti me vlerë 26 milionë lekë.*
- Njëkohësisht për periudhën 5-mujore të vitit 2022 është mbyllur kontratat e investimit:
 - ✓ *Projekti “Orendi e paisje zyre për Godinen e Re të SH.Ç.B.A” me vlere te plote projekti 39mln lekë.*

Ministria e Mbrojtjes

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 6.8% e buxhetit fillestar realizuar në masën 568.5 milionë lekë dhe 7.8% e planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Nuk ka realizim për projektet me financim të huaj për 5mujorin 2022.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika në realizimin e projekteve të investimeve.
- Përsa i përket projekteve me financim të brendshëm, programi me realizimin më të lartë janë: “Mbeshtetje për Shendetesine” i cili paraqitet me realizim 26.4% kundrejt planit prej 150 milionë lekë, programi “Forca e Luftimit” me realizim 9.4% kundrejt planit prej 4,653 dhe programi “Mbështetja e Luftimit” me realizim 8.4% kundrejt planit prej 1,113 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve për 5mujorin 2022 janë:
 - ✓ *Armatim i lehtë municion dhe pajisje e makineri për forcat e armatosura me vlerë 413 milionë lekë;*
 - ✓ *Ndërtimi i Muzeut të madh të Forcave të Armatosura me vlerë 58 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion Administrata e SUT me vlerë 38 milionë lekë;*
 - ✓ *Rikonstruksion i depoz nr.5 në G-D Shkozë me vlerë 29 milionë lekë.*
- Njëkohësisht për periudhën 5mujore 2022 është mbyllur kontrata e investimit për projektin “Rikonstruksion i parkut të automjeteve, i pikës së karburantit dhe Rrethimi i jashtëm dhe ndërtimi i sistemit të integruar të sigurisë me kamera, (Pashaliman)” me vlerë të plotë 23,4 milionë lekë.

Ministria e Turizmit dhe Turizmit

- Për projektet me financim të brendshëm, realizimi për 5mujorin 2022 është 44.4% e buxhetit fillestar realizuar në masën 258 milionë lekë dhe 48.6% të planit të ndryshuar me AN nr.3/2022.
- Për projektet me financim të huaj realizimi për 5mujorin 2022 është 26.4% e buxhetit realizuar në masën 129 milionë lekë.
- Kjo ministri nuk ka raportuar për problematika në realizimin e projekteve të investimeve.
- Përsa i përket projekteve me financim të brendshëm, programi me realizimin më të lartë është “Zhvillimi i Turizmit” i cili paraqitet me realizim 66.8% kundrejt planit prej 369 milionë lekë.
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve me financim të brendshëm për 5mujorin 2022, janë:
 - ✓ *Mbeshtetje Financiare Projekti BERZH në vlerën e 178 milionë lekë;*
 - ✓ *Permirësimi i infrastruktures dhe kthimi i Parkut Natyror “Syri i Kalter” në destinacion eko-turistik në vlerën 45 milionë lekë.*
- Projektet kryesore të cilat kanë kontribuar në realizimin e investimeve me financim të huaj për 5-mujorin për Ministrinë e Turizmit dhe Turizmit paraqiten si vijon:
 - ✓ *Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit në vlerën 60 milionë lekë;*
 - ✓ *Rezervati nderkufitar i Prespes në vlerën 21 milionë lekë;*
 - ✓ *Pershtatja dhe ndryshimet klimaterike në fushën e menaxhimit nderkufitar të riskut të përmytjeve në Ballkanin perëndimor në vlerën 19 milionë lekë.*